



Qeveria e Republikës së Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

PLANI HAPËSINOR

Zona e Mbrojtur me Interes të Veçantë

“Beteja e Koshares”



Instituti për Planifikim Hapësinor
Prishtinë, Nëntor 2013

PËRMBAJTJA:

Hartuesit e Planit Hapësinor dhe Falënderimi	03
Lista e shkurtimeve	04
Përmbledhja	05
Hyrja	06
Shënim i shkurtë për Brigadën 138 Agim Ramadani	07
Qëllimi i hartimit të Planit Hapësinor	11
Planifikimi Hapësinor – sistemi, përfshirja dhe procesi	12

I. PROFILI - ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE HAPËSINORE

Përfshirja e zonës	14
Pozita gjeografike, klima dhe raporti i sipërfaqeve	16
Veçoritë natyrore	19
Rreziqet natyrore dhe nga faktori njeri	20
Posedimi dhe shfrytëzimi i tokës	22
Mjedisi dhe elementët e saj	24
Peizazhi, larmia biologjike dhe trashëgimia natyrore e kulturo-historike	27
Infrastruktura dhe zhvillimi socio-ekonomik.....	33
Zona e Memorialit në kontekst të planifikimit	36
Vlerësimi i kapacitetit të investimeve	37
Analiza - SWOT (përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet)	38
Sfidat kryesore të zhvillimit	40

II. VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

Deklarata e Vizionit	45
Parimet e përgjithshme	45
Synimet (caqet) afatgjate të zhvillimit hapësinor	46
Prioritetet strategjike	47

III. KORNIZA E ZHVILLIMIT TË ARDHSHËM

Korniza e zhvillimit të ardhshëm hapësinor	49
Koncepti i zhvillimit hapësinor (Kosharja - Qendër dhe urë turistike)	49
Struktura e zhvillimit hapësinor të zonës	51

IV. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Strategjitë konkurruese të zhvillimit hapësinor	52
Strategjia sipas trendit (ose “zero”)	52
Strategjia sipas konceptit zhvillimor (“Kosharja - Qendër dhe urë turistike”)	52
Synimi 1 Menaxhim dhe Planifikimi i zhvillimeve në zonë	53
Synimi 2 Sigurimi i qasjes dhe shërbime teknike në zonë	57
Synimi 3 Zhvillimi i turizmit në zonë dhe i vendbanimeve për rreth saj	59
Hartat strategjike dhe plani i veprimit	64

V. DISPOZITAT PËR ZBATIM TË STRATEGJISË

Dispozitat e përgjithshme mbi Planin Hapësinor	70
Kushtet dhe masat e përgjithshme dhe të përcaktuara nga qeveria dhe pushteti lokal.....	71
Përgjegjësitë e Autoritetit për menaxhim të zonës	72
Zhvillimi, rregullimi dhe shfrytëzimi i hapësirës	73
Mbrojtja dhe ruajtja e vlerave mjedisore e të trashëgimisë	74
Infrastruktura dhe shërbimet teknike	76
Dispozitat për konsultime, bashkëpunim dhe pjesëmarrje	77
Dispozitat mbi kronologjinë dhe etapat e zbatimit	78
Udhëzime mbi hulumtimet e mëtejshme.....	78
Shtojcat	79

HARTUESIT E PLANIT

Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH):

Drejtor: Luan Nushi,

Koordinator i projektit: Faton Deva,

Planerët dhe hulumtuesit: Luan Nushi, Faton Deva, Elvida Pallaska, Arbën Rrecaj, Zana Mehmeti, Besim Gollopeni, Mimoza Kallaba, Hasim Kryeziu, Gëzime Grajqevci, Shpend Agaj, Nexhmije Kamberi, Rizah Murseli dhe Festa Nela.

Përgatitja e hartave - Sektori i GIS-it në IPH

Përgatitja teknike: Instituti për Planifikim Hapësinor

Grupi Punues Ndër-Institucional:

Udhëheqës/Koordinator - Faton Deva nga IPH/AMMK,

Ndihmës Koordinator - Zana Mehmeti nga IPH/AMMK,

Anëtarë:	Sabit Restelica	AMMK,
	Ismail Hetemaj	DMM/MMPH,
	Fatlije Buza	DU/MMPH,
	Hidajete Zhuri	DPH/MMPH
	Vjollca Aliu	MKRS,
	Idriz Gashi	MBPZHR;
	Ismet Hoxha	MI;
	Bedri Millaku	MTI;
	Agron Gojani	Komuna e Gjakovës;
	Nezir Lokaj	Brigada 138 Agim Ramadani dhe
	Skender Sina	OJQ "Pashtriku" Sh.B.A.

Pjesëmarrës tjerë, të ftuar në takimet publike, përfaqësuan: Universitetet publike dhe private; Agjencitë dhe Institutet vendore; OJQ-të vendore dhe të huaja; Bizneset nga sektori Publik dhe Privat; dhe Profesionistë të pavarur

Vërejtje: Versioni i dokumentit në gjuhën shqipe është version kompetent

FALËNDERIM

Falënderojmë të gjithë kontribut-dhënësit, pjesëmarrës të grupit punues ndërinstitucional (GPNI), përfaqësues nga sektorët relevant të Qeverisë së Kosovës, të Komunës së Gjakovës, të OJQ Brigada 138 Agim Ramadani, të OJQ Sh.B.A. "Pashtriku", të organizatave publike qeveritare e joqeveritare dhe të gjithë ekspertët tjerë profesional. Gjithashtu, shprehim mirënjohjen tonë për gatishmërinë dhe angazhimin e tyre, në grupet punuese dhe në takimet publike, të organizuara me qëllim të ndihmës dhe mbështetjes së Institutit për Planifikim Hapësinor në hartimin dhe ngritjen e cilësisë së dokumentit:

"Plani Hapësinor për Zonën e mbrojtur dhe me Interes të Veçantë - Beteja e Koshares".

LISTA E SHKURTIMEVE

Shkurtesa	Emërtimi
BK	Buxheti i Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
EJL	Evropa Jug Lindore
KK	Kuvendi Komunal
KGj	Komuna e Gjakovës
DUMK	Drejtoria për Urbanizëm, Mjedis dhe Kadastër
DZHE	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik
GPNI	Grupi Punues Ndër-Institucional
ZKM	Zyra Kryeministrit
MM	Ministria e Mbrojtjes në egzil
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MAPL	Ministria e Administrimit Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MI	Ministria e Infrastrukturës
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MF	Ministria e Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera e Minerale
DPH	Departamenti për Planifikim Hapësinor / MMPH
DSH	Departamenti i Shpronësimit / MMPH
DMM	Departamenti i Mbrojtjes Mjedisit / MMPH
DU	Departamenti i Ujërave / MMPH
AKK	Agjencia e Kadastrave të Kosovës / MMPH
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës / MMPH
DPK	Drejtoria e Parkut Kombëtar (Sharri dhe Bjeshkët e Nemuna) / AMMK / MMPH
DMVR	Drejtoria për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim mjedisor/ AMMK / MMPH
IHMK	Instituti Hidro-Meteorologjik i Kosovës/ AMMK / MMH
IMN	Instituti për Mbrojtjen e Natyrës / AMMK / MMPH
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor / AMMK / MMPH
PH	Plani Hapësinor
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
PRrU	Plani Rregullues Urban
PVS	Plani i Veprimit Strategjik
SWOT	Analiza e gjendjes ekzistuese (nga anglisht për Përparësi, Dobësi, Mundësi dhe Rreziqe)
ZMIV	Zonë e Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë (Memoriali Koshares)
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
IUCN	Organizata Botërore për Ruajtjen e Natyrës (International Union for Conservation of Nature)
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
UFORK	Unioni i Fondeve për Rindërtimin e Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
SHP UÇK	Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së
ZOD	Zona Operative e Dukagjinit
KOMZOAD	Komanda e ZOD-it
GO - 3	Grupi Operativ i Tretë
QSU	Qendra Stërvitore Ushtarake
BDV	Batalioni Diversantë e Vëzhgues
MKAB	Mbrojtja Kimike-Atomike-Biologjike

PËRMBLEDHJE

Ky dokument paraqet Planin Hapësinor, për hapësirën ku është zhvilluar “Beteja e Koshares” nga Brigada 138 Agim Ramadani, si obligim dhe detyrë e përmbaruar e MMPH-së, në zbatim të vendimit, si në shtojcën 1, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr. 09/19 të datës 15 Qershor 2011 mbi shpalljen e saj për Zonë nën Mbrojtje dhe me Interes të Veçantë.

Territori i kësaj zone, shtrihet në komunën e Gjakovës dhe përfshinë sipërfaqe prej 2488 hektarë, sipas ngastrave kadastrave të bashkëngjitur në të njëjtin Vendim. Zona gjendet në pjesën perëndimore të Kosovës që shtrihet përgjatë vijës kufitare me Republikën e Shqipërisë gjatësi prej 22 kilometrave (nga pika e kalimit kufitar Morinë deri në Rrasën e Zogut) me fshatin Koshare në qendër.

Përveç vlerave karakteristike kulturore - historike të luftës së UÇK-së gjatë viteve 1998/99, kjo zonë ka edhe vlera tjera të trashëgimisë kulturore, të peizazhit, të larmisë biologjike dhe të resurseve e trashëgimisë natyrore, ku gati e gjithë zona është pjesë e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”.

Plani Hapësinor për ZMIV “Beteja e Koshares”, bazohet në PHK 2010 - 2020+, në kërkesën për trajtim të zonave të mbrojtura dhe atyre me interes të veçantë si dhe në dokumente tjera relevante nga sektorë të ndryshëm që tregojnë për faktet dhe vlerat të cilat mund të takohen edhe gjatë vizitave në teren.

Ky Plan Hapësinor, është dokument bazë dhe kornizë e veprimeve strategjike, të ofruara në formën e masave, të projekteve apo/dhe të aktiviteteve, me të gjithë bartësit dhe përgjegjësit kryesor, me afatet kohore, me koston e nevojshme dhe fondin financiar për zbatim e tyre.

Qëllim tjetër është zhvillimi i qëndrueshëm i vendit (përmes zhvillimit ekonomik - turizmit), duke ngritur oferta cilësore turistike për të siguruar frekuentim më të madh të vizitorëve në zonë, me çka do të rritej Bruto Prodhimi Vendor (BPV ose në gjuhë të huaj GDP: Gros Domestic Product) si dhe rritja e pjesëmarrjes së Turizmit në BPV.

HYRJE

Në Kosovë, sikur edhe në çdo vend tjetër, sigurimi i mbrojtjes, ruajtjes, zhvillimit dhe promovimit të vlerave dhe të pasurive brenda zonave të mbrojtura dhe me interes të veçantë është parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në veçanti dhe atë ekonomik e të vendit në përgjithësi.

Zhvillimi i qëndrueshëm, nënkupton menaxhimin e të gjitha burimeve në mënyrë që të plotësohen nevojat ekonomike, sociale dhe estetike mjedisore, duke ruajtur integritetin kulturor, proceset jetësore të larmisë biologjike dhe bazës ekologjike. Ky zhvillim, i mbështetur në direktiva, kritere dhe parime ndërkombëtare, bazohet në përkujdesjen e gjeneratave të deritanishme në përnjohjen, mbrojtjen, ruajtjen, shfrytëzimin si dhe promovimin e këtyre vlerave dhe të pasurive të trashëguara për tek gjeneratat e ardhshme.

Me iniciativë të Presidencës së Republikës së Kosovës dhe me propozim të MMPH-së, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj të 15 Qershorit të vitit 2011, hapësirën ku është zhvilluar "Beteja e Koshares" nga Brigada 138 Agim Ramadani e shpallë për Zonë të Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë, me vendimin Nr. 09/19 (shih shtojcën 1).

Bazuar në këtë vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe mbështetur në kornizën aktuale ligjore, MMPH-ja (me njësinë e saj IPH-në) obligohet të hartojë Planin Hapësinor për Zonën e Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë "Beteja e Koshares", për një periudhë të ardhshme së paku 10 vjeçare.

Zona e Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë (ZMIV) "Beteja e Koshares", e shpallur nga Qeveria e Republikës së Kosovës për shkak të vlerave të saj të karakterit kulturo-historik të luftës së UÇK-së, gjatë viteve 1998/99, shtrihet në territorin perëndimor të Republikës së Kosovës, gjegjësisht të Komunës së Gjakovës, me sipërfaqe prej rreth 2.500 (saktësisht 2.488) hektarë, me fshatin Koshare në qendër të saj.

Kjo zonë e veçantë (ose e Memorialit të Koshares), përveç vlerave të përmendura të luftës çlirimtare, gjithashtu posedon edhe vlera të tjera, të peizazhit, larmisë biologjike dhe të trashëgimisë natyrore e kulturore, të cilat e shtojnë rëndësinë e saj dhe rrisin interesimin e vizitorëve për përjetimin e tyre. Në mënyrë që ky kompleks i vlerave të bëhet edhe më tërheqës për vizitorët, kërkohet që zhvillimet brenda dhe jashtë kësaj zone të veçantë të jenë të planifikuara e të menaxhuara mirë dhe në harmoni me vlerat tjera të kësaj ane.

Ky Plan Hapësinor, është hartuar nën udhëheqje dhe koordinim të IPH-së, në bashkëpunim me Grupin Punues Ndër-Institucional, i përbërë në nivel të ekspertëve profesional nga: përfaqësuesit e sektorëve relevant të Qeverisë së Kosovës (MMPH, MTI, MBPZhR, MKRS dhe MI), Komunës së Gjakovës dhe OJQ-ve komunale dhe vendore të përfshira (Shoqata Bjeshkatore Alpine "Pashtriku" - Gjakovë dhe Shoqata e Veteranëve të UÇK-së nga "Brigada 138 Agim Ramadani" - Prishtinë). Kontribut të konsiderueshëm kanë dhënë edhe ekspert tjerë, konsulentë të huaj dhe vendor, që përfaqësonin agjenci, institute dhe organizata tjera të përfshira në takimet me publikun gjatë procesit të planifikimit¹.

¹ MMPH: Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor

SHËNIM I SHKURTË PËR “BRIGADËN 138 AGIM RAMADANI (ISH GO - 3)”

Shënimi mbi historikun dhe të dhënat për Brigadën 138 Agim Ramadani janë marrë nga Raporti² i hartuar dhe aprovuar nga pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në “Betejën e Koshares” - tani anëtarë të shoqatës së veteranëve të luftës së UÇK-së.

Grupi Operativ i Tretë (GO - 3) - ka funksionuar nën Komandën Shtabit Përgjithshëm të UÇK-së përmes Komandës së Zonës Operative të Dukagjinit (KOMZOD) dhe është përbërë nga tri njësi operative ushtarake:

1. Brigada 131;
2. Brigada 134; dhe
3. Batalioni Diversant Vëzhgues (BDV),

Këto njësi operative ushtarake ishin të themeluara me urdhër të Ministrit në Ministrinë e Mbrojtjes të Republikës së Kosovës - Z. Kolonel Ahmet Krasniqi. Më vonë “GO - 3” është riemëruar në “Brigada 138 - Agim Ramadani”.

HISTORIKU I NJËSIVE USHTARAKE DERI NË FORMIMIN E GO - 3

Brigada 131

U themelua me 16 Qershor 1998 dhe aktivitetet e veta luftarake i zhvilloi në dy lokacione të ndara në ZOD. Një pjesë e komandës, u vendos në fshatin Jasiq me detyrë luftarake, ndërsa pjesa tjetër, u dislokua në Lugun e Baranit.

Aksionet luftarake që mund të theksohen në këtë periudhë luftimesh janë: luftimet kundër forcave armike në rajonet e Oplazit, Badres, Gomuret, Zhares, Kroj i Priftit etj; pastaj luftimet në Junik, evakuimi i të plagosurve dhe popullatës civile nga zona e Junikut, aksioni në Bjeshkët e Junikut, aksioni mbi karakollin ushtarak të “Zhillaviqit”, aksioni i koduar “Fenix” mbi njësitet kufitare, etj. Pjesa e brigadës që ishte dislokuar në Lugun e Baranit ndërmori veprime luftarake si: në Betejën e Loxhës, në rajonin e Dushkajës, në Qeskovë, etj.

Brigada 134

Brigada e parë e UÇK-së e themeluar me datë 4 Qershor 1998, pas dislokimit në Kosovë, në kazermën e improvizuar në shkollën e fshatin Prapaqan, u angazhua në mobilizimin, stërvitjen, strukturimin dhe koordinimin e njësive ushtarake në teren. Kjo njësi ndërmori veprime luftarake ndaj armikut, me theks të veçantë, në “Betejën e Loxhës”, aksionet e intervenimit me njësi në mbrojtjen e fshatrave Jabllanicë e Gjakovës, Glllogjan, Shaptej, Hereq, Llukë e Epërme, Lugu i Baranit, Llugaxhi, Kosuriq, Qeskovë, Dollovë, Gërgoc, Zhabel, Ratishë, Cërmjan, Rashkoc, etj. Gjatë këtyre veprimeve nga kjo brigadë kanë rënë katër dëshmorë.

Batalioni Diversant e Vëzhgues (BDV)

U themelua me 07 Korrik 1998, me mision të vëzhgimit dhe diversioneve, në brezin kufitarë Shqipëri - Kosovë dhe në thellësi të Kosovës deri në 10 km. Në kuadër të detyrave luftarake ka kryer 25 vëzhgime nga trekëndëshi kufitar Kosovë - Mali i Zi - Shqipëri deri në pjesët veriore të Majës së malit Pashtriku. Aksionet e kësaj njësie, që duhet veçuar, janë në angazhimin e tyre në aksionet luftarake, të përmendura me Brigadës 131, si “Fenix”, etj.

² OJQ “Shoqata e Veteranëve të UÇK-së nga ish Brigada 138 – Agim Ramadani”, Raport mbi Historikun e Brigadës 138 Agim Ramadani, 2011 Prishtinë.



SULMI I ORGANIZUAR NGA "GO - 3"

Kuadrot komanduese të njësive operative, bazuar në eksperiencat e mëhershme dhe në parashikimet për zhvillimet politiko-ushtarake në të ardhmen e afërt, vendosën që të unifikohen në GO - 3 nën një hierarki komanduese ushtarake. Atëherë, ata u pajtuan të vepronin me mision të përbashkët dhe në ndryshim të doktrinës së veprimeve, kur edhe morën Vendimin për sulm, me qëllim të:

- *Thyerjes së kufirit dhe hapjes së korridorit*
- *Marrjes së një segment të vijës kufitare në mes Shqipërisë dhe Kosovës dhe të depërtohej në thellësi të territorit të Kosovës me qëllim të shpërbërjes dhe ndarjes së koncentruar të forcave si dhe të dezorganizimit të armikut në luftime.*
- *Sigurimit të një korridor për mbështetjen e forcave çlirimtare në brendi të Kosovës, dhe*
- *Detyrimit të armikut në përqendrimin e forcave në drejtim të zonës kufirit.*

Ky vendim ishte bazuar në analizat e bëra, mbi vlerësimin e situatës dhe përzgjedhjen e zonës së veprimit, sikur që ishin:

- Rrethanat politiko-ushtarake;
- Vlerësimi i forcave Serbo-Malazeze dhe të Brigadës 138 Agim Ramadani me përparësitë dhe mangësitë e veta;
- Vlerësimi i relievit, të qasjeve dhe infrastrukturës rrugore, të kushteve atmosferike, etj;
- Caktimi i zonës për thyerjen e kufirit dhe specifikat e saj, depërtimi dhe hapja e korridorit për në brendi të vendit, e të tjera.

BETEJA E KOSHARES

Realizimi i Betejës së Koshares përmes sulmit dhe luftimeve që ishin zhvilluar për 77 ditë me radhë, kishte filluar me 09 Prill dhe kishte përfunduar me 19 Qershor 1999. Këto luftime, ishin zhvilluar në një teren të thyeshëm kodrinor/malor dhe në temperatura të ndryshme, fillimisht më të ulëta (0 -12 °C) në muajin prill e deri në ato më të larta (30 °C) në muajin qershor. Gjerësia e frontit rreth 22 km, thellësia afër 7 km, në lartësi mbidetare të zonës së luftimit nga 600 – 2200 m. Distançë e pozicioneve të luftimit në mes forcave kundërshtarë ka qenë e ndryshme dhe në afërsi prej 50 deri në 200 m.

Gjatë ditës së sulmit dhe depërtimit (Dita D) si dhe në vazhdimësi gjatë gjithë operacionit, forcat e GO – 3 (ose të Brigadës 138) të UÇK-së, vendosin kontrollin mbi këto objekte hapësinore: Mriqa, Gomure, Zharre, fshati Koshare; lugina e lumit Gusha, Shkoza e Mulliqit dhe Qafë Morina. Kurse, me theks të veçantë, këtu duhet përmendur kontrollin e vënë mbi objektet taktike me rëndësi strategjike brenda kësaj zone operimi, siç ishin: Gomuret, Rrasa e Koshares, Reparti Ushtarak Koshare, Maja e Gllavës dhe Reparti Ushtarak Qafë Morinë.

Zona, që përfshihej nën kontrollin e zjarrit të artilerisë së UÇK-së, arrinte deri në 20 km dhe më tej në thellësi të vendit, përgjatë gjithë magjstrales Pejë – Gjakovë. Ndërsa nën zjarrin e kësaj artilerie mbaheshin rajonet si Rrasa e Zogut, Kërshi i Yllit, Gjocaj, Jasiq, Padi i Gështenjave, Juniku, Rastavica, Baballoqi, fshatrat e Rekës së Keqe, Rezina dhe Shkalla e Radanit deri në kufi me Postën Kufitare "7 Korriku".

Krahas luftimeve në vijë fronti, me sistem të organizuar zjarri, është vepruar edhe me grupe diversanti – vëzhgimi, të filtruara në prapavijë të pozicioneve të armikut. Njëri grup ka vepruar në regjionin e Gjeravicës dhe Rrasës së Zogut - në Gropën e Erenikut, kurse grupi tjetër në hyrje të fshatit Batushë - në rajonin e Lugut të Carragojës, Shkallës së Radanit dhe Majës së Pëllumbit.

Organizimi i vijës së frontit dhe sistemit të zjarrit është bërë në drejtimet operative: 333, që ka përfshirë zonën operuese nga PK "7 Korriku" e Shkalla e Radanit deri në Gushen e Botushës,

drejtimi operativ 555, me zonë operimi Gusha e Botushës deri në Rrasë të Koshares, drejtimi operativ 777 me zonë operimi Rrasa e Koshares deri në Gomure dhe drejtimi operativ 999 me zonë operimi Gomure deri në Rrasën e Zogut. Batalionet e këmbëtorisë ishin të përforcuara me armë të mbrojtjes kundër-ajrore (MKA) dhe të artilerisë së këmbëtorisë si: mitraloz kundërajror, mortaja dhe TpS, të cilat mundësonin ndërmarrjen e veprimeve të pavarura luftarake kundër automekanizimeve të blinduara si dhe të goditjes së armikut në thellësi. Për avancimin dhe mbrojtjen e njërive operative angazhohej grupi artileri i brigadës(GAB) sipas kërkesës dhe nevojave operative në fushëbetejë.

Pas marrjes së pozicioneve dominuese në fushëbetejë, forcat ushtarake të Brigadës 138 Agim Ramadani kaluan në avantazh ndaj atyre të armikut dhe me riorganizimin e formacioneve ushtarake dhe të sistemit zjarrit e të komandimit u lëshuan urdhrat për detyrat e ardhshme luftarake. Po ashtu, edhe në radhët e forcave armike filloi riorganizimi dhe ndërmarrja e kundërsulmeve të fuqishme me tërë potencialin e tyre njerëzorë dhe të arsenalit luftarak. Përfundimisht, meqë armiku ishte bindur në fuqinë dominuese luftarake të forcave të kësaj brigade të UÇK-së, vendos të bëjë fortifikimin (rrethimin) dhe mbylljen hermetike të vijës së frontit, përmes vendosjes masive dhe të pa rregullt të minave në zonë, gjë e cila shërbeu për masë mbrojtëse (preventivë) ndaj asgjësimit (shkatërrimit) total të tyre.

BALANCA FORCAVE TË ARMATOSURA?

Në fillim të operacionit, Forcat e armatosura të GO - 3, në kuadër të UÇK-së, numëronin 156 pjesëmarrës, kurse forcat e armikut, ato serbo - malazeze që ishin edhe më të armatosura, vetëm në njërin nga Batalionet kufitare, të ashtuquajtur "IBAR", kanë numëruar 350 ushtarë.

Përgjatë gjithë kohës së luftimeve, numri i ushtarëve sa vjen e shtohet në të dy anët. Në përfundim të operacionit (Betejës në Koshare) Brigada 138 Agim Ramadani ka numëruar rreth 2600 pjesëtarë. Ndërsa, forcat armike serbo - malazeze, numri i të cilëve kishte arritur deri në 10 000 trupa gjithsej, ishin përforcuar edhe me pjesëtar nga: Brigada 125 e Mekanizuar, Brigada 63 e Parashutisteve; Brigada 72 për Operacione Speciale; Batalioni Diversantë - Vëzhgues; Batalioni 52 i Policisë Ushtarake; Kompania Tankiste, Kompania "Beretat e Kuqe"; Pjesë nga Batalioni 56 Kufitar; si dhe disa batalione këmbësorie të vullnetarëve dhe mercenarëve.

Gjithashtu, formacionet ushtarake të armikut, ishin të mbështetura me grupe pajisjesh dhe mekanizma të përkrahjes me zjarr artilerie, sisteme të ndryshme operimi, si:

- Topat "NORA" si dhe gjuajtësit me shumë tyta "ORKAN" dhe "OGANJ";
- Topat kundërajror 20, 30, 40 mm;
- Sistemet kundër blindues "MALUTKA" dhe "FAGOT", etj.

Përveç gjithë kësaj, forcat armike, gjatë luftimeve, kanë përdor edhe:

- Aviacionin luftarak të tipit "MIG 21" si dhe
- Helme të tipit NEUROPARALITK, të njohur si "VX" dhe "SARIN".

HUMBJET

Në Betejën e Koshares, ranë 114 Dëshmorë të Kombit (prej të cilëve dy janë dekoruar me Urdhërin Hero i Kosovës kurse tre luftëtarë tjerë janë lirisdashës dhe vullnetarë ndërkombëtar, shtetas të huaj nga: Italia, Franca dhe Maroku) dhe ishin plagosur 423 luftëtarë, nga radhët e Brigadës 138 Agim Ramadani të UÇK-së.

Ndërsa, nga radhët e armikut, akoma nuk është publikuar ndonjë shënim zyrtar me ndonjë të dhënë të saktë apo të përafërt të humbjeve.

RIEMËRIMI I “GO - 3” NË “BRIGADA 138 AGIM RAMADANI”

Shënim:

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (SHPUÇK), duke u bazuar në kërkesën e Komandës së “Grupit Operativ Tre (GO-3)” dhe nën pajtueshmëri të plotë të Komandës së Zonës Operative të Dukagjinit (KOMZOD), më 11 Maj 1999, miratoj dhe morri vendim që “Grupi Operativ Tre (GO - 3)” të quhet “BRIGADA 138 AGIM RAMADANI”.



Figura 1. Shenja identifikuese e Brigadës 138. Burimi: OJQ Shoqata e Veteranëve të UÇK-së nga Brigada 138 – Agim Ramadani - Prishtinë.

Vëmendje:

Ish Presidenti i Republikës së Kosovës Dr. Ibrahim Rugova, me dekret presidencial të datës 19.04.2005, komandantët: AGIM RAMADANI dhe SALI ÇEKAJ – Dëshmorë të Kombit të rënë në Betejën e Koshares i dekoroj me Urdhrin e Artë - “HERO I KOSOVËS”³. Vendimet e veçanta të kësaj dekorate iu dorëzuan familjeve të tyre në Prishtinë më 19.04.2009 nga ish Presidenti Fatmir Sejdiu.

³ Vendimet mbi dekorimin me Urdhrin e Artë “Hero i Kosovës” janë lëshuar dhe dorëzuar familjarëve të Dëshmorëve të Kombit Agim Ramadani dhe Sali Çekaj nga Presidenti Fatmir Sejdiu me datë 19.04.2009 në Prishtinë.

QËLLIMI I HARTIMIT TË PLANIT HAPËSINOR

Plani Hapësinor për zonën e mbrojtur dhe me interes të veçantë “Beteja e Koshares” është dokument, i cili promovon interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim më të qëndrueshëm ekonomik, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetesës, duke mbrojtur njëkohësisht resurset natyrore, larminë biologjike dhe trashëgiminë natyrore e kulturore.

Qëllimi i përgjithshëm i hartimit të këtij Plani është:

- ❖ Ofrimi i kornizës bazë të veprimeve (Planit të Veprimit Strategjik - përmes aktiviteteve, masave apo projekteve) për rregullimin dhe zhvillimin e hapësirës së zonës së mbrojtur dhe me interes të veçantë (të Memorialit) “Beteja e Koshares”.

Qëllime tjera dhe më specifike të Planit janë që përmes veprimeve që do të zhvillohen në zonë, të arrihet:

- Përkujdesje e përmirësuar dhe më efikase ndaj vlerave mjedisore dhe të trashëgimisë historike, kulturore e natyrore, brenda dhe për rreth Memorialit të Koshares;
- Rregullimi i hapësirës së Memorialit të Koshares me infrastrukturë të siguar dhe qasje më të lehtësuar;
- Promovimin e vlerave dhe pasurive mjedisore e të trashëguara dhe joshjen e vizitorëve për përjetimin e tyre në funksion të realizimit të ofertës turistike.

Qëllim tjetër me rëndësi është që shfrytëzimi i përmbajtjes së Planit të jetë në shërbim të:

- I) Hartimit të planeve tjera të ngjashme dhe
- II) Informimit të politikë-bërësve e të vendim-marrësve mbi rreziqet dhe variantet e zgjidhjeve të mundshme zhvillimore me ndikimet e tyre në zonë;

Natyrisht, me ndërhyrjen e aktiviteteve të planifikuara, në zonën e veçantë, do të ndryshojë shfrytëzimi aktual i tokës si edhe vetë peizazhi natyror. Prandaj, me këtë Plan jepen propozime për zhvillimet e ardhshme hapësinore, si në aspektin e mbrojtjes e të ruajtjes së mjedisit dhe të vlerave tjera të trashëgimisë ashtu edhe në aspektin e zhvillimit të turizmit (përfshirë qasjen, lëvizjen, përkujtimin dhe përjetimin e vlerave) të zonës me rrethinë.

Këtu, fillimisht, jepet përshkrimi i gjendjes ekzistuese mjedisore - zhvillimore, për të nxjerrë diagnozën e zhvillimit aktual, mbi të cilën më pas ndërtohet edhe vizioni i propozuar për zhvillimin e ardhshëm hapësinor, në kuadër të zonës duke përfshirë edhe rrethinën e saj. Rrjedhimisht dhe më tej, propozohen, vlerësohen dhe përzgjidhen veprimet strategjike, të dhëna në formë masash, projektsh apo aktivitetsh, me efektet e tyre të bazuara në strukturën dhe konceptin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor të zonës. Përfundimisht, dispozitat e ndryshme të sugjeruara që jepen këtu, janë rregulla, masa dhe kushte për zbatim, monitorim dhe vlerësim të këtij Plani Hapësinor.

PLANIFIKIMI HAPËSINOR - SISTEMI, PËRFSHIRJA DHE PROCESI

Hartimi i Planeve Hapësinore bazohet në legjislacionin e Kosovës në fuqi si dhe në praktikat dhe standardet e mira ndërkombëtare. Korniza Ligjore në Kosovë është e përafëruar në masë të madhe me kornizën legjislative *acquis communautaire* të BE-së. Plani Hapësinor për Zonë të Veçantë bazohet në ligjin aktual me të gjitha aktet nënligjore që mbulojnë fushën e Planifikimit si dhe janë respektuar edhe ligjet tjera relevante për: Mjedisin, Trashëgiminë Kulturore e Natyrore, Shpronësimin, Infrastrukturën dhe Shërbimet Publike, duke përfshirë edhe të gjitha Udhëzimet Administrative përkatëse të cilat rrjedhin nga këto ligje.




Figura 2. Skema e sistemit të planifikimit në Kosovë - Burimi: IPH / MMPH

Sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, Sistemi i Planifikimit, në Republikën e Kosovës (fig. 2), ndahet në dy nivele: në nivel qendror dhe në nivel lokal. Niveli qendror, harton plane hapësinore për tërë territorin e Republikës së Kosovës si dhe për zonat e veçanta me specifika të ndryshme.

Me iniciativën e Zyrës së Presidentit dhe propozimin e MMPH-së, Qeveria e Kosovës ka nxjerr vendim, sipas të cilit hapësira ku janë zhvilluar aktivitetet e rëndësishme të luftës së UÇK-së “Beteja e Koshares” nga Brigada 138 Agim Ramadani – shpallet Zonë e Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë. Sipas këtij vendimi dhe legjislacionit në fuqi, MMPH-ja përmes Institutit për Planifikim Hapësinor obligohet që me rolin e bartësit dhe koordinatorit të projektit të hartoj Planin Hapësinor për këtë zonë.

Me vendim të Sekretarit Përgjithshëm (SP) të MMPH-së, është themeluar Grupi Punues Ndër-Institucional. Grupit Punues, i cili në përbërje fillestare ishte me ekspertë nga MMPH-ja, kurse që në fillim të procesit të hartimit të këtij Plani, i bashkëngjiten edhe profesionistët tjerë përfaqësues nga: sektorët tjerë të Qeverisë së Kosovës (MI, MTI, MKRS, MBPZHR), Brigada 138, SHBA “Pashtriku” si dhe Kuvendi Komunal i Gjakovës.

Skema e pjesëmarrjes




Figura 3. Skema gjithëpërfshirëse në procesin e planifikimit në Kosovë. Burimi: IPH / MMPH

Përveç pjesëmarrjes në grupe punuese, në dëgjimet dhe diskutimet e hapura konsultuese si dhe shqyrtimet e organizuara publike, u jepet mundësia për kycje edhe të përfaqësuesve tjerë, si në skemën e paraqitur në fig. 3, kur edhe arrihet përfshirje më e gjerë e mbështetur në parimin gjithëpërfshirës të palëve të interesuara.

Bazuar në Udhëzimin Administrativ⁴, që rregullon çështjen e Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta, këto Plane duhet të sigurojnë një regjim të veçantë planifikimi dhe kontrole të zhvillimeve hapësinor në zonë të mbrojtur dhe me interes për Kosovën, me organizim dhe menaxhim (mbrojtje, ruajtje, trajtim, shfrytëzim dhe promovim) të vlerave të saj.

Plani Hapësinor për Zonën e Veçantë si dokument, por edhe si proces i planifikimit, paraqet përmbledhjen dhe trajtimin e zhvillimeve hapësinore, në 5 faza (fig. 4), që tregojnë për:

- gjendjen aktuale (faza e I-rë),
- vizionin me caqe të bazuara në parime (faza e II-të),
- kornizën e zhvillimit të ardhshme hapësinore me koncept dhe strukturë (faza e III-të),
- strategjinë me planin e veprimeve të zhvillimit të ardhshëm hapësinor (faza e IV-të), dhe
- dispozitat për zbatim të strategjisë (faza e V-të), ku përshkruhen kushtet dhe rregullat të cilat duhet të respektohen për zbatim të drejtë të veprimeve të planifikuara.

⁴ MMPH: UA mbi "Elementet Themelore të Përbajtjes së Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta" Nr. rendor 43 dhe Nr. Protokolli 04/05.




Figura 4. Skema e procesit të planifikimit (Hartimit të Planit) në Kosovë. Burimi: IPH / MMPH

Gjatë hartimit të Planit Hapësinor për Zonën e Veçantë, duke trajtuar zhvillimet aktuale dhe ato të ardhshme, nëpër fazat e përmendura, nxirren sfidat zhvillimore si dhe mund të dalin edhe vendime të ndryshme dhe plane strategjike të veprimit, me qëllim dhe në drejtim të arritjes së vizionit edhe përpara përfundimit dhe miratimit të tij. Plani Hapësinor i zonës me interes të veçantë, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe ajo grafike, ku hyjnë të gjitha llojet e ilustrimeve qofshin ato harta, figura, skema, tabela dhe foto.

Pas finalizimit të Planit, IPH/AMMK/MMPH organizon Shqyrtimin Publik, për 60 ditë me radhë, i cili është i hapur për të gjithë që janë të interesuar, që me diskutimet, komentet dhe sugjerimet e veta, të kontribuojnë në cilësinë e dokumentit final.

Dokumenti i plotësuar me rekomandimet nga shqyrtimi publik, dorëzohet në Qeveri për miratim paraprak dhe procedim të mëtejshëm për aprovim përfundimtar në Kuvendin e Kosovës (fig. 4). Pas aprovimit, dokumenti merr karakter obligues dhe si i tillë duhet të respektohet dhe zbatohet nga të gjithë sektorët dhe planet e nivelit qendror dhe lokal. Plani i tillë, konsiderohet bazë e projekteve, për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit në përgjithësi dhe të zonës së cilës i dedikohet në veçanti.

I. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

1. PROFILI - ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE NË ZONËN E VEÇANTË

1.1 PËRFSHIRJA E TERRITORIT DHE KUFIRI I ZONËS SË MEMORIALIT

Hapësira e Zonës së Veçantë ku është zhvilluar “Beteja e Koshares”, për të cilën hartohet ky plan hapësinor, ka sipërfaqe prej 2.488 ha ose rreth 25 km² dhe në vete përfshinë elemente dhe faktorë të ndryshëm mjedisor me ndikim në hapësirë.

Ndër elementët më të dalluar mjedisor dhe hapësinor, që përfshihen në këtë zonë, nisur nga kufiri ndërshtetëror Shqipëri - Kosovë (nga pika Rrasë e Zogut në veri deri në pikën jugore Qafë Morinë) në gjatësi prej 22 km dhe duke hyrë në thellësi të vendit, si në hartën e më poshtme në fig. 5, janë:

- Rrasa e Zogit, Maja e Zezë dhe Gomuret,
- Braha, Pjesë e Livadhit Shabanit dhe Rrasa e Koshares,
- Oplazi dhe Fshati Koshare;
- Lugina e lumit Gusha dhe
- Kodra e Shkozës me Babushin dhe Bokën

Përshkrimi i vijës së kufirit të Zonës së Veçantë “Beteja e Koshares”, është bërë duke përdorur hartën topografike me përpjesë $P = 1 : 25,000$ dhe orto-foton e vitit 2009. Ndërsa, harta e prezantuar është në përpjesë $P = 1 : 40,000$ dhe paraqet vijën kufizuese të zonës, që përshkohet nëpër pikat I - VII si dhe vijën në mes të kuotës VII dhe I, që përputhet dhe tregon kufirin ndërshtetëror në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

Kufiri i kësaj zone, fillon të shtrihet prej kuotës I (me koordinatat $X = 7436324.24$ m, $Y = 4697473.61$ m dhe $Z = 590$ m) që ndodhet në vijën kufitare Shqipëri-Kosovë dhe është në afërsi të pikës së kalimit kufitar “Qafë Morinë”. Nga kjo kuotë, kufiri merr drejtimin lindor deri në afërsi të lumit “Morina”, që i referohet kuotës II (me $X = 7438483.50$ m, $Y = 4698058.74$ m dhe $Z = 460$ m), e cila ndodhet në luginën e lumit afër vendbanimit Morinë.

Nga kuota II deri në kuotën III (me $X = 7437827.60$ m, $Y = 4699406.66$ m dhe $Z = 490$ m), kufiri përcjell drejtimin kryesisht verior paksa të devijuar kah perëndimi, gjegjësisht nëpër luginën e këtij lumi. Prej kuotës III kufiri ndërron drejtimin pothuaj për 90° dhe shkon në veri-lindje duke kaluar nëpër shpatet “Hodup” deri në afërsi dhe mbi maje të “Nizamit”, që me këtë rast paraqet kuotën IV (me $X = 7439275.67$ m, $Y = 4700923.38$ m dhe $Z = 700$ m).

Nga këtu (kuota IV), kufiri shkon kryesisht nëpër të njëjtën lartësi mbidetare (izohipsën 700 m) të malit Shkoza, sërish dhe gjithmonë në drejtim veri-perëndimor, ku pas një distance prej rreth 800 m zbret në luginën e lumit “Gusha” në kuotën V. Prej kuotës V (me $X = 7438515.65$ m, $Y = 4701672.29$ m dhe $Z = 528$ m) kufiri vazhdon të shtrihet në drejtimin e njëjtë, duke kaluar nën shpatet e “Kotecit”, pranë burimit të lumit “Celis”, nëpër “Livadhet e Shabanit”, “Fushat e Shtira” dhe kështu deri në kuotën VI (me $X = 7433474.67$ m, $Y = 4705979.71$ m dhe $Z = 1873$ m).

Nga kuota VI, e cila quhet edhe "Guri i Gatë", e deri në kuotën VII (me $X = 7431472.43$ m, $Y = 4706940.15$ m dhe $Z = 2250$ m) vija e kufirit përsëri ndërron drejtimin me kahe gjarpërore, një herë kah perëndimi, pastaj në veri dhe përsëri kah perëndimi. Kjo vijë e thyer e kufirit, kur del në luginën e përroit "Ereniku i Vogël" e ndjek atë deri te burimi i tij, duke lënë shpatet e "Rrasës së Zogut" në të djathtë dhe për të përfunduar prapë në kufirin administrativ me Republikën e Shqipërisë.




Figura 5. Harta e ZMIV "Beteja e Koshares" me rreth 25 km² dhe kufiri i saj. -Burimi: IPH/MMPH

1.2. POZITA GJEOGRAFIKE, KLIMA DHE RAPORTI I SIPËRFAQEVE

1.2.1. Pozita Gjeografike

Zona e mbrojtur dhe me interes të veçantë “Beteja e Koshares”, zënë pozitë perëndimore në territorin e Republikës së Kosovës dhe shtrihet në kufirin ndërshtetëror me Republikën e Shqipërisë (fig. 6). Kjo zonë gjendet, në Malësinë e Gjakovës, në anën malore të pjesës perëndimore të Rrafshit të Dukagjinit, me qendrën e saj në atitudat përkatëse prej 42,14° të gjatësisë gjeografike dhe 20,28° të gjerësisë gjeografike veriore. Në afërsi dhe për rreth kësaj zone, gjenden: Liqeni i Radoniqit me Aeroportin e Gjakovës dhe Ujëvarat e Mirushës në lindje, Bjeshkët e Nemuna me Majën e Gjeravicës (më e larta në Kosovë - 2.656 m) dhe liqenin, burimin e luginën e Lumit Ereniku, Manastirin e Deçanit, Patriarkanën e Pejës si dhe Liqenin e Plavës në veri, ndërsa lugina piktoreske e Lumit Valbona dhe Maja e Shkëlzenit (2.410 m) shtrihen në perëndim (në regionin e Tropojës - Shqipëri) për të përfunduar me Pikën e kalimit kufitar Morina në jug.




Figura 6. Harta me pozitën e zonës dhe kontekstin e saj hapësinor në Kosovë. Burimi: IPH / MMPH

1.2.2. Klima me karakteristikat e përgjithshme

Nga studimet e shumta dhe matjet shumë vjeçare për të reshurat, siç tregon edhe Master Plani 1982⁵, mund të përfundohet se në Republikën e Kosovës dominojnë kushte të ndryshme klimatike. Kosova, për nga pozita e saj gjeografike, gjendet në mes të kufirit të moderuar sub - tropikal të rripit klimatik Evropian. Thënë më saktë, Kosova gjendet në mes të zonës klimatike kontinentale të Detit Mesdhe dhe klimës Evropiane kontinentale.

Megjithatë, Republika e Kosovës, për shkak të varg maleve të cilat e rrethojnë atë, ka edhe regjione të caktuara, të cilat janë me veti specifike mikro-klimatike, të ndërprera përmes luginave të lumenjve, nëpër të cilat depërtojnë ndikimet e modifikuara të klimës kontinentale mesdhetare. Në zonën e mbrojtur dhe me interes të veçantë (apo më shkurt në Memorialin) Beteja e Koshares mbizotëron kryesisht klimë kontinentale (kalimtare nga e mesme në atë malore) me ndikim nga Deti Adriatik përmes pellgut Drinit dhe Erenikut.

Zona klimatike e mesme kontinentale, është e njohur në bazë të aktiviteteve të ciklonit, të cilat kushtëzojnë sasi të mëdha të reshjeve, që në këto zona shfaqen në periudhat e dimrit, ndërsa verës, kjo zonë është nën ndikimin e ciklonit azur, ku dominojnë masat ajrore me origjinë tropikale në të. Si pasojë e kësaj të fundit, që mund të nënvizohet, është se gjatë stinës së verës masat e ajrit janë të nxehta dhe të thata .

Temperatura e ajrit - ndryshon shumë në hapësirat e caktuara brenda Kosovës, në varësi të shtrirjes së tyre gjeografike dhe të përkatësisë rajonale, p.sh. në Rrafshin e Kosovës apo të Dukagjinit - ku gjendet edhe zona e Memorialit të Koshares. Në përgjithësi, për Kosovën, mund të thuhet që sezoni më i ftohtë dimëror është gjatë muajve Dhjetor – Shkurt, me mesataren prej 0.2 °C. Sezoni në stinën e Pranverës është më i ftohtë se në stinën e Vjeshtës.

Është karakteristike që në rajonin e Gjakovës dominojnë temperaturat më të ulëta të ajrit se në rajonin e Pejës dhe Istogut, e cila është me shtrirje më të vogël gjeografike se këto të fundit brenda Dukagjinit. Kjo vjen nga shtrirja e masës ajrore dhe krijimit të reve të shiut, sepse Gjakova si dhe i tërë shtrati i Erenikut dhe Lum Bardhit të Deçanit, shtrihen në zonën me reshjet më të larta vjetore në Republikën e Kosovës. Në Gjakovë, mesatarja e temperaturës minimale vjetore është 5.6°C, ndërsa mesatarja e temperaturës maksimale vjetore është 15.8°C.

Të reshurat - për të cilat, gjithmonë duke u bazuar në të dhënat hidro-meteorologjike për periudhën kohore 1948-1978, mund të konstatohet se: sasia vjetore e të reshurave të shiut, në Pellgun e Lumit - Drini Bardhë është më e larta nga toalet e pellgjeve tjera në Kosovë. Gjithsesi, reshjet maksimale (sasitë maksimale apo më të larta) paraqiten në periudhën vjeshtë - dimër, ndërsa ato minimale apo më të ulëta në sezonin veror. Nëntori e Dhjetori janë muajt me më së shumti të reshura përdërisa me thatësi më të lartë është muaji Gusht.

Në disa rajone, paraqitet edhe maksimumi sekondar, ku të reshurat e shiut janë të larta edhe në muajin Maj. Sidomos në rajonin e Dukagjinit, ku sipas oscilimeve të reshurave të shiut në Junik arrijnë vlerën totale vjetore 1.408 mm, kurse në rajonin e Gjakovës arrin vlerën totale vjetore gjer në 981 mm. Vlera minimale e reshjeve paraqitet në muajin Gusht, me vlerë prej 43 mm në rajonin e Gjakovës, ndërsa në Junik vlera minimale prej 46 mm.

⁵ Master Plani për Ujëra, 1986 Prishtinë.


1.2.3. Raporti i sipërfaqeve me zonën e memorialit

Sipërfaqja e zonës së mbrojtur dhe me interes të veçantë “Beteja e Koshares”, përfshinë territorin prej 2.488 ha ose rreth 25 km². Në aspektin administrativ, e gjithë zona, gjendet në territorin e Komunës së Gjakovës (fig. 7). Raporti i përfshirjes së sipërfaqes, nga territori i përgjithshëm i komunës së Gjakovës prej 587 km², është 1/24 ose 4,23 % në nivel lokal, përderisa, në nivel qendror apo vendi (si në fig. 6) është rreth 0.23%, nga territori i përgjithshëm i republikës së Kosovës me sipërfaqe të prej 10.907 km².

Figura 7. Harta e Memorialit të Koshares në kuadër të PK Bjeshkët e Nemuna dhe Komunës së Gjakovës. Burimi: MMPH /IPH

Bazuar në të dhënat që disponojmë, në sektorin e sistemit informativ gjeografik (GIS) në IPH, rreth 85 % e zonës së mbrojtur dhe me interes të veçantë “Beteja e Koshares”, është pjesë e territorit të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”⁶ (shih fig. 7). Zona e Memorialit të Koshares shtrihet në cepin më jugor të këtij Parku dhe përfshihet në 3.5 % të territorit tij.

Sipërfaqja e territorit të zonës së Memorialit të Koshares, dominohet me mbi 77 % ose 3/4 e saj nga toka pyjore, nga sipërfaqet e pasura me shkurre dhe drunjë të mesëm e të lartë (në pjesën jugore dhe qendrore të zonës), si dhe me nën 1/4 ose 23 % nga toka bujqësore, nga sipërfaqet e pasura me kullosa (në tërë pjesën veriore dhe në disa pjesë të vogla në qendër të zonës).



⁶ Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, i shpallur me Ligjin Nr. 04/L – 086, GZRK Nr.2 e datës 21.01.2013.

1.3. VEÇORITË NATYRORE

Gjeologjia e terrenit - e zonës së veçantë “Beteja e Koshares”, që shtrihet përgjatë kufirit Kosovë – Shqipëri, i takon Bjeshkëve të Nemuna të cilat njëjtë sikur Sharri dhe Dinariket janë formuar në faza të njëjta gjeologjike. Ky formacion është nga lloje të ndryshme shkëmbinjsh metamorfik, proceset e të cilave janë prezentë edhe në ditët e sotme.

Bazuar në hartën gjeologjike, sikur në fig. 8, shtrirja e formacioneve shkëmbore vërehet se nuk është e njëjtë. Në të mund të shihet se:

- Sedimentet liqenore dhe lumore shtrihen në jug të zonës;
- Afër Morinës janë identifikuar Serpentine dhe periodite te serpentizuara. Përhapja e gëlqerorëve, dolomitëve dhe brekçive janë në afërsi të Bokës dhe Lumit (Potok) Mulliq si dhe rrëzë tyre janë shkëmbi gëlqeror dhe dolomitë;
- Ranorët, filitet, rreshpet klorite, konglomeratet, mergelët, gëlqeroret kanë përhapje me të gjerë territoriale, në: Shkozë, Oplaz, Koshare dhe Rrasë e Koshares;
- Rëra, argjila, zhavorri, tufe (pjesërisht) dhe lignit - shtrihen në Koshare me rrethinë;
- Sendimentet glaciale kanë përhapje në pjesën veriore gjegjësisht në rrjedhjet e sipërme lumore, në luginat e lumit Ereniku i vogël dhe lumit Gusha, kurse Serpentinët dhe Gabrot kanë përhapje më të rralla.





Figura 8 dhe 9. Hartat e zonës me formacionet gjeologjike (majtas) dhe pedologjike (djathtas). Burimi: IPH / MMPH




1.4. RREZIQET

Rreziqet natyrore - meqë nuk ka studime, matje dhe hulumtime më të reja, për Zonat e rrezikuara nga erozioni, mbi shkallën dhe intensitetin e tyre të ndryshëm, përdoret harta e prezantuar në fig. 10, e krijuar nga të dhënat prej hartës Erozive në Atlasin HE të Kosovës⁷. Në bazën e të dhënave dhe në këtë hartë, tregohet edhe për përfshirjen e këtyre sipërfaqeve, që janë në kuadër të Bjeshkëve të Nemuna, nga erozioni me shkallë intensiteti të lartë është rrezikuar mbi 1/3 ose 35% e sipërfaqes së zonës së veçantë, kurse 40% e territorit saj është nën presion të erozionit me shkallë të intensitetit të mesëm.

Zonat të cilat nuk janë të mbuluara me vegetacion bien nën ndikim të faktorëve ekzogjen nga alterimi fizik, kimik dhe biologjik dhe në këtë mënyrë shkaktohet rritja e shkallës së erozionit. Sipërfaqet me erozion shumë të fortë dhe të fortë janë zonat më të rrezikuara, në të cilat alternohet, bartet dhe akumulohet sasi më e madhe e materialit eroziv. Këtu, bartja dhe akumulimi i materialit eroziv, në drejtim të Rrafshit të Dukagjinit, mundësohet përmes pellgut të lumit Ereniku.

Figura 10. Harta e intensitetit të shkallës së erozionit në zonën e veçantë. Burimi: IPH / MMPH nga Atlasi HE i Kosovës 1976



Rreziqet nga faktori njeri - janë prezentë në zonën e veçantë të Koshares sikur në çdo zonë tjetër në mbarë Kosovën, edhe pse kjo zonë është mjaft larg ndikimit të faktorit njeri.

Të gjitha aktivitetet e paplanifikuara dhe të pakontrolluara, qofshin ato të shkaktuara nga rreziqe natyrore apo nga faktori njeri në mënyrë ilegale, kanë për pasojë dëmet mjedisore, e sidomos të rritjes së shkallës erozive në zonë. Dëmet e shkaktuara e të ekspozuara në mjedisin e kësaj zone, të ndikuara nga faktori njeri, janë me qëllim të përfitimit ekonomik. Për këtë qëllim, bregorja e Shkozës pranë perroit të Gushës në hyrje të kësaj zone, po shfrytëzohet nga një kompani private, për nxjerrjen dhe thyerjen e shkëmbinjve gëlqeror. Aktiviteti i saj po vazhdon përkundër vendimit në fuqi të KPMM-së, që nga viti 2011, për anulim të licencës, së lëshuar nga po i njëjti organ në vitin 2005 për shfrytëzim 20 vjeçar.

⁷ Harta është pjesë e hartës së përpunuar në sektorin eGIS-it të IPH-së sipas Hartës Erozive të shkëputur nga "Atlasi Hidro - Ekonomik i Kosovës". 1976, Prishtinë.

Kjo hapësirë e bregores është e degraduar dhe për rehabilitimin e saj duhet të merren masa emergjente dhe adekuate, sepse paraqet rrezik për shembjen e saj dhe e cila nuk përshtatet me karakterin dhe qëllimin e zonës së mbrojtur e me interes të veçantë.



F

Foto 1. Pamje nga veprimtaria e Gurëthyesit dhe prerja ilegale e drunjtëve. Burimi: IPH / MMPH.

Aktiviteti tjetër, që shfaqet në zonën e Koshares ndonëse jo në sasi të mëdha, është edhe shfrytëzimi i pakontrolluar i pyjeve me dukurinë e prerjes ilegale të drunjtëve. Për ndërprerjen e kësaj dukurie dhe parandalimin e këtij degradimi, që mundëson erozionin, duhet të merren masat e preferuara mjedisore.

Por çështja më shqetësuese në ZMIV-të është prezenca e minave të pashpërthyera e të shpërndara pa ndonjë plan të vendosjes tyre gjatë luftës nga ana e palës ushtarake serbe. Prandaj, ky është një rrezik permanent për të gjithë vizitorët e zonës, pavarësisht angazhimit të njësive të FSK-së për de-minimin e tyre.



Foto 2. Zonat e dyshuara për rrezik nga minat dhe takimi me njësitet për de-minim (nga FSK-ja dhe KFOR-i). Burimi: IPH / MMPH

Zjarret dhe përhapja e tyre, është tjetër rrezik i përhershëm që mund të shkaktohet nga faktori natyror gjatë temperaturave të larta të stinës së Verës. Shkaktari më i shpeshtë i zjarrit është edhe faktori njeri, i cili me vetëdije apo pa të ndikon në shfaqjen e kësaj dukurie që shëmton natyrën. Prandaj, masat që duhet të ndërmerren, për në zonën që konsiderohet me potenciale të mëdha rreziku nga zjarri, duhet të jenë sipas kriterëve të bazuara në ligje, plane dhe rregullore ekzistuese për menaxhimin e emergjencave.

1.5. POSEDIMI DHE SHFRYTËZIMI I TOKËS

1.5.1. Posedimi pronësor i Tokës

Territori i zonës së veçantë, për nga posedimi pronësor i tokës, rezulton të jetë i kombinuar, pra në pronësi private dhe publike. Sipërfaqet e përshtatshme për ndërhyrje dhe zhvillime të reja në zonë, të cilat duhet bazuar në planin hapësinor dhe rregullues të domosdoshëm, gjenden kryesisht në hapësirën qendrore të zonës që përfshinë Logun dhe Rrasën e Koshares.

Hapësira e planifikuar për ndërhyrje, në Logun e Koshares, për organizimin dhe rregullimin e Kompleksit të Memorialit, është sipërfaqe prej rreth 10 ha (si në fig. 11 majtas), që përfshinë Varrezat e Dëshmorëve (sip. e shpronësuar) dhe hapësirën për rreth, e cila është nën posedim të pronësisë private (sip. që duhet shpronësuar). Kurse, hapësira e istikameve me vend-rëniat e dy heronjve në Rrasën e Koshares si dhe të Karakollit e të shtigjeve, janë sipërfaqe nën posedim të pronësisë shoqërore – publike, të ekonomisë pyjore dhe të rrugëve publike, me rreth 60 ha (si në fig. 11 djathtas), të cilave duhet ndërruar titullarin e pronës.




Figura 11. Pasqyra për posedim pronësor të tokës në Log (majtas) dhe Rrasë (djathtas) të Koshares. Burimi: IPH / MMPH dhe N.Sh. "Gjeodezia" - Gjakovë

1.5.2. Shfrytëzimi i Tokës

Për nga shfrytëzimi aktual i sipërfaqes së tokës, siç mund të vërehet qartë në fig. 12 (majtas), zona mbulohet kryesisht nga dominimi i sektorit pyjor me mbi $\frac{3}{4}$ ndaj sektorit bujqësor (kryesisht kullosa) që mban nën $\frac{1}{4}$ e sipërfaqes totale të saj. Gjersa, sipërfaqja pjesëmarrëse nga sektorët tjerë (si ndërtimi i shtëpive të fshatit për banim, shkolla, tyrbja, karakolli, varrezat e dëshmorëve, restoranti dhe industria) është shumë minimale, sepse ka një shtrirje shumë të vogël prej rreth 0.5%, brenda zonës së mbrojtur dhe me interes të veçantë "Beteja e Koshares".





Figura 12. Hartat e shfrytëzimit aktual të tokës.
Burimi: IPH / MMPH

Meqë kjo zonë mbizotërohet nga potencialet e shumta me resurse mjedisore dhe vlera të trashëgimisë natyrore e kulturo - historike, rekomandohet që shfrytëzimi i tyre të jetë racional dhe i kontrolluar gjatë planifikimit të zhvillimeve të ardhshme.

Figura 13. Hartat e përshtatshmërisë së tokës bujqësore. Burimi: IPH / MMPH



Shikuar nga aspekti i përshtatshmërisë së përdorimit të tokave bujqësore, në zonën e veçantë shtrihen tokat bujqësore që i takojnë klasës 5 - 8, klasifikimi i të cilave shihet në legjendën e hartës djathtas, në fig. 13. Prandaj, zhvillimet e ardhshme hapësinore, të lejueshme në këtë zonë, duhet t'i përgjigjen kërkesave të vizitorëve që janë të ndërlidhura mes sektorit të turizmit dhe atyre mjedisor, bujqësor, pyjor si dhe atij bjeshkatarë - alpin.

1.6. MJEDISI

Në aspektin mjedisor, duke përjashtuar disa degradime të vogla e të rralla që ndodhin brenda saj, në përgjithësi në zonën e mbrojtur dhe të interesit veçantë mbizotëron një mjedis i pastër kodrinor - malor me vlera të shumta natyrore. Meqë, vet prezenca e disa veprimeve të njeriut me ndikim ndotës dhe degradues në zonë (gurëthyes, prerje e drunjtëve, pluhuri i ngritur dhe hedhja pa kriter e mbeturinave), janë brenga të cilat mund të shndërrohen në elemente serioze në degradimin e përgjithshëm mjedisor të zonës. Një element tjetër, me ndikim negativ dhe më specifik në degradim të tokës, është edhe prezenca aktuale e minave të pashpërthyera dhe ndotja e saj nga uranumi i varfëruar.

1.6.1. Ajri

Zona e interesit të veçantë, në përgjithësi është një hapësirë me ajër të pastër në zonën kodrinore - malore, mirëpo në të, gjenden edhe faktorë që ndikojnë sadopak në ndotjen e cilësisë së ajrit. Këtu, brenga momentale, janë pasojat e kësaj ndotje në zonë, si gazrat e liruara dhe pluhuri i ngritur gjatë qarkullimit të auto mjeteve motorike nëpër rrugën (me tampon të shtruar mirëpo pa shtresë finale të vendosur) nga fshati Batushë për në Varrezat e Dëshmorëve (foto 3) si dhe nga mbeturinat e hedhura jashtë kontejnerit, të shkaktuara nga moskujdesi i vizitorëve.



Foto 3. Ngritja e pluhurit në rrugën Batushë - Varrezat e Dëshmorëve. Burimi: IPH / MMPH

1.6.2. Toka

Përkundër një territori të pastër në këtë mjedis kodrinor - malore, brengë janë disa faktorë që hasen në hapësirën e kësaj zone të veçantë (siç vërehen edhe në foton 4), që ndikojnë në degradimin e tokës. Këtu, mund të përmenden: hedhja e mbeturinave dhe prerja e drunjtëve pa ndonjë kriter a kontroll adekuate përskaj rrugës si dhe veprimtaria e Gurëthyesit, në shpatin shumë të thepisëm verior të kodrës së Shkozës, pranë përroit Gusha që në hyrje të kësaj zone nga fshati Batushë. Pozita dhe funksionimi i mëtejshëm eventual i gurëthyesit në bregoren e Shkozës, paraqet degradim dhe rrezik mjedisor, duke ndikuar në shembjen e saj.



Foto 4. Degradimi i tokës nga mbeturinat (majtas) dhe gurëthyesi në zonë (djathtas). Burimi: IPH / MMPH

Mirëpo, brenga më e madhe e rrezikut në ndotje dhe degradim të tokës, qëndron në prezencën e uranimit të varfëruar nga predhat e lëshuara nga NATO gjatë bombardimit në vitin 1999 dhe në mos-largimin e tërësishëm të minave të vendosura brenda kësaj zone, shih hartat në fig. 14.

Sipas raportit të programit për mjedis të Kombeve të Bashkuara⁸, Komuna e Gjakovës, është ndër zonat më të ndoturat nga predhat me uranum të varfëruar, në Kosovë. Në këtë raport, përcaktohen 39 vendndodhje, prej tyre 30 në zonën urbane (ish garnizoni ushtarak pranë Kishës Katolike) dhe 9 sosh në Liqenin e Radoniqit, uji i të cilit përdoret për pije për qytetin dhe disa fshatra të Gjakovës.



Figura 14. Hartat e rajonit me degradim të tokës uraniumi i varfëruar (majtas) dhe nga minat (djathtas). Burimi: "Strategjia e Zhvillimit Qëndrueshëm të Komunës së Gjakovës 2006"⁹

Koncentrimi i mjeteve të pashpërthyera, me vendosje të tyre pa ndonjë plan në hapësirën e ZIV-të "Beteja e Koshares", përgjatë vijës kufitare me R. e Shqipërisë, është një çështje tepër problematike, e cila kërkon një përkushtim dhe angazhim më të madh të organeve kompetente për eliminimin e tyre.

Bazuar në prezencën e këtyre mjeteve të pashpërthyera, zona e Memorialit të Koshares konsiderohet si e rrezikshme, për çka edhe njësitet e de-minimit të FSK-së dhe të KFOR-it janë të angazhuara deri në pastrim përfundimtar (të plotë) të zonës. Prandaj, deri atëherë, lëvizjet e vizitorëve në zonë duhet të jenë të kontrolluara dhe të udhëhequra nga njohës të mirë të terrenit.

1.6.3. Uji

Sa i përket resurseve ujore, zona e interesit të veçantë, është larg ndikimeve negative të shkaktuara nga faktori njeri, prandaj edhe konsiderohet si zonë shumë e pastër në këtë aspekt. Kjo zonë, karakterizohet me një numër të madh të rrjedhave në formë të përroskave dhe përrenjve. Ujëmbledhësi kryesor i këtij rrjeti të ujërave, që përfshinë mbi 90 % të sipërfaqes së zonës së veçantë, është Përroi i Gushës. Ndërsa, në pjesën veriore të zonës që përfshinë nën 10 % të sipërfaqes së saj, është rrjedha e sipërme e përroskës Ereniku i Vogël. Në zonën e veçantë të Koshares (siç shihet edhe në fig. 15) ka basene nëntokësore dhe burime e rrjedha të shumta ujore. Të gjithat burimet e identifikuar ujore (74 sosh) rezultojnë me ujë të pijshëm. Bazuar në të dhënat, mbi trupat ujqor që posedon zyra e gjeodezisë dhe e kadastrave në Gjakovë, sasia e përgjithshme e ujit nga të gjitha burimet brenda zonës (edhe pse matje të vjetra e të kryera brenda 24 orëve), është 14.983 m³ ose 0.174 m³/s.

⁸ UNEP. "Uraniumi i Varfëruar në Kosovë (Depleted Uranium in Kosovo)". 2001 Prishtinë.

⁹ KK Gjakovë. *Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Komunës së Gjakovës*, CBDC (Qendra për Zhvillimin e Komunitetit dhe Biznesit, 2006 Gjakovë.




Figura. 15. Harta hidro-gjeologjike në zonë dhe për rreth saj. Burimi: IPH / MMPH.

1.6.4. Zhurma

Zona e mbrojtur dhe me interes të veçantë ku është zhvilluar Beteja e Koshares konsiderohet për zonë shumë të qetë mjedisore sepse gjendet në një hapësirë ku përjashtohet ndikimi negativ (ndotës e degradues) të shkaktuar nga zhurma si pasojë e veprimtarisë njerëzore.

1.7. PEIZAZHI, LARMIA BIOLOGJIKE DHE TRASHËGIMIA NATYRORE E KULTURO - HISTORIKE

Komuna e Gjakovës, për nga peizazhi, larmia biologjike dhe trashëgimia natyrore e kulturore është një rajon i llojllojshëm dhe shumë i pasur mjedisor. Në pjesën perëndimore, ku gjendet edhe zona e veçantë “Beteja e Koshares”, shtrihen malet e larta me pyje dhe kullota të ndara nga luginat e mprehta lumore, gjersa në pjesën lindore shtrihen fushat bujqësore me toka pjellore dhe lugina gjarpërore lumenjsh të ndryshëm. Kjo strukturë relievore dhe morfologjia e tillë e terrenit i dhurojnë kësaj komune pamje karakteristike dhe të ndryshme nga të gjitha anët.

1.7.1. Peizazhi

Ambienti rrethues brenda territorit të komunës së Gjakovës mundëson përjetim të peizazhit mahnitës dhe të llojllojshëm në varësi të drejtimit që shikohet. Kjo, mundësohet falë vlerave të ndryshme të trashëguara, me specifika të krijuara dhe të trashëguara natyrore (të pyjeve, kullosave, livadheve, arave, e të tjera) ashtu edhe të veçorive gjeografike, morfologjike, të relievit, luginave lumore dhe fenomeneve hidro-gjeologjike.



Foto 5. Peizazhe natyrore nga Rrasa Koshares (majtas - 1385 mlm) dhe tek Karakolli (djathtas). Burimi: IPH / MMPH

Sigurisht që edhe zona e veçantë e Memorialit të Koshares, mund të krenohet me pika të tilla për vrojtim të peizazhit, sikur që vihet re edhe nga pikat me lartësi të mesme si në foton 5. Mirëpo, mundësia dhe kënaqësia akoma më e madhe e përjetimit të peizazheve më të spikatura, ofrohet në varësi të pozicioneve të vendvrojimit, kur shikohet nga pikat më të ulëta dhe më të larta. Këtu, vlen të theksohen peizazhet, që përjetojnë që nga qasja për në zonë, nga pikat më të ulëta prej anës Lindore (nga Rrafshi i Dukagjinit) duke shikuar kah Veri - Perëndimi në drejtim të bregoreve dhe majave të larta ashtu edhe nga majat e larta malore në drejtim të luginave dhe ultësirave.

1.7.2. Flora dhe Vegjetacioni

Në zonën e mbrojtur dhe e interesit të veçantë “Beteja e Koshares”, e cila i takon masivit malor të Bjeshkëve të Nemuna, mbizotëron klimë kontinentale dhe sub-mesdhetare, duke krijuar një kompleks të ndërlikuar të kushteve ekologjike për paraqitjen, ekzistencën dhe zhvillimin e larmisë biologjike (biodiverstetit). Pjesa më e madhe e zonës është e mbuluar me pyje, që luajnë rol të rëndësishëm për ekonominë lokale, si drunjtë, shkurre dhe bimë barishtore, ndër të cilat një numër i madh i tyre janë relikte, endemo-relikte dhe endemike.

Bimët barishtore (foto 6) të cilat gjenden në këtë zonë janë: Bishpelëza gjethendryshme (*Festuca heterophylla*), Telishi (*Dactylis glomerata*), Veronika dushkvogël (*Veronica chamaedrys*), Xherolloku vjeshitora (*Colchium autumnale*), Dredhëza (*Fragaria vesca*), Klinopodi i rëndomtë (*Clinopodium vulgare*), Shpendra (*Helloborus odoratus*), Bjelisha njëlulëshe (*Melica uniflora*), etj.



Foto 6. Veronika dushkvogël, Bari i peshkut tapsus dhe Xherolloku vjeshtor. Burimi: IPH / MMPH.

Në aspektin e shtrirjes vertikale të vegetacionit (foto 7), pjesën më të madhe e përfshinë vegetacioni gjetherënës. Në pyjet gjetherënëse dominojnë: Dushku (*Quercus*), Ahu (*Fagetum montanum*), Gështenja (*Aesculus hippocastanum*) dhe Frashëri (*Fraxinus ornus*). Kurse, në pyjet gjethembajtëse dominojnë: Bredhi (*Abies alba*), Hormoqi (*Picea abies*), Rrobulli (*Pinus heldreichii*) dhe Arneni (*Pinus peuce*).




Foto 7. Dushku, Gështenja dhe Arneni. Burimi: IPH/MMPH.

1.7.3. Fauna

Kushtet klimatike dhe relievore në këtë pjesë ofrojnë mundësi të favorshme për ekzistencën dhe përhapjen e një numrit të madh të llojeve shtazore në këtë hapësirë. Llojet e faunës që jetojnë në këtë territor janë: Rrëqebulli (*Lynx lynx*), Ariu i murrmë (*Ursus arctos*), Ujku (*Canis lupus*), Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), Kaprolli (*Capreolus capreolus*), Shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos* - foto 8), Shqiponja perandorake (*Aquila heliaca*), Falkoi thonj-bardhë (*Falco naummani*), Petriti (*Accipiter gentilis*), Pulë-egra (*Tetrao urogallus*), etj, të cilat kanë status kombëtar dhe ndërkombëtar të mbrojtjes.

Foto 8. Shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*). Burimi: Internet¹⁰



Në këtë zonë jetojnë gjithashtu një numër i madh i Ujë-tokësorëve (*Amphibia*), Zvarranikëve (*Reptilia*), familje si: *Testudinae*, *Lacertidae*, *Anguidae*, *Viperidae*, *Colubrinae*, si dhe shumë lloje të zogjve të egër e të lakuriqëve (*Hiropterat*).

¹⁰ <http://www.nhpto.org/wild/forthebirds/falcons.asp>


Trashëgimia natyrore

Zona e Memorialit të Koshares, për shkak të vlerave dhe resurseve të shumta natyrore, si të peizazheve atraktive, formave të ndryshme morfologjike, ndërtimit specifik gjeologjik, baseneve (aquifere) nëntokësore dhe burime të ndryshme ujore, llojlojshmërisë së tokave dhe të një gjeo-trashëgimie të rëndësishme, paraqet një regjion me mundësi reale për zhvillim të saj dhe të karakteristikave tjera funksionale hapësinore.

Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, si kategori e II-të sipas IUCN-it, ka vise të tëra me vlera të begatshme të natyrës dhe të peizazhit, që përfshinë dhe nënkupton funksionimin dhe ruajtjen e ekosistemeve më të spikatura dhe të rariteteve natyrore brenda hapësirës vet (fig.16).

Mbrojtja e këtyre vlerave, nuk do të ndaloj shfrytëzimin e tyre, por i njëjti duhet të jetë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, me motiv kulturor, edukativ - arsimor - shkencor dhe turistik. Natyrisht që vlerat turistike në Parkun Kombëtar begatohet edhe më shumë me Legjenden historike “Beteja e Koshares”.

Figura 16. Harta e trashëgimisë natyrore, kulturore e historike dhe majat malore si pika për vrojtje të peizazhit. Burimi: IPH/MMPH



1.7.4. Trashëgimia historike

Depërtimi i Brigadës 138 Agim Ramadani në territorin e Kosovës (i njohur si operacioni me emrin “Dita D” - e thyerjes së kufirit mes R. Shqipërisë dhe R. Serbisë e Malit Zi) si dhe luftimet e zhvilluara në zonën e Koshares janë nga vlerat më të rëndësishme të trashëgimisë historike, të kulturës më të re të sakrificës dhe rezistencës popullore dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Beteja e Koshares, me luftimet e pandërprera për 77 ditë, që filluan me 09 Prill 1999 dhe u zhvilluan në një zonë fronti me gjerësi rreth 22 km të vijës së kufirit dhe në thellësi deri në 7 km në brendi të vendit, përfunduan me 19 Qershor 1999. Për më gjerësisht mbi luftën në Koshare, e gjejmë në “Raportin mbi historikun e Brigadës 138 Agim Ramadani” 2011, në të cilë ranë 114 Dëshmorë të Kombit (varrezat e përbashkëta në foton 9) dhe u plagosen 423 luftëtarë nga radhët e saj, përderisa mendohet që humbjet nga forcat armike, edhe pse nuk janë deklaruar janë të shumëfishta.



Foto 9. Gjendja aktuale e Varrezave të Dëshmorëve në Koshare. Burimi: IPH / MMPH 2011

1.7.5. Trashëgimia Arkeologjike (Lashtësia)

Kërkimet arkeologjike në Kosovë, në kuadrin e ekspeditave përnjohëse gjatë viteve 2000 – 2006, treguan për një dendësi vendbanimesh me tipare të ndryshme (castrum, kështjella apo fortesa), që kishin ndodhur në rajonin që përfshinte pellgu i Drinit të Bardhë si dhe në rajonet e lumenjve tjerë si degë të tij: Lumëbardhët e Pejës, Deçanit e të Prizrenit, lumit të Istogut e të Klinës, Mirushës së Malishevës dhe Erenikut të Gjakovës.

Në hartën e shkëputur nga “Harta Arkeologjike e Kosovës I” (fig. 17), shihen gjurmë të qytetërimit të lashtë, në mesin e të cilave edhe Fortesa mesjetare e Jerinës. Fortesa ishte ngritur në kodrën e Rrasë e Koshares duke krijuar një rrethim gjatësor lindje-perëndim, me përmasat gjatësore rreth 190.0 dhe gjerësi prej 2.0 deri në 20.0 m, e cila kishte mbrojtje të sigurt natyrore dhe për raste rreziku. Bazuar në materialin e gjetur e në dispozicion është vështirë të përcaktohet koha e ndërtimit. Përpos hulumtimeve fillestare, nga arkeologët e njohur shqiptarë dhe kosovarë, deri më tani nuk ka ndonjë investim tjetër të veçantë në punët kërkimore për gjetjen e mureve dhe konsolidimin e strukturës së kësaj Fortese.

Figura 17. Harta arkeologjike për Rr. e Dukagjinit. Burimi: “Harta Arkeologjike...”¹¹.



¹¹ L. Përzhita, K. Luci, G. Hoxha. *Harta Arkeologjike e Kosovës - I*, 2006 Prishtinë.




Në ditën e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës (më 17.02.2008), anëtarët e Shoqatës Beshkatore – Alpine “Pashtriku”, në pikën strategjike në Rrasë të Koshares vendosën pllakën përkujtimore për Fortesën e Jerinës, në shenjë simboli të lashtësisë dhe qëndresës së regjionit të Gjakovës dhe të Kosovës (foto 11).

Foto 11. Pllaka përkujtimore për Fortesën e Jerinës në Rrasë të Koshares. Burimi: IPH/MMPH.


1.7.6. Trashëgimia Shpirtërore (Kulti)

Në brendi të kësaj zone, pikërisht në fshatin Koshare, përbri rrugës për në Varrezat e Dëshmorëve, gjendet një objekt i kultit - Tyrbja e sektit Sheit (foto 11).

Foto 11. Tyrbja në zonën e veçantë. Burimi: IPH / MMPH



Ndërsa, ndër 14 pikat e Kultit në trojet Shqiptare, të njohura si Majat e Diellit, si në hartën e N.Sh. “Gjeodezia” - Gjakovë¹² (pjesë e shkëputur e së cilës është paraqitur në fig.18), shihet qartë se më të afërtat me këtë zonë të veçantë, ndodhen dy sosh në krahinën e Tropojës - Shqipëri, në Beshkët e Nemuna në Majën e Hekurave dhe në Majën e Shkëlzenit si dhe një në Majën e Pashtrikut në Kosovë, të cilat vizitohen në ditë të caktuara për rituale fetare.



Majat e Diellit Kulti në trojet Shqiptare

1. Maja e Hekurave - Peqës 2561m/lmd
Pozita gjeografike N 42°23'06" E 19°58'10"
Beshkët e Nemuna
Komuna Margegaj - Tropojë Shqipëri
2. Maja e Lybetenit 2498m/lmd
Pozita gjeografike N 42°12'24" E 21°07'10"
Beshka e Sharrit - kufiri Kosovë - Mk.
Komuna Kaçanik(Kosovë)-Tetovë(Mk.)
3. Maja e Gjallicës 2486 m/lmd
Pozita gjeografike N 42°00'42" E 20°28'10"
Beshka e Gjallicës
Komuna Kukës - Shqipëri
4. Maja e Shkëlzenit 2407m/lmd
Pozita gjeografike N 42°27'26" E 20°07'43"
Beshkët e Nemuna
Komuna Tropojë - Shqipëri

Figura 18. Pjesë e hartës me “Majat e Diellit” – kultit në trojet Shqiptare. Burimi: N.Sh. “Gjeodezia” Gjakovë.

¹² Ndërmarrja Shoqërore “Gjeodezia” - Gjakovë. Harta: Majat e Diellit – Kulti në trojet Shqiptare. Hartë e prezantuar në takimin e Shoqatës së Gjeodetëve Mbarëkombëtar më 2013 në Tiranë.

1.7.7. Trashëgimia Arkitektonike Tradicionale (autoktone)

Rrafshi i Dukagjinit karakterizohet me kullat e ndërtuara prej guri, që janë ndërtime tradicionale autoktone dhe të papërsëritshme jo vetëm në rajonin e Ballkanit por dhe më gjerë. Këto ishin shtëpitë karakteristike, të cilat shërbenin për banim dhe zakonisht kishin mure të forta nga guri, dritare të vogla dhe pozitë strategjike për mbrojtje. Kullat e gurit zakonisht kanë nga dy ose tri kate. Kulla të tilla dhe shtëpi banimi prej guri gjenden edhe në fshatin Koshare brenda ZIV (si në foto 12), të cilat për fat të keq janë të dëmtuara gjatë luftës dhe mbeten të pa trajtuara duke pritur rikthimin e pronarëve e që mbeten nën ndikimin e faktorëve të shumtë klimatologjik, për pasojë kanë shkatërrimin e tyre dhe humbjen e gjurmëve të trashëgimisë arkitektonike.



Foto 12. Kullat prej gurit të (akoma të pa rindërtuara) në fshatin Koshare. Burimi: IPH / MMPH

Në hapësirën qendrore, më të koncentruar të objekteve të ndërtuara, të fshatit të shpërndarë të Koshares, gjenden edhe objekte të trashëgimisë tradicionale (vernakulare), të ndërtimit autokton të shtëpive – kullave prej guri. Të gjitha objektet në fshatin Koshare, duke e përjashtuar objektin e tyrbes, akoma nuk janë rindërtuar dhe ngelen duke pritur rikthimin e banorëve që janë pronarë të objekteve dhe të pasurive të patundshme në fshat.

Kullat që datojnë nga shek 18 dhe shek 19 janë karakteristikë e pjesës perëndimore të Kosovës si dhe pjesës veriore të Shqipërisë. Në hapësirën për rreth zonës së interesit veçantë, në vendbanimet më të afërta si Batushë, Brovinë, Mulliq, Ponoshec, Morinë, Gjocaj, Jasiq dhe Junik, shumica e kullave janë dëmtuar gjatë luftës, mirëpo disa prej tyre tanimë janë restauruar (siç shihet edhe në foto 13). Këto kulla, janë të nevojshme dhe mundësojnë pranimin, akomodimin, pushimin, ushqimin dhe takimin e grupeve të mysafirëve potencial, të cilët janë të interesuar të vizitojnë zonën me rrethinë, në mënyrë që hapësira e saj të kursehet nga ndërtimet dhe zhvillimet tjera të panevojshme për këtë qëllim.





Foto 13. Kullat prej gurit të rindërtuara në Batushë majtas) dhe Junik (djathtas). Burimi: IPH / MMPH

1.8. INFRASTRUKTURA DHE ZHVILLIMI SOCIO - EKONOMIK

1.8.1. Infrastruktura dhe shërbimet teknike

Qasjet dhe arritja në zonë. - Qasja për në Zonë, nga të gjitha qendrat komunale të Kosovës, me gjatësi maksimale rreth 120 km nga ajo më e largëta, është lehtë e arritshme. Nga kryeqendra Prishtina me Aeroport Civil Ndërkombëtar “Adem Jashari”- Sllatinë dhe Stacion qendror Hekurudhor në Fushë Kosovë janë rreth 100 km. Pikërisht në skajin më jugor të zonës, gjendet vend kalimi kufitar me Shqipërinë në afërsi të fshatit Morinë, që mundëson qasje më të lehtë për vizitorët që vijnë përmes kësaj Republike.



Arritja deri në Gjakovë, mundësohet përmes Auto-udhës “Ibrahim Rugova” me largësi rreth 55 km si dhe degëzimin M 25 (Ferizaj - Prizren - Vërmicë me nën degëzimin R 107) dhe degëzimin M 9.1 (Klinë - Gjakovë - Ponoshec - Morinë), të rrugëve magjistrale - kombëtare M 2 (Prishtinë - Ferizaj - Shkup) përkatësisht M 9 (Prishtinë - Klinë - Pejë). Prej Prizrenit, në dalje të auto-udhës ose të degëzimit M 25, ndërton drejtim dhe merr rrugën rajonale R 107 (Prizren - Gjakovë - Deçan - Pejë), me të cilën arrihet edhe në Junik përmes rrugës R 202.

Në zonën e veçantë të Memorialit “Beteja e Koshares” (si në fig. 19), arrihet përmes rrugës R 109 (Ponoshec - Batushë - Junik - Deçan), që është degëzim i rrugës M 9.1 nga magjistralla M 9 si dhe degëzim i rrugës rajonale R 107 nga magjistralla M25 / M2. Në fund, rrugët malore të pa asfaltuara, që mundësojnë qasje të vështirësuar për në kompleksin e Varrezave të Dëshmorëve, realizohet nga dy drejtime: nga ana veri-lindore përmes fshatit Jasiq - Komuna e Junikut dhe nga ana lindore përmes fshatit Batushë - Komuna e Gjakovës.

Figura 19. Harta e shtrirjes së rrugëve dhe qasja në zonë. Burimi: MMPH /IPH

Infrastruktura rrugore. - që siguron qasje të drejtpërdrejtë deri në qendër të zonës së interesit veçantë apo tek Varrezat e Dëshmorëve, të rënë në “Betejën e Koshares”, është mundësuar përmes rrugës së re të hapur, që fillon nga fshati Batushë dhe përfundon tek kompleksi “Varrezat e Dëshmorëve” në Koshare, është me gjatësi L= 7.9 km. Kjo rrugë është qasja e vetme për arritje deri në qendër të Memorialit të Koshares me automjete të udhëtarëve dhe për përdorim të përgjithshëm. Përkundër faktit se në disa vende paraqitet edhe rreziku nga shembja e dheut, në mihjet dhe mbushjet anësore, vazhdimisht bëhen përpjekje në zvogëlimin e rrezikut dhe stabilizimin e trasesë së rrugës.

Rruga Batushë – Koshare është e asfaltuar në gjatësi prej 2.280 m, kurse pjesa tjetër, në gjatësi prej 5.620 m, është me tampon prej zhavorri dhe e përgatitur për shtruarje finale (shih foto 14). Nga MI (Ministria e Infrastrukturës ose ish MTPT - Ministra e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit), deri më tani, janë investuar diku rreth 2.0 milion Euro. Meqë e njëjta nuk mirëmbahet sa duhet, në disa pika (segmente) të saj ka tendencë të rrëshqitjes së skarpateve (brigjeve), kur mund të vihet në rrezik edhe ndërprerja e zhvillimit të komunikacionit (rrezikimit të pjesëmarrësve në komunikacion).



Foto 14. Rruga me tampon për Varreza të Dëshmorëve dhe rrugë pyjore në zonën e Memorialit. Burimi: IPH / MMPH

Në Memorialin e Koshares, janë të hapura disa shtigje rrugore nga ekonomia pyjore (shih foto 14), të cilat nuk janë në gjendje të mirë dhe nuk mund të shfrytëzohen për lëvizje të automjeteve të udhëtarëve pa ndonjë intervenim apo mirëmbajtje shtesë. Po ashtu, janë të hapura disa shtigje për këmbësor, me gjerësi rreth dy (2) metra, përmes të cilave mund të arrihet në pikat dhe lokacionet më interesante dhe me rëndësi të veçantë në gjithë Memorialin. Për momentin këto shtigje nuk mund të shfrytëzohen për përdorim të përgjithshëm.

Transporti.- për në zonë të veçantë nuk është i sistemuar. Përveç vizitave të organizuara me grupe të interesuara dhe me rastin e përkujtimit të Dëshmorëve akoma është në varësi të kapaciteteve individuale.

Sistemi i Ujësjellësit dhe kanalizimit.- në zonë dhe në vetë fshatin e Koshares nuk ka qenë i shtrirë në një sistem të organizuar për nevojat e fshatit, duke përjashtuar sistemin e ujësjellësit të ndërtuar prej ish Armatës Jugosllave, me tubacione nga burimi, përmes impianteve nga betoni si në foto 15, deri në objektet ushtarake (të patrullës dhe karakollit) kufitare. Banorët e fshatit në mënyrë të njëjtë por individuale kanë siguruar ujin e pijshëm nga burime të shumta në zonë. Kurse trajtimi dhe largimin e ujërave të zeza është bërë përmes gropave septike (foto 15) dhe kanaleve deri në rrjedhat më të afërta lumore.

Grumbullimi dhe Largimi i Mbeturinave, - nuk është i organizuar në fshat dhe zonën e gjerë të Koshares, përveç dy pikave me kontejner, ku mund të hedhen ato nga vizitorët. Njëri gjendet afër Varrezave të Dëshmorëve, gjendja e të cilit shihet në foto 15, kurse tjetri në lokalet e Rest.“Katana”.

Sistemi Elektrik, - është prezentë në zonë, në kuadër të sistemit të vjetruar ekzistues të furnizimit me energji elektrike, për nevoja të fshatit dhe objekteve ushtarake kufitare, me shtylla druri dhe kablllo teli (foto 15). Ky sistem, ajrore të tensionit 220 V, me rastin e ndërtimit të kompleksit të memorialit dhe kampi ka nevojë për zgjerim dhe ndërrim të fijeve përçuese si dhe vendosjen e trafo-stacioneve shpërndarëse.


Telekomunikimi përmes valëve difuzive, - është i pranishëm në zonë, me vendosjen së antenave valë-shpërndarëse në afërsi të mjaftueshme për të mbuluar hapësirën e saj. Mirëpo, kohëve të fundit, gjatë vizitave të grupit punues dhe përdorimi i telefonisë mobile nga operatorë të Kosovës në zonën e veçantë, del të jetë më i kushtueshëm, nga që territori i saj, është i mbuluar nga valët më të fuqishme difuzive të rrjetit të operatorëve nga shteti fqinjë.

Foto 15. Burim natyror uji dhe impiant dy-hapësinor nga betoni, gropa septike, kontejneri për mbeturina dhe shtylla prej druri për përçim ajror të energjisë elektrike në zonë. Burimi IPH / MMPH



1.8.2. Zhvillimi socio - ekonomik

Ndërlidhja apo implikimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë me vendbanimet në zonën e mbrojtur e të interesit veçantë “Beteja e Koshares” dhe për rreth saj mund të vërehen edhe në hartë (si në fig. 20).



Brenda zonës së Memorialit, gjendet fshati Koshare, tanimë i boshatisur, ngase banorët e këtij vendbanimi janë shpërngulur që në vitin 1998. Meqë, asnjë nga banorët e këtij fshati nuk është kthyer për të zhvilluar veprimtari normale jetësore, prandaj edhe të gjitha objektet ekzistuese janë të shkatërruara dhe në gjendje jo të mirë fizike.

Figura 20. Harta e vendbanime në zonë dhe për rreth Memorialit. Burimi: IPH / MMPH

Vendbanimet më të afërta, të cilat mund të ofrojnë shërbime dhe do të përfitonin nga vizitorët e kësaj zone, janë Batusha, Brovina, Mulliqi, Ponošeci, Morina (nga komuna e Gjakovës) dhe Jasiqi, Gjoçaj e Juniku (nga komuna e Junikut).

Në kuadër të kësaj zone, ekzistojnë hapësira të përshtatshme për kullosa, mirëpo ato po shfrytëzohen nga disa familje dhe blegtorë të Republikës së Shqipërisë, të cilët kanë ndërtuar edhe stanet e përkohshme për bagëtitë e tyre, në mënyrë ilegale (foto 16).

Restoranti “Katana, i cili gjendet në hyrje të zonës përkaj lumit Gusha, është i vetmi objekt turistik me karakter hotelier, që i ofron mysafirëve ushqim, freskim dhe pushim para apo pas vizitës së kësaj zone.




Foto 16. Pamje e një stani në zonë së veçantë dhe Restoranti “Katana” në hyrje të Memorialit. Burimi: IPH / MMPH.

1.10. ZONA E MEMORIALIT NË KONTEKST TË PLANIFIKIMIT

Implikimi apo ndërlidhja hapësinore e zonës së veçantë (Memorialit) “Beteja e Koshares”, në kontekst me plane të nivelit qendror, gjendet në Planin Hapësinor të Kosovës (PHK 2010 – 2020, fig. 21), sipas të cilit përcaktohet qartë lista e zonave të veçanta dhe mundësia për shpalljen e zonave të reja me interes për Kosovën, për të cilat duhet edhe të hartohet Plani.




Figura 21. Harta e strategjisë në PHK 2010 – 2020. Burimi IPH / MMPH

Kurse, sa i përket implikimit hapësinor në kontekst me planet e nivelit lokal, në PZHK-të e Gjakovës e të Junikut, fatkeqësisht, zona në fjalë as që është trajtuar fare. Sipas këtyre dokumenteve, vetëm zona e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, pjesë e së cilës është edhe zona e Memorialit të Koshares, preferohet të shndërrohet në atraksion dhe pjesë e produkteve turistike, jo vetëm për dy komuna e përmendura por për mbarë Kosovën.

Sa i përket ndikimeve hapësinore ndërshtetërore, ekzistojnë iniciativa të përbashkëta, akoma jo zyrtare, për bashkëpunim ndërkufitarë, mes OJQ-ve të dy vendeve, nga Shqipëria (Bajram Curri e Tropoja) dhe Kosova (Gjakova e Juniku).

1.11. VLERËSIMI I KAPACITETEVE TË INVESTIMIT

Me qëllim të realizimit të zhvillimeve të nevojshme në Zonën e Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë "Beteja e Koshares", në kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën trevjeçare 2012 – 2014, nga Buxheti i Kosovës, janë vlerësuar dhe rezervuar mjetet financiare prej rreth 900.000 € (Euro). Nga kjo shumë totale, në vitin 2012, për hartim të Planit Hapësinor dhe të Detyrës Projektuese si dhe për hapjen e Konkursit Ideor dhe hartimin e Planit Rregullues Urban janë shpenzuar 195.000 €. Kurse, gjatë dy viteve tjera në vazhdim, janë planifikuar të shpenzohen në vitin 2013 edhe 200.000 €, përkatësisht 500.000 € në vitin 2014. Përveç kësaj, për këtë qëllim, janë ndarë mjete donacioni edhe nga dy Fondet Kosovare "UFORK (Unioni i Fondeve për Rindërtimin e Kosovës)" dhe "Begjet Pacolli" me shumë të përbashkët prej rreth 40.000 €.

Në vazhdim, është dhënë një pasqyrë e përafërt e kapacitetit buxhetor, të paraqitur ndaras, për nga investimi i realizuar deri më tani dhe atij të nevojshëm (planifikuar) për qasje dhe lëvizshmëri (mobilitet) në zonë.

Realizimi i investimeve / të shpenzuara deri më tani, është rreth 2.2 milion Euro (€):

- Nga Komuna e Gjakovës, me qëllim të shpronësimit të pronave private në dobi të qasjes dhe rregullimit të hapësirës së nevojshme për varret e përkohshme të 114 Dëshmorëve të Kombit me rrethim, janë shpenzuar rreth një milion Euro (1.000.000 €).
- Nga Qeveria e Kosovës, nga MI (ish MTPT) me qëllim të rregullimit të rrugës (përfshirë tamponin) Batushë - Koshare janë shpenzuar rreth 2.000.000 €, kurse nga MMPH dhe Donacionet (Fondet: "UFORK" & "Begjet Pacolli") me qëllim të hapjes së konkursit ideor dhe kontraktimit të hartimit të PRRU-së janë shpenzuar rreth 195.000 €.

Investimi i nevojshëm për ndërtimin e Kompleksit dhe infrastrukturës rrugore, është rreth 6.0 milion Euro (€):

- Ndërtimi i Kompleksit të Memorialit me kosto prej rreth - 1.200.000 €;
- Kompletimi i rrugës ekzistuese Batushë - Koshare deri tek Varrezat e Dëshmorëve¹³ me kosto rreth 1.000.000 €;
- Ndërtimi i Rrugës me shtresë tamponi nga fshati - Jasiq - Gjocaj deri te Kompleksi i Memorialit në Koshare me gjatësi L=7,5 km¹⁴ me kosto prej rreth 1.500.000 €;
- Rikonstruktimi i disa rrugëve kryesore të ekonomisë pyjore¹⁵ me kosto prej rreth - 1.100.000 €;
- Ndërtimi i teleferikut prej Logut deri në Rrasë të Koshares me gjatësi rreth 1 km = 500.000 €; dhe
- Përcaktimi dhe realizimi (hapja dhe ndërtimi) i shtigjeve të reja për këmbësorë si dhe rindërtimi dhe rregullimi i segmenteve ekzistuese me mirëmbajtje¹⁶, sipas hollësive të Planit Rregullues me kosto të përafërt prej 700.000 €.

¹³ Ndërtimi i mureve mbrojtëse dhe përfundimi punimeve në mbi-strukturën e rrugës duke përfshirë edhe asfaltimin e pjesës së mbetur.

¹⁴ Gjerësia e asfaltit 5.5 m, bankinat 0.75 m, në pjesët ku traseja është në gërmim ose prerje duhet të parashihet rigolla nga betoni me gjerësi prej 0.75 m. Elementet horizontale dhe vertikale të trasesë duhet të projektohen për shpejtësinë llogaritëse $V_p = 50$ km/h dhe pjerrësi maksimale gjatësore të rrugës nën 8%. (7,5 km gjatësi x 180,000.00 – 200,000.00 €/km).

¹⁵ Rikonstruktimi i rrugëve pyjore duke përfshirë edhe shtresën e tamponit. Kjo është e nevojshme për lëvizjen e njerëzve brenda zonës së veçantë të Memorialit, përmes shtigjeve për këmbësor, për automjete zjarrfikëse dhe të terrenit (për të mundësuar edhe lëvizjen e atyre që nuk janë në gjendje të ecin), për motoçikleta dhe për kuaj, për në pikat më të rëndësishme, që sillen rreth 20 km X 55.000 €/km.

¹⁶ Hapja dhe shtruarja e shtegut të këmbësorëve me kube betoni / rrasa guri mbi tampon me gjerësi 1.7 m dhe gjatësi rreth 10 km (1.7 x10x 40.000,00 €/km).

Vlerësimi i kapacitetit investues / sipas Pozicioneve		Vlera për njësi	Vlera totale €
1	Ndërtimi i Kompleksit të Memorialit (sipas PRrU)	paushall	1.200.000
2	Kompletimi i rrugës Batushë - Koshare	paushall	1.000.000
3	Ndërtimi i rrugës Jasiq - Gjocaj - Koshare (7.5 km)	200.000/ km	1.500.000
4	Rikonstruktim i rrugëve kryesore (20 km me gjerësi 2.5 m)	55.000 / km	1.100.000
5	Ngritja e teleferikut Logu (Oplaz) - Rasë të Koshares (1 km)	500.000 / km	500.000
6	Hapja dhe shtruarja e shtegut të këmbësorëve (10 km me gjerësi 1.7 m) mbi tampon (me trashësi 15 +5 cm)	70.000 / km	700.000
Gjithsejtë (Euro) €:		-	6.000.000

1.12. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE - "SWOT"

Analiza SWOT, si vegël e ndërtuar mbi informatat që dalin nga Profili zhvillimor, të bazuara në dokumente relevante, intervista të ndryshme dhe dalje të anëtarëve të GPNI-së në teren (foto 12), jep një pasqyrë më të qartë të rezultateve mbi gjendjen ekzistuese (faktike) të zonës dhe për mundësitë e zhvillimit të ardhshëm të saj. Kjo analizë, më konkretisht, përcakton diagnozën e problemeve të krijuara gjatë zhvillimit të gjertanishëm dhe ndihmon shumë në përcaktimin e veprimeve strategjike për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të zonës.

Përparësitë

- Shpallja me Vendim nga Qeveria e Republikës së Kosovës "e hapësirës ku u zhvillua Beteja e Koshares nga Brigada 138 Agim Ramadani" për "Zonë të Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë";
- Zonë dhe vend i sakrificës dhe rezistencës gjatë ngjarjeve të vitit 1999;
- Pjesë përbërëse e PK "Bjeshkët e Nemuna" dhe afërsia me pikat tjera turistike;
- Pozita e përshtatshme gjeografike;
- Zonë me mjedis të pastër kodrinor - malor, me burime ujore, biomasë dhe pyje të larta e të shëndosha;
- Zonë e pasur me pyje halore dhe larmi biologjike të zhvilluar;
- Zonë me vlera tërheqëse të peizazhit natyror;
- Prezenca e pikës arkeologjike e evidentuar në listën e trashëgimisë në MKRS;
- Zonë e pasur me kullosa dhe livadhe;
- Kushte të mira për zhvillimin e blegtorisë e bletarisë, kultivim bujqësor të gështenjës e të fasules si dhe grumbullimin e frutave malore e të bimëve mjekuese;
- Kushte të përshtatshme klimatike (për shëndet, sport dhe rekreacion);
- Afërsia me Liqenin e Radoniqit;
- Afërsia me qytetin e Gjakovës;
- Afërsia me Aeroportin e Gjakovës;
- Ruajtja e zonës së Kompleksit të Memorialit nga zhvillimet e pakontrolluara;
- Qasje e mirë nga Batusha deri tek Varrezat e Dëshmorëve;
- Prezenca e shoqatës së bjeshkatarëve dhe trurit të anëtarësisë saj;

Dobësitë

- Mungesë e përkujdesjes së mjaftueshme institucionale për vlerat e zonës;
- Mos hartimi i Planit për Menaxhim të zonës si dhe atij Rregullues Urban për hapësirën e ngushtë në qendër të saj;
- Mungesa e organit kompetent për menaxhim të zonës;
- Mungesa e zyrës informative, hartës turistike dhe të shenjësimit për zonën dhe rrethinën e saj;
- Mos përfundimi i punëve finale në rrugën Batushë – Koshare;
- Qasje e rrezikuar nga rrëshqitja e dheut tek mbushjet dhe me pluhur në rrugën Batushë – Koshare;
- Qasje e vështirësuar për në zonë nga drejtimi Junik – Jasiq – Koshare;
- Infrastrukturë dhe shërbime të pamjaftueshme teknike;
- Mosshfrytëzim i ujit për pije nga burimet natyrore në zonë;
- Ndodhja dhe zhvillimi i aktivitetit të gurëthyesit në zonë;
- Prania e sipërfaqeve me Erozion të intensitet të lartë;
- Shfrytëzimi i pakontrolluar i kullësive të zonës nga barinjët dhe familje endacake;
- Mosshfrytëzimi i potencialit mjedisor për kultivim të prodhimeve bujqësore, malore, mjekësore dhe nga blegtoaria;

Mundësitë

- Investimi i Qeverisë për të hartuar Planin Rregullues Urban si dhe ngritjen e Kompleksit Memorial në Logun e Koshares me konservim të gjendjes së vitit 1999 në Rrasën e Koshares;
- Interesimi i qeverisë për promovim dhe shfrytëzim të potencialit të peizazhit, larmisë biologjike dhe të trashëgimisë natyrore e kulturore në zonë dhe për rreth saj;
- Vullneti i mirë i Qeverisë dhe KPMM-së për largimin e gurëthyesit nga zona dhe rehabilitimin mjedisor të sipërfaqes së shfrytëzuar;
- Interesimi për riaktivizimin e rrugës së vjetër për në zonën e Tropojës përkaj ish objektit të karakollit;
- Iniciativa për projekte në shfrytëzim të vlerave dhe potencialit hapësinor të zonës në favor të zhvillimit të rekreacionit dhe shëndetit të mirë njerëzor si dhe bashkëpunimit ndërkufitar;
- Zhvillimi i bizneseve familjare (bletaria e të tjera);
- Stimulimi i fermerëve, përmes politikave të qarta, në favor të ngritjes cilësore të rendimentit të fasules së rrallë, në zonë dhe për rreth saj;
- Iniciativa nga shoqëria civile dhe PPP për hartimin e projekteve dhe ngritjen e kampingjeve si dhe zhvillimin e turizmit ekologjik;
- Hartimi dhe zbatimi i projekteve për rregullimin e shtigjeve me vendpushime dhe kroje përgjatë tyre;
- Ngritja e impiantit dhe rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit për kompleksin e memorialit dhe vend-kampingjet;
- Sigurimi dhe zbatimi i projekteve për përfitimin e energjisë elektrike përmes shfrytëzimit të potencialit solar dhe burimit ujor për nevoja të zonës,
- Klasifikimi, bartja dhe riciklimi i mbeturinave,

Kërcënimet / Rreziqet

- Mos-zbatimi i investimeve nga ana e Qeverisë në ZMIV - Humbja e vlerave kulturore - historike të luftës së UÇK-së;
- Mos zbatimi i planeve hapësinore dhe rregullues për zonën e mbrojtur dhe me interes të veçantë "Beteja e Koshares";
- Mos-hartimi i politikave të qarta për zhvillimin e zonave rurale nga Qeveria;
- Mos-përpilimi i agjendave joshëse turistike për vizitave individuale dhe grupe për njohjen dhe përjetimin e vlerave në zonë dhe për rreth saj;
- Mos-promovimi i vlerave dhe potencialit hapësinor të zonës me rrethinë;
- Joshja më atraktive turistike nga vendet fqinje për viset me vlera të ngjashme;
- Neglizhenca institucionale dhe e PPP-së për aplikimin e trendit ndërkombëtar për avancimin e zonave të mbrojtura natyrore;
- Mungesa e sigurimit të investimeve nga fondet e jashtme si pasojë e problemeve politike;
- Vazhdimi i veprimtarisë së Gurëthyesit dhe mos rehabilitimi mjedisor i zonës së degraduar, dhe
- Rrëshqitja e dheut nga ndikimet e faktorëve natyrore-klimatike dhe njeriut (prerja e drunjëve dhe mos ndërtimi i bankinave prej betoni përkaj rrugës kryesore në zonë).

1.13. SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT

Nga trajtimi dhe analiza e bërë mbi gjendjen dhe situatën ekzistuese të zhvillimit hapësinor – profilin dolën probleme dhe çështje të ndryshme të identifikuara. Këto probleme, të grupuara sipas fushave përkatëse tematike, u bashkërenditen në tri (3) Sfida Kryesore të Zhvillimit të zonës “Beteja e Koshares”, si në vijim:

Sfida 1: “Përkujdesja ndaj vlerave të trashëguara historike, kulturore e natyrore”

Sfida 2: “Sigurimi i infrastrukturës fizike në zonë”

Sfida 3: “Shfrytëzimi i zonës historike të Koshares për zhvillimin e turizmit kulturor, rural dhe rekreativ”

Sfida 1: “Përkujdesja ndaj vlerave të trashëguara historike, kulturore e natyrore”

Vetë niveli i përkujdesjes Institucionale dhe publike ndaj vlerave të theksuara, të sakrificës së pjesëmarrësve në Betejën e Koshares si dhe vlerave të trashëguara dhe resurseve natyrore në zonë paraqet një sfidë të madhe që kërkon ndërjegjësim dhe vullnet moral e politik si dhe mjete të konsiderueshme buxhetore për realizimin e saj meritore.

Përkundër buxhetit të vogël, një përkujdesje ndaj hapësirës së Memorialit të Koshares (akoma të pa shpallur për zonë të veçantë), nuk ka munguar nga niveli lokal dhe qendror. Shpronësimi i pronës private, për hapësirën e nevojshme për varrosjen e 114 Dëshmorëve të Kombit dhe rrethimi saj me tela gjembor, si dhe hapja dhe shtruarja e rrugës nga fshati Batushë deri në Logun e Koshares, prej rreth 8 km (2 km me asfalt dhe 6 km me tampon prej zhavorri) që siguron qasje deri tek Varrezat, janë realizuar nga KK Gjakovë dhe MI (ish MTPT), që rezultojnë të pamjaftueshme në krahasim me sakrificën e bijve tanë për liri.

Mirëpo, tani, që hapësira ku u zhvillua “Beteja e Koshares” është shpallur Zonë e mbrojtur dhe me interes të veçantë, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, shpresojmë që përkujdesja do të jetë shumë më e shtuar dhe e nivelit të duhur. Kjo përkujdesje, ndaj vlerave të theksuara, fillimisht duhet të konsistojë, në përcaktimin e territorit të zonës së veçantë për hartimin e Planit Hapësinor si dhe ndarjen e hapësirave për ndërtimin dhe rregullimin adekuat si të Komplexit të Memorialit (në Logun e Koshares) me Elementet e përcaktuara gjegjëse ashtu dhe për konservimet e pikave strategjike të vitit 1999 (në Rrasën e Koshares dhe Karakollit).

Çështja më kryesore, në këtë sfidë, është realizimi i këtij zhvillimi (ndërtimi dhe rregullimi i hapësirës), i cili gjithsesi duhet bazuar në një Plan Rregullues Urban e jo të ndodh në mënyrë të paplanifikuar dhe të pakontrolluar. Po ashtu, çështje më vete është edhe hartimi i vet PRRU-së, që duhet të bazohet në Detyrën Projektuese të dhënë në konkursin ideor, të cilin duhet të hartoj Kompania e përzgjedhur konkurruese, përmes procedurave të prokurimit si dhe në bazë të poenëve vlerësues të anëtarëve të komisionit, për secilin elaborat të ofruar në konkurs, të organizuar dhe nën kompetencë të MMPH-së.

Përveç vlerave karakteristike kulturore – historike të luftës së UÇK-së gjatë viteve 1998/99, kjo zonë ka edhe vlera tjera mjedisore, si të peizazhit, të vrojtimit, të trashëgimisë arkeologjike e të kultit si dhe të trashëgimisë natyrore e larmisë biologjike. Nisur nga kjo dhe vlerësimi hartës së trashëgimisë, pothuaj, e gjithë zona e veçantë është dhe duhet trajtuar si pjesë e Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”. Prandaj, edhe një arsye më shumë se këtu kërkohet përkujdes edhe më i shtuar dhe sfidues, në përcaktimin e zonave të mbrojtura dhe atyre zhvillimore dhe të kampingut, në mënyrë që mos të rrezikohen vlerat dhe burimet natyrore si dhe ato të ndërtuara kulturore (arkeologjike, autoktone) e shpirtërore të trashëguara, që gjenden në zonën e veçantë dhe që joshin vizitorët potencial.

Sfida 2: "Sigurimi i infrastrukturës fizike në zonë"

Sikur që dihet, asnjë zonë që dedikohet për zhvillime të caktuara hapësinore në të, që janë qoftë në funksion të zhvillimit ekonomik përmes turizmit, qoftë në funksion të banimit apo funksione tjera, nuk mund të funksionojë pa siguruar infrastrukturën e nevojshme fizike.

Sigurimi i infrastrukturës fizike nënkupton mundësimin e qasjes së lehtë në të gjitha përmbajtjet e zonës përmes ndërtimit të rrugëve automobilistike dhe të shtigjeve për këmbësorë, kalërim, alpinizëm, etj.

Po ashtu, sigurimi i furnizimit me ujë të pijshëm përmes instalimit të sistemit të ujësjellësit dhe largimin e ujërave të zeza përmes instalimit të sistemit të kanalizimit, janë tjetër çështje për trajtim si nevojë e domosdoshme për zhvillimin e zonës.

Trajtimi i qasjes dhe furnizimit të rregullt me energji elektrike të përmbajtjeve ekzistuese dhe të reja të zonës përmes përmirësimit dhe ndërtimit të rrjetit të ri elektrik si dhe mundësimin e komunikimit të banorëve/vizitorëve të zonës me botën tjetër, është çështje tjetër sfiduese.

Zgjidhje për këtë duhet kërkuar përmes vendosjes në vende të planifikuara të antenave më të fuqishme të telefonisë mobile, instalimit të telefonisë fikse, sigurimit të Internetit në variantin pa tela dhe atë kabllor, vendosjes së antenave dhe instalimit të sistemit për pranimin e sinjalit televiziv ajror dhe kabllor.

Nga emërtimi i zonës së mbrojtur dhe me interes të veçantë "Beteja e Koshares" (ose Memoriali i Koshares) kuptohet se fjala është për një zonë që do të rregullohet në shenjë përkujtimi për Betejën e Koshares, të zhvilluar me lavdi, nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Përveç funksioneve për informim dhe ngritje të krenarisë kombëtare, kjo zonë natyrisht që do të jetë edhe në funksion të zhvillimit të turizmit, prandaj është e kuptueshme që, në mënyrë që të mund t'i ushtrojë këto funksione, aty duhet të ndërtohet infrastruktura e nevojshme fizike. Ideale do të kishte qenë nëse infrastruktura do të mund të kompletohej para se të fillojnë ndërtimet në zonë sepse kështu kostoja e ndërtimeve do të ishte më e ultë dhe objektet e porsandërtuara do të viheshin menjëherë në funksion.

Çfarë duhet bërë dhe pse infrastruktura është sfidë për shoqërinë kosovare?

Vizitorëve që shkojnë në zonë duhet t'u mundësohet një qasje e lehtë në të gjitha pikat që janë me interes të vizitohen, qoftë përmes rrugës automobilistike, qoftë përmes shtigjeve për këmbësorë apo edhe ndonjë mënyrë tjetër. Është e nevojshme që të zgjerohet rrjeti elektrik dhe të instalohen trafo-stacionet e nevojshme në mënyrë që ndërtesat që janë në zonë dhe banorët/vizitorët aty të mund të furnizohen me energji elektrike. Ndërtesat po ashtu duhet të lidhen në sistemin e ujësjellësit dhe atë të kanalizimit dhe banorëve që e frekuentojnë zonën t'u mundësohet komunikimi që do të thotë se duhet të sigurohet infrastruktura e telekomunikacionit. Mbrojtja e mjedisit nga ndotja me mbeturina të ngurta është shumë e rëndësishme për zonën, e cila si e ndotur nuk do të ishte atraktive për vizitorët, prandaj është e domosdoshme të sigurohet një menaxhim i duhur me këto mbeturina.

Realizimi i gjithë kësaj që u tha deri më tani kërkon përpjekje, veprim profesional dhe mjete të konsiderueshme financiare. Zhvillimi infrastrukturor i ndonjë zone rurale siç është kjo për të cilën është fjala, nuk do të kishte paraqitur ndonjë sfidë për ndonjë vend të zhvilluar, por për Kosovën si vend me një nivel dukshëm më të ultë të zhvillimit socio-ekonomik se sa të vendeve të zhvilluara e me mundësi të vogla investuese, ky zhvillim paraqet sfidë aq më tepër kur realiteti në Kosovë tregon se përparësi për zhvillim socio-ekonomik po u jepet zonave urbane. Këtë zhvillim e bën sfidë sidomos nevoja për ta siguruar një shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare e të cilat Kosova edhe nuk i ka me bollëk, por edhe ka po ashtu prioritete tjera ku duhet t'i derdhë ato.

Sfida 3: "Shfrytëzimi i zonës historike të Koshares për zhvillimin e turizmit rural, kulturor dhe rekreativ"

Në përgjithësi, ngritja e njohurive për vlerat e trashëgimisë natyrore dhe kulturore si dhe promovimi i tyre ndikon në krijimin e mundësisë për përfitime ekonomike. Burimet dhe vlerat natyrore me prezencën e trashëgimisë kulturore – historike në zonën e Koshares ndërlidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimin ekonomik të vendit, në këtë rast me sektorin e turizmit. Menaxhimi i këtyre burimeve natyrore dhe vlerave të trashëgimisë në zonë, në mbrojtjen dhe ruajtjen apo shfrytëzimin e tyre për zhvillimin e turizmit, është sfidë kyçe që ndikon në gjendje mjedisore, gjenerim ekonomik me rritjen të numrit të punësuarve si dhe në ngritjen e cilësisë së jetës së komunitetit.

Zona e Koshares mund të planifikohet për zhvillimin e turizmit në raport të ngushtë me mbrojtjen e vlerave natyrore e kulturore si kusht primar. Ky zhvillim, mund të kontribuoj në përfitime ekonomike, por mund të ndikoj edhe në rritjen e kërkesave për zhvillimin e zonës: ngritjen e kampingjeve, ngritjen e infrastrukturës, prodhimtarisë ekologjike (veprimtarive blegtorale dhe bujqësore) dhe ngritjen e masave për mbrojtjen e mjedisit.

Informimi i publikut për kontributin dhe sakrificën e dhënë në luftën e UÇK-së kundër forcave të okupatorit dhe promovimi i vlerave të shumta në zonën e interesit dhe për rreth saj është një sfidë që në vete ngërthen një mori ngjarjesh dhe aktivitetsesh.

Identifikimi i zonave të rrezikshme, prezenca e zonave të minuara me mjete shpërthyesë që kanë mbetur nga pasojat e luftës është një çështje problematike, prandaj siguria e vizitorëve, për mënyrën e lëvizjes së sigurt në zonë është sfidë që në të ardhmen kërkon një angazhim maksimal për të eliminuar këtë problematikë.

Relievi, pyjet dhe kullosat mundësojnë zhvillimin e turizmit malor ku mund të ofrohen shërbime turistike, në formë të turizmit sportiv (alpinizëm) dhe shëndetësor (bjeshkatar, qëndrim në natyrë, shëtitje, argëtim, etj). Ndërsa prezenca e objekteve trashëgimisë kulturore si dhe konservimi i objekteve të luftës së Koshares (istikamet, karakolli, guri kufitar, etj) ndikojnë në rritjen e interesimit dhe ngritjen e ofertës turistike.

Plotësimi i parakushteve për administrimin dhe menaxhimin e zonës si dhe ngritja e ofertës turistike, për banorët lokal mund të ofrojë mundësi për përfitime ekonomike familjare, ngritjen e numrit të punësuarve, si dhe mundësi të reja për zhvillimin e turizmit rural.

Afërsia e pikave të shumta turistike për-rreth, të cilat gjenden në një hapësirë territoriale (rajoni) me vlera të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, në Republikën e Kosovës (Komuna e Deçanit, Junikut, zona e vjetër e qytetit të Gjakovës, Aeroporti i Gjakovës, Maja e Gjeravicës dhe Liqeni i Radoniqit) dhe në Republikën e Shqipërisë (qyteti i Tropojës me rrethinën e tij, Maja e Shkëlzenit dhe Gryka e Valbonës si atraksion i veçantë turistik) mundëson krijimin e një zone turistike atraktive, me qendër zonën e Koshares e cila do të lidhë pikat për rreth. Prandaj, bashkëpunimi ndër-kufitar, mund të ndikoj drejtpërdrejtë, në zhvillimin e turizmit përmes plotësimit të ofertës turistike dhe paketë aranzhmaneve të përbashkëta, dhe në ngritjen e interesimit dhe të fluksit të vizitave në zonë dhe për rreth saj.

Qeveria nga niveli lokal dhe qendror, mund të mbështes banorët lokal, për ngritjen e kapaciteteve të reja për blegtori, bujqësi dhe për produkte ekologjike të cilat do të mund të ndikonin në zhvillimin e turizmit rural dhe gjenerimin vendeve të reja të punës, ku do të përfitojë jo vetëm zona për rreth kufirit por edhe Kosova në përgjithësi.

Lista e çështjeve (si probleme dhe mundësi) të identifikuara:

- Menaxhimi planifikimin dhe kontrollin e zhvillimeve në zonën e veçantë;
- Ruajtja dhe shfrytëzimi i vlerave mjedisore-natyrore dhe të trashëgimisë kulturore-historike;
- Shpronësimi i pronave private në zonën e ngushtë (të Varrezave dhe Istikameve)
- Ngritja dhe ndërtimi i Kompleksit të Memorialit i nivelit meritur me elemente gjegjëse sipas PRrU-së të hartuar në bazë të Detyrën Projektuese nga konkursi ideor;
- Risetësim i ngjarjes së vitit 1999 me konservim dhe ruajtje të pikave të rëndësishme të saj;
- Rritja e kapaciteteve të Muzeut në Gjakovë për luftën e UÇK-së përfshirë ekspozitat nga Beteja e Koshares
- Krijimi i zonës në pikë qendrore turistike dhe njëkohësisht urë lidhëse për të vizituar pikat më të njohura për rreth saj;
- Përcaktimi i rrugëve dhe shtigjeve si dhe materialit ndërtimor për shtresën finale sipas llojit dhe mënyrës së lëvizjes (mobilitetit);
- Mbrojtja e vlerave natyrore dhe kulturore dhe shfrytëzimi i tyre për zhvillimin e turizmit;
- Menaxhimi i të hyrave në zonë nga frekuentimi i vizitorëve;
- Organizimi i vizitave sipas programeve të përgatitura e të hartuara nga ekspertët e fushës së turizmit;
- Bashkëpunimi ndër-kufitar dhe ndër-komunal lidhur me zhvillimin e turizmit;
- Pastrimi i gjithë zonës së veçantë nga mjetet e pashpërthyerë e të mbetura nga lufta dhe informimi i opinionit për shëtitje të sigurt të vizitorëve brenda saj;
- Informimi i publikut për vlerat e zonës përmes fushatës së marketingut turistik;
- Ndërtimi i punkteve hyrëse e të informimit dhe të objekteve për shërbime turistike;
- Ngritja e njohurive për vlerat e gjithmbarshme të zonës dhe mundësitë e përfitimit ekonomik për banorët lokal;
- Zhvillimi i kapaciteteve të blegtorisë dhe rritja e prodhimit ekologjik;
- Grumbullimi dhe prodhimi i mjaltit, gështenjave dhe frutave malore;
- Kultivimi fasules së njohur të kësaj ane (Pasuli Mulliqit);
- Përgatitja e prodhimeve autoktone të ushqimit, (mishit, djathit, turshive dhe brumrave);
- Ngritja e kampingjeve turistike bjeshkatore - alpine (duke shfrytëzuar hapësirat e tokës ndërtimore dhe infrastrukturën e fshatit Koshare);



Foto 17. Pamje nga vizitat e Grupit Punues në zonë (Rrasë të Koshares). Burimi: IPH / AMMK / MMPH

II. VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

2.1 DEKLARATA E VIZIONIT

Bazuar në materialet e konsultuara dhe në ide të mbështetura në përvojën profesionale të ekspertëve pjesëmarrës në Grupin Punues Ndër - Institucional si dhe nëpër diskutime të shumta gjatë takimeve publike, është arritur pajtueshmëri e plotë e Vizionimit, gjegjësisht e formulimit të versionit përfundimtarë të kësaj deklarate, që thotë:

Memoriali - Beteja e Koshares është zonë e menaxhuar me kujdes në dobi të mbrojtjes e ruajtjes, të edukimit e hulumtimit, të promovimit, zhvillimit e të shfrytëzimit si dhe të përkujtimit e përjetimit, të vlerave dhe resurseve, të trashëgimisë historike - kulturore, natyrore dhe të peizazheve.

Duke iu referuar përmbajtjes së Deklaratës së Vizionit, mund të konstatohet se të gjitha caqet (synimet) e përgjithshme, të derivuara prej saj, duhet të jenë të ndërlidhura me vënien e hapësirës së zonës me të gjitha vlerat e dëshmuara brenda saj nën një administrim dhe menaxhim të kujdesshëm. Ky menaxhim, duhet të konsistojë, në zhvillimin dhe kontrollin e aktiviteteve, të cilat së pari janë të bazuara në planifikimin efikas hapësinor dhe urban dhe i përkasin objektivave specifike të ndara sipas synimeve. Këto aktivitete, që janë masa, projekte dhe veprime (siç do të shohim tek Strategjia si fazë e IV-të e procesit të Planifikimit), do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në mbrojtjen, ruajtjen, edukimin dhe hulumtimin e mëtejme, promovimin, zhvillimin dhe shfrytëzimin e këtyre vlerave të trashëguara në zonë dhe për rreth saj duke e mundësuar në fund edhe përkujtimin dhe përjetimin e tyre nga publiku i gjerë, gjegjësisht gjeneratat e tanishme dhe të ardhshme.

2.2. PARIMET E PËRGJITHSHME

Caqet (Synimet) e përcaktuara duhet patjetër të mbështetën në parimet e përgjithshme dhe të njohura për menaxhimin dhe zhvillimin e zonave me interes të veçantë.

Parimet e përgjithshme për zhvillim hapësinor dhe mbrojtje të mjedisit janë të bazuara në dokumentet të rëndësishme për planifikim hapësinor vendor dhe ndërkombëtar:

- Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor;
- Parimet Udhëzuese për Zhvillim të Qëndrueshëm Hapësinor të BE-së nga PEZhH (Perspektiva Evropiane e Zhvillimit Hapësinor - anglisht ESDP);
- Parimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm nga Agjenda 21;
- Parimet e Qeverisjes së Mirë Urbane nga Agjenda e UN Habitatit.

Parimet e përgjithshme për zhvillim dhe mbrojtje

Parimet bazë mbi të cilat do të fokusohen zhvillimet e përgjithshme në raport me parimet ndërkombëtare janë:

- Promovimin e interesave të përbashkëta të komunës duke mbrojtur dhe zhvilluar resurset natyrore dhe të trashëgimisë duke mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm;
- Promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes dhe përfshirjes në formulimin e strategjive zhvillimore dhe planeve fizike;
- Promovimin e transparencës së plotë në planifikim dhe procesin e marrjes së vendimeve duke iu lejuar pjesëmarrësve qasjen në të dhëna dhe hartat e nevojshme;
- Promovimin e të drejtave të barabarta ekonomike dhe shoqërore për të gjithë kosovarët;
- Promovimin e kualitetit të përmirësuar të jetës dhe forma të balancuara të Vendbanimeve;
- Promovimin e harmonizimit me parimet dhe planet e vazhdueshme të Zhvillimit Hapësinor Evropian.

Parimet e qeverisjes së mirë:

- Qëndrueshmëria - qasje e integruar e cila përfshin elementet hapësinore të transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për komunë;
- Subsidiariteti - marrja e vendimeve mbi baza të hierarkisë nga niveli qendror në atë lokal dhe zbatimi sa më efikas;
- Barazia - plani duhet të merr parasysh aspektet e barazisë: minoritetet, femrat, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara (adresimi i nevojave të grupeve të tilla përmes pjesëmarrjes publike) të ketë në konsideratë aspektet e ndjeshmërisë gjinore;
- Efikasiteti - ti prijë zhvillimit strategjik në territorin e zonës dhe të trajtojë çështjet e rëndësishme strategjike për fushat përkatëse;
- Transparenca - të gjitha zhvillimet të cilat ndodhin në hapësirën e zonës duhet të kenë arsye dhe personat përgjegjës duhet të jenë transparent për ato zhvillime;
- Pjesëmarrja - në këtë rast plani zhvillimor dhe urban si dy projekte shumë të rëndësishme për të ardhmen e komunës duhet të përfshijnë pjesëmarrje të gjerë me qëllim të përfaqësimit të interesave të gjitha palëve pa dallime;
- Përgjegjshmëria - për të gjitha zhvillimet të cilat ndodhin në hapësirë duhet të jemi të përgjegjshëm, sikur përfaqësuesit nga sektori publik, privat dhe deri te qytetari më i thjeshtë i vendit.

2.3. SYNIMET E PËRGJITHSHME ME OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Me qëllim të arritjes së Vizionit, duhet të bëhen derivimet e nevojshme, të strukturuar në formë piramidale, që nga Deklarata e Vizionit në synime (caqe) të përgjithshme, të përcjella me objektiva specifike si në vazhdim, e deri në veprimet konkrete (në planin e veprimit strategjik), që përmes plotësimit të tyre të fitohet rezultati i kërkuar. Objektivat specifike, sipas synimeve, janë:

SYNIMI 1(S1): Planifikimi dhe menaxhimi i zhvillimeve në zonë

- Objektivi 1 (O1) - Administrimi i zonës dhe Menaxhim i zhvillimeve
- Objektivi 2 (O2) - Planifikimi, zbatimi dhe kontrolli i zhvillimeve
- Objektivi 3 (O3) - Mbrojtja, ruajtja dhe shfrytëzimi racional i vlerave të trashëguara

SYNIMI 2 (S2): Sigurimi i qasjes dhe të shërbimeve teknike në zonë

- Objektivi 4 (O4) - Sigurimi i infrastrukturës rrugore dhe transportit;
- Objektivi 5 (O5) - Sigurimi i infrastrukturës së energjisë elektrike;
- Objektivi 6 (O6) - Sigurimi i infrastrukturës ujore;
- Objektivi 7 (O7) - Sigurimi i infrastrukturës së telekomunikacionit, dhe
- Objektivi 8 (O8) - Sigurimi i menaxhimit të mbeturinave.

SYNIMI 3 (S3): Zhvillimi i turizmit në zonë dhe të vendbanimeve për rreth saj

- Objektivi 9 (O9) - Sigurimi dhe ofrimi i shërbimeve cilësore turistike
- Objektivi 10 (O10) - Ngritja e njohurive të banorëve lokal për vlerat e zonës dhe mundësitë e përfitimit ekonomik
- Objektivi 11 (O11) - Krijimi i imazhit dhe promovimi i Memorialit të Koshares

2.4. PRIORITETET ZHVILLIMORE

Ndër prioritetet më të përzgjedhura zhvillimore, nga të gjitha veprimet strategjike, janë:

1. Përpilimi i Detyrës Projektuese për Konkursin Ideor me qëllim të përzgjedhjes së Kompanisë Private për Hartimin e Planit Rregullues Urban (me zgjidhjen arkitektonike) për pjesën qendrore (zona 1, 2 dhe Karakoll) të zonës së mbrojtur dhe të interesit veçantë, si në hartën e fig. 22.
2. Shpronësimi i pronave private në zonën 1 dhe 2 (në Logun dhe Rrasën e Koshares) të nevojshme për ngritjen e Kompleksit të Memorialit dhe ruajtjen e istikameve kryesore dhe pikave tjera me rëndësi për luftën e UÇK-së gjatë vitit 1999.
3. Zbatimi i PH dhe PRrU-së, nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me:
 - a. Ngritjen e Kompleksit të Memorialit në Logun e Koshares me të gjitha Elementet përbërës për rreth Varrezave të Dëshmorëve;
 - b. Rikonstruktimin dhe konservimin e Istikameve kryesores dhe rregullimin pikave dhe të ngjarjeve me rëndësi historike në Rrasën e Koshares (majtas) si dhe konservimi i ish-Karakollit (dy pamjet djathtas) si në foto 18;
 - c. Ngritjen e infrastrukturës së nevojshme rrugore dhe të shtigjeve për qasje dhe lëvizshmëri në zonë;
 - d. Ngritjen e infrastrukturës turistike dhe të shërbimeve tjera teknike në zonë.




Figura 22. Harta e zonës qendrore të Memorialit të Koshares për hartim të PRrU-së. Burimi: IPH/MMPH.



Foto 18. Istikami i Komandës (majtas) dhe dy pamjet e Ish-Karakollit. Burimi: IPH/MMPH

4. Shtimi i kapaciteteve ekzistuese ose ndërtimi i muzeut të ri në Gjakovë për vlerat e luftës së UÇK-së, duke përfshirë edhe eksponatet nga Beteja e Koshares.
5. Themelimi i Autoritetit Drejtues dhe hapja e Web-faqes për sensibilizimin e opinionit dhe promovimin e vlerave të shumta në zonën e mbrojtur të interesit veçantë.
6. Planifikimi dhe rregullimi i rrugëve malore dhe i shtigjeve për ecje e kalërim me vend-ndalesat të cilat bëjnë të mundur vizitën e pikave më interesante me pushim dhe përjetim të vlerave të zonës.
7. Studimi, plani dhe ngritja e Teleferikut prej Logut (Kompleksit të Varrezave) për në Rrasë (Istikamet) të Koshares.
8. Largimi i menjëhershëm i Gurëthyesit dhe rehabilitimi mjedisor i zonës së degraduar të Memorialit të Koshares.
9. Organizimi, ngritja dhe rregullimi i dy zonave të përshtatshme për kampe bjeshkatore - alpine në Braha dhe fshatin Koshare të bazuara në Planin për Menaxhim.

III. KORNIZA E ZHVILLIMIT TË ARDHSHËM

3.1. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Në aspektin hapësinor Zona e Memorialit të Koshares ka një pozitë strategjike, e rrethuar me disa nga përmbajtjet që kanë një rëndësi të veçantë jo vetëm për rajonin ku ndodhen, por rëndësia e tyre i tejkalon edhe kufijtë më të gjerë. Ky është edhe argumenti kryesor, që koncepti i zhvillimit të ardhshëm hapësinor për zonën bazohet pikërisht në raportin e ndërsjellë të përmbajtjeve të rëndësisë përkatëse me vet zonën e Memorialit të Koshares, duke konsistuar në shfrytëzimin maksimal të ndërveprimeve që mund të ndërtohen mes tyre.




Figura 23. Skema e konceptit të zhvillimit të ardhshëm hapësinor të zonës së Koshares. Burimi: IPH / MMPH

Koncepti i zhvillimit të ardhshëm hapësinor për zonën e Memorialit të Koshares, kryesisht fillon dhe mbaron me Varrezat e Dëshmorëve si pikë qendrore në Komplexin e Memorialit, që njëkohësisht paraqet përmbajtjen më të rëndësishme në të gjithë zonën. Aty qëndron themeli i të gjitha zhvillimeve dhe aty gërshetohen rrugët që e lidhin vet zonën me përmbajtjet dhe zhvillimet hapësinore përreth saj.

Duke iu referuar skemës kryesore të konceptit (Fig. 23), zona e Memorialit të Koshares, përkatësisht zhvillimet e parapara në kuadër të Planit Rregullues Urban, duhet të jenë në qendër

dhe me relacion në shërbim të komunikimit të ngushtë me të gjitha përmbajtjet e identifikuar si më të rëndësishme për rreth saj.

Në perëndim të zonës, ndodhen pika të dëshmuara të trashëgimisë natyrore dhe kulturore: Gryka e Valbonës si atraksion i veçantë turistik me Majat malore të Shkëlzenit dhe të Hekurave si dhe qytetet Tropojë e Bajram Curr me rrethinë. Lidhja e këtyre pikave me zonën e Koshares planifikohet të realizohet në dy mënyra: I) përmes shtigjeve për këmbësorë (të cilat në masë të madhe duhet të përshkojnë të njëjtën trase që është përdorë për komunikim gjatë kohës së luftimeve) dhe II) përmes rrugëve automobilistike nga qytetet Tropojë dhe Bajram Curr (që nuk i plotësojnë të gjitha nevojat normale të komunikimit për momentin).

Atraksion tjetër turistik malor është Maja e Gjeravicës, e cila njëkohësisht paraqet edhe majën më të lartë të Kosovës (2656 m/lmd) dhe majat tjera në kuadër të parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna, që ndodhet në veri-perëndim të zonës. Afërsia me zonën dhe mundësia e lidhjes së sajë në rrjetin e shtigjeve alpine, për këmbësorë dhe lëvizjeve tjera alternative, të cilat mund të çojnë edhe deri tek Liqeni i Plavës, e bënë më atraktive dhe e shton vlerën e zonës së Memorialit të Koshares në përgjithësi.

Zona e Memorialit të Koshares është bregore që ngrihet nga Rrafshi i Dukagjinit, i cili pos tjerash njihet edhe si rajoni me vlera të dëshmuara të trashëgimisë kulturore. Komuna e Pejës me Patrikanën dhe e Deçanit me Manastirin (në veri të zonës), e Junikut me komplekset e kullave të gurit (në veri-lindje) si dhe zona e vjetër e qytetit të Gjakovës me Çarshinë e Madhe dhe shtëpitë e vjetra karakteristike qytetare (në jug-lindje), e bëjnë akoma më atraktive këtë zonë duke e plotësuar edhe më tej ofertën e përbashkët turistike.

Pikat tjera të veçanta, që kanë ndikim në zhvillimin e turizmit të zonës, janë: Zona e Monumentit Natyror "Ujëvarat e Mirushes", Aeroporti i Gjakovës (që për momentin është nën menaxhimin e KFOR-it) dhe Liqeni i Radoniqit. Mementalisht, nga dy të fundit, asnjëra nuk është e hapur për publikun e gjerë. Sipas informatave aktuale, aeroporti shfrytëzohet për fluturime ushtarake, por që mund të përdoret edhe për fluturime civile. Një veprim i tillë do të ndikojë në lidhjen më të mirë të rajonit në përgjithësi dhe në anën tjetër do të shfrytëzohet edhe për alternativë shumë e nevojshme e aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës. Sa i përket Liqenit, me pak investime shtesë, do të krijoheshin kushte, që përveç sigurimit të ujit për pije dhe ujitje, ai të shfrytëzohet edhe për nevoja turistike rekreative.

Mbi të gjitha, rruga që lidhë Republikën e Kosovës me Republikën e Shqipërisë, përmes pikës doganore dhe kalimit kufitar në Morinë të Komunës së Gjakovës, është mundësi tjetër që ndikon drejtpërdrejtë në ngritjen e interesit e të fluksit të vizitorëve për në zonën e mbrojtur dhe me interes të veçantë "Beteja e Koshares". Bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës 2020+, kjo rrugë është e dyta për nga rëndësia (pas asaj në Vërmicë të Prizrenit), e cila do të shërbej për komunikim dhe transport rrugor të njerëzve dhe mallrave mes dy shteteve, përkatësisht e lidhjes së Kosovës me bregdetin shqiptar - Portin e Shën Gjinit.

Meqë, të gjitha këto pika kanë lidhje të afërt e të drejtpërdrejtë me zonën, me pak investime, mund të ndikohet që lëvizja nga njëra pikë në tjetrën të bëhen më e lehtë dhe më efikase. Zona e Memorialit të Koshares, me të gjitha përmbajtjet për rreth, duke i përfshirë edhe ato në anën perëndimore të saj, mund të shndërrohet në një qendër atraksioni të qëndrueshëm turistik me ndikim në zhvillimin e gjithë rajonit. Prandaj, një zhvillim i tillë, akoma më shumë do të ndikojë në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të trashëguara historike, kulturore e natyrore të zonës së mbrojtur dhe me interes të veçantë "Beteja e Koshares".

3.2. STRUKTURA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR TË ZONËS

Struktura hapësinore e zonës së mbrojtur dhe me interes të veçantë ku është zhvilluar Beteja e Koshares sipas rekomandimeve të planit ndahet në zonën e ngushtë dhe të gjerë të veprimit. Zona e ngushtë e veprimit, përfshinë, zonën e parë (I) në Logun e Koshares dhe të dytë (II) në Rrasen e Koshares, brenda Zonës së Memorialit. Kurse, zona e gjerë e veprimit, përfshinë, zonën e tretë (III) që nënkupton tërë hapësirën e mbetur të kësaj zone të shpallur si dhe zonën e katërt (jashtë saj) e cila përbënë disa pika, objekte, vende dhe vendbanime të cilat kanë pasur ndikim anësor në zhvillimet e luftës.

- Zona e parë (I) – konsiderohet zona e Logut të Koshares, për të cilën është kërkuara të hartohet një Plan Rregullues Urban, në bazë të së cilit duhet të ndërtohet Kompleksi Memorial me Elementet përbërës: Varreza të 114 Dëshmorëve, Lapidarin e përbashkët me vendet për Flamuj, Muralin me Flakadan, Amfiteatrën për manifestimet publike si dhe Muzeun me Fontanë dhe Vendpushim të familjarëve. Ndërsa, për rreth tyre, duhet të sigurohet hapësirë e nevojshme, e cila do të shërbejë për Varreza të Veteranëve të luftës (sipas dëshirës së deklaruar të tyre) nga Brigada 138 Agim Ramadani dhe për vendosjen e parkingjeve për vizitorë të zonës.
- Zona e dytë (II) – konsiderohet zona e Rrasës së Koshares dhe Ish-Karakollit të ushtrisë Jugosllave, në të cilën prapë sipas PRRU-së duhet bërë konservimin e Ish-Karakollit ushtarak si dhe ruajtjen, shënimin, rikonstruktimin dhe konservimin e pikave strategjike dhe më domethënëse gjatë periudhës së luftimeve të kësaj Brigade. Këtu, duhet të rregullohen Vendrëniet e Heronjve Kombëtar (Agim Ramadani dhe Sali Çeku), pikat tjera të rëndësishme sikur që janë Istikamet Kryesore (të Komandës, Mjekëve dhe Artilerisë) dhe pozicionet e luftës me istikamet tjera të veçanta dhe të lidhura në varg. Nuk duhet përjashtuar ndërtimin dhe rregullimin e shtigjeve që mundësojnë lidhjen, vizitën dhe përkujtimin e këtyre hapësirave, vendeve dhe pikave të veçanta.
- Zonë e tretë (III) - konsiderohet e tërë hapësira tjetër e mbetur e zonës së Memorialit, për të cilën, veprimet që duhet të merren me qëllim të ruajtjes, shënimin, rikonstruktimit dhe konservimit të pikave dhe të ngjarjeve më interesante gjatë periudhës së luftimeve (si: pikat e depërtimit të kufirit, vendet e sulmit dhe rrethimit të forcave armike të stacionuara dhe në lëvizje, vend-vrojtimit, etj) do të jenë të bazuara në Planin për Menaxhim të kësaj zone të shpallur. Në këtë zonë, sipas po të njëjtit Plan, duhet të parashihen edhe organizime tjera, si në ngritjen dhe rregullimin e hapësirave për kampingjeve turistike me infrastrukturë dhe shërbime të nevojshme teknike ashtu edhe në rregullimin e pikave rekreative - sportive dhe vrojtuese të peizazhit.
- Zonë e katërt (IV) – konsiderohen vendbanimet, objektet dhe pikat e shpërndara jashtë zonës së Memorialit të Koshares, në të cilat duhet të vendosen mbishkrime apo simbole tjera të përzgjedhura, në formë pllake ose gjësendi tjetër, në shenjë mirënjohjeje, përkujtimi dhe respekti, meqë ishin shfrytëzuar ose kishin shërbyer për strehim, qëndrim, shërim, përgatitje, ushtrime, vrojtme, depërtime dhe luftime tjera të ushtarëve të njësiteve të Brigadës 138 Agim Ramadani. Gjithashtu, zona e katërt (IV), duhet të përfshijë edhe vendbanimet për rreth Memorialit të Koshares, e cila do të shërbejë për ngritjen e zhvillimeve të ardhshme që nuk mund të lejohen në hapësirën e shpallur për zonë të mbrojtur dhe me interes të veçantë si dhe për ofrimin e mundësisë për pranimin, akomodimin dhe ushqimin e vizitorëve e të turistëve potencial.

IV. STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

4.1. STRATEGJIA E TRENDIT

Strategjia e trendit ose “zero”, shprehë gjendjen aktuale të zhvillimeve në zonën e Memorialit, e cila, në mungesë të strategjive tjera të përgatitura, do të shërbejë për vlerësim dhe krahasim me strategjinë e hartuar sipas konceptit për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të këtij Plani. Padyshim, se zhvillimi i një strategjie të tillë, që ka për rezultat veprimet e pa planifikuara, të pamjaftueshme dhe të pakoordinuara në mes veti., do të ndikojë në degradimin e vazhdueshëm dhe në humbjen e vlerave të trashëguara historike, kulturore dhe natyrore të zonës. Argumentet, për një gjendje të tillë të moskujdesjes, janë të shumtë, me përjashtim të një përkujdesjeje simbolike, nga niveli lokal për gjendjen momentale të Varrezave të Dëshmorëve si dhe ai qendror për rregullimin e rrugës që siguron qasjen deri tek këto Varreza.

Përkujtimi për Dëshmorët e rënë dhe sakrifica e pjesëmarrësve tjerë në Betejën e Koshares, kërkon dhe meriton përkujdesje shumë më të madhe nga ajo e deritanishme. Prandaj, duke e pasur këtë parasysh, kërkohet një bashkërendim gjithëpërfshirës dhe përkushtim i të gjitha forcave nga sektorë dhe partnerë të ndryshëm (qeveritar dhe joqeveritar) në hartimin dhe zbatimin e një strategjie për zhvillim të qëndrueshëm të zonës.

4.2. STRATEGJIA SIPAS KONCEPTIT ZHVILLIMOR

Strategjia për zhvillim të ardhshëm hapësinor të zonës së veçantë Beteja e Koshares, e bazuar në konceptin zhvillimor, është përmbledhje e veprimeve, të cilat janë masa, aktivitete dhe projekte duke rezultuar me një bashkëveprim të koordinuar ndërinstytucional, përfshirë edhe përkrahjen shumë të vlefshme të shoqërisë civile dhe organizatave tjera jo qeveritare.

Të gjitha synimet, objektivat dhe veprimet e kësaj strategjie, që do të prezantohen në vazhdim, janë rezultat i pajtueshmërisë së arritur mes ekspertëve profesionistë të grupit punues, dhe të gjithë pjesëmarrësve tjerë të konsultuar në takimet publike, gjë që dëshmon edhe në qëndrueshmërinë e kësaj strategjie të ofruar. Prandaj, zbatimi i kësaj Strategjie, të bazuar në konceptin zhvillimor “Kosharja qendër dhe urë turistike”, me plot bindje duhet besuar se është më e suksesshme nga ajo paraprake “Zero”.

4.2.1. SYNIMI 1.

PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I ZHVILLIMEVE NË ZONË

SYNIMET	
S1	Planifikimi dhe menaxhimi i zhvillimeve në zonë
S2	<i>Sigurimi i qasjes dhe të shërbimeve teknike në zonë</i>
S3	<i>Zhvillimi i turizmit në zonë dhe të vendbanimeve për rreth saj</i>

Me këtë synim do të arrihet një menaxhim i përhershëm i zonës i mbështetur në strukturën organizative dhe në planifikimin e zhvillimeve të ardhshme të cilat mundësojnë një kontroll të vazhdueshëm gjatë rregullimit të hapësirës si dhe në ruajtjen apo shfrytëzimin racional të vlerave dhe të përmbajtjeve të trashëgimisë kulturo-historike e natyrore, të larmisë biologjike, mjedisore e të peizazhit në zonë.

Përzgjedhja e veprimeve me ndikime hapësinore, që do të ofrohen sipas objektivave, janë të qarta dhe konkrete, si për ruajtjen e vlerave ashtu edhe për trajtimin e përmbajtjeve të reja në raport me ato ekzistuese.

Pikësynim kryesor, këtu është, administrimi i zonës së Memorialit, menaxhimi dhe kontrolli i përhershëm i zhvillimeve brenda dhe për rreth saj të bazuara në planet adekuate të parapërgatitura.

Arritja e këtij synimi mundësohet me realizimin e objektivave në vazhdim:

Objektivi 1. Administrimi i zonës dhe Menaxhimi i zhvillimeve

Sipas këtij objektivi, është paraparë të themelohet një "Autoritet Drejtues" për menaxhim dhe administrim të zonës, i cili do të funksionojë nën mbikëqyrjen e qeverisë qendrore dhe në përbërjen e të cilit do të përfaqësohet edhe qeveria lokale. Jemi të bindur se, një strukturë e tillë, me ekspertë të fushës së trashëgimisë kulturore e natyrore dhe turizmit, nga dy nivelet e qeverisjes, do të jetë shumë funksionale dhe me ndikim shumë pozitiv në zhvillimin e qëndrueshëm të Zonës së Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë "Beteja e Koshares".

"Autoriteti Drejtues (AD)" do të jetë përgjegjës për administrim, Menaxhim dhe kontrollin e vazhdueshëm të zhvillimeve, të bazuara në planet paraprake hapësinore, rregulluese dhe të menaxhimit, me qëllim të funksionalizimit dhe të rregullimit të hapësirës së zonës së Memorialit. Ky AD, përveç kompetencës dhe detyrës që ka për mbrojtje, ruajtje, shfrytëzim, informim dhe promovim të vlerave të trashëguara e të resurseve mjedisore, brenda dhe për rreth kësaj zone, me ndihmë dhe ndërmjetësim të Qeverisë do të përfshihet edhe në arritjen e marrëveshjeve të ndryshme me organet tjera kompetente.

Veprimet e nevojshme për arritjen e objektivit janë:

- ***Themelimi i Autoritetit Drejtues për Menaxhim***

Për arritjen e një menaxhimi të suksesshëm dhe kontrollin e vazhdueshëm të zhvillimeve në zonë nevojitet të themelohet organi drejtues. Ky AD do të administrojë, përcjellë dhe mbikëqyrë çdo zhvillim, si ato të planifikuara paraprakisht ashtu edhe do të mundohet të gjej dhe të ofroj zgjidhje profesionale për ato të paplanifikuara.

- ***Hartimi i Rregullores së Brendshme për Administrim të zonës së Memorialit***
- ***Hartimi i Planit për Menaxhim të zonës së Memorialit;***

Hartimi i Rregullores së Brendshme të Administrimit dhe Planit për Menaxhim krijon mundësinë për përkujdesjen, mirëmbajtjen dhe promovimin e vlerave të ZMIV-të me një strukturë të përhershme financiare që siguron një buxhet të vazhdueshëm për menaxhim. Autoriteti Drejtues duhet të inicioj dhe udhëheqë me procesin për hartim të Rregullores dhe Planit për Menaxhim, me

të cilat do të definoreshin të gjitha aktivitetet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për zonë dhe vlerat e saj. Plani për Menaxhim, hartohet në bashkëpunim me sektorët tjerë të qeverisjes qendrore dhe lokale dhe duhet të përmbajë: plan-programin për shfrytëzimin, rregullimin, monitorimin dhe kontrollin e zhvillimeve brenda Memorialit si dhe dizajnimin e simbolit dhe planin detal për marketing dhe organizim të vizitave.

- *Shpronësimi i pronave sipas ligjeve në fuqi;*

Para fillimit të procesit të zbatimit të planit hapësinore dhe atij rregullues për ndërtimin, konservimin dhe rregullimin e zonës së veçantë, është e nevojshme të kryhet shpronësimi i pronave private dhe ndryshimi i titullarit të pronësisë, në hapësirat, pikat dhe në vendet ku janë paraparë zhvillimet e reja.

- *Bashkëpunimi i vazhdueshëm i AD me institucionet relevante me ndikim;*

Për të arritur një menaxhim të mirë e funksional të zonës, nevojitet një bashkëpunim i vazhdueshëm mes Autoritetit Drejtues të zonës së Memorialit dhe të gjitha institucioneve tjera qeveritare dhe joqeveritare që janë relevante dhe me ndikim në zonë. Ky bashkëpunim, mes tjerash përfshinë edhe arritjen e marrëveshjeve të mirëkuptimit, si për shfrytëzimin e pronës shoqërore-publike të ekonomisë pyjore ashtu edhe për ruajtjen dhe shfrytëzimin e vlerave dhe të resurseve tjera në zonë.

Objekti 2. Planifikimi, zbatimi dhe kontrolli i zhvillimeve

Për menaxhim të suksesshëm me zonën e mbrojtur dhe me interes të veçantë “Beteja e Koshares”, në veçanti për rregullimin e hapësirës dhe në përkujdesje ndaj vlerave të trashëgimisë dhe resurseve natyrore brenda saj, nevojitet që zhvillimet e ardhshme të jenë të kontrolluara. Për të mundur një kontroll të përhershëm dhe efikas kërkohet që të gjitha zhvillimet duhet të parashihen apo të mbështeten në planet adekuate strategjike (Hapësinore dhe Rregulluese) të aprovuara. Me këtë rast, hartimi i planit për menaxhim të vlerave në zonë si dhe planeve për rregullimin e hapësirës së saj, krijohet korniza bazë me projektet e planifikuara për zhvillime të ardhshme. Prandaj, edhe lejimi i zhvillimeve të planifikuara apo moslejimin i atyre të pa planifikuara dhe jo-formale në një zonë të tillë të mbrojtur dhe me interes të veçantë për vendin do të jetë më i lehtë dhe i kontrolluar.

Objekti arrihet përmes këtyre veprimeve:

- *Hartimi i PRrU-së (Planit Rregullues Urban) sipas Detyrës Projektuese;*
- *Aprovimi dhe zbatimi i PRrU-së nga Qeveria (MMPH dhe Komuna);*

Me qëllim të realizimit të rregullimit të hapësirës dhe kontrollit të zhvillimeve të bazuara në planifikim hapësinor, është e rëndësishme që nga MMPH-ja, të organizohet Hartimi i Detyrës Projektuese për shpalljen e Konkursit dhe në bazë të idesë së përzgjedhur nga Komisioni i pavarur, të bëhet edhe kontraktimi i Kompanisë fituese, për Hartim të Planit Rregullues Urban (PRrU-së) me zgjidhjen Arkitektonike për secilin element veç e veç. Me rastin e aprovimit të PRrU-së së hartuar do të filloj edhe procedura e zbatimit tij.

- *Ngritja dhe ndërtimi i Elementeve të Kompleksit të Memorialit sipas projekteve të veçanta nga PRrU-ja;*
- *Ngritja e kapaciteteve të Muzeut për luftën e UÇK-së në Gjakovë përfshirë edhe eksponatet nga Beteja e Koshares;*

Realizimi i këtij Plani, në ngritjen dhe ndërtimin e Elementeve të Kompleksit të Memorialit, sipas projekteve të veçanta për zbatim, në Logun e Koshares si pjesë qendrore e zonës, mund të organizohet në faza të ndryshme kohore të zhvillimit ku përveç investimit nga Buxheti i Kosovës lejohet edhe pjesëmarrja e Partneritetit Publik Privat (PPP). Në këtë rast, ngritja e kapaciteteve të Muzeut për luftën e përgjithshme të UÇK-së në qytetin e Gjakovës, që do të përfshinte edhe

ekspozitat me dokumentacion nga Beteja e Koshares, do të mundësonte që Muzeu në Kompleksin e Memorialit në zonë, për arsye të ndryshme (ndërtimi, mirëmbajtja, qasja dhe ngrohja gjatë dimrit, etj) të jetë me kapacitete shumë më të vogla.

- *Rikonstruktimi dhe konservimi (ruajtja) i Istikameve Kryesore sipas PRRU-së,*
- *Konservimi i Karakollit dhe i Kullës Vrojtuese sipas PRRU-së;*
- *Rregullimi pikave të rëndësishë së veçantë të luftës në zonë sipas PRRU-së;*

Përveç ngritjes së Kompleksit të Memorialit, në zbatim të PRRU-së, është shumë me rëndësi edhe rikonstruktimi dhe konservimi i istikameve më kryesore në Rrasën e Koshares, konservimi i Karakollit dhe të kullës së vëzhgimit e gurit të thyer (piramidës) në vijën kufitare si dhe rregullimi i vend-rënies së Heronjve Kombëtar: Agim Ramadanit dhe Sali Çekajt, vend-vendosjes së artilerisë dhe të kontrollit terrenit si dhe të pikave tjera të sulmit diversant e të rëndësishë së veçantë, gjatë luftës të zhvilluar në vitin 1999. Të gjitha këto veprime janë të parapara për fazën e parë afatshkurte trevjeçare.

- *Hartimi i projektit dhe konservimi i ngjarjeve të luftës përmes efekteve të zërit e të dritës në Rrasën e Koshares;*

Për në fazën e dytë 3 – 5 vjeçare, është paraparë të realizohet edhe mundësia e konservimit të ngjarjeve të luftës së vitit 1999, në mënyrë më të avancuar dhe përmes efekteve të sinkronizuara bashkëkohore të zërit dhe dritës, të sillet përkujtimi i tyre gjatë shtegtimin të vizitorëve në Rrasën e Koshares si pjesë qendrore e zonës së veçantë.

- *Hartimi i projektit për rregullimin e shtigjeve për lëvizje dhe të hapësirave për pushim, vrojtim dhe rekreacion;*

Me qëllim të sigurimit të një lëvizje më të lehtësuar të vizitorëve, me ndalesat për pushim, vrojtim dhe përjetim komod të peizazhit dhe të pikave më të rëndësishme nga ngjarjet e luftës së vitit 1999 në zonën e Memorialit, duhet që paraprakisht të hartohet projekti në të cilit duhet bazuar edhe ndërtimin dhe rregullimin e këtyre shtigjeve dhe vend-ndalesave. Po ashtu, ky veprim, është përgjegjësi e Qeverisë me mundësi bashkëpunimi me PPP dhe parashihet për fazën (trevjeçarin) e parë.

- *Hartimi i projektit për teleferikun nga Varrezat e Dëshmorëve për në Rrasë të Koshares;*

Ndër veprimet tjera, për në fazën e parë trevjeçare, parashihet edhe hartimi i Projekt për teleferikun me gjatësi në vijë ajrore prej rreth 700 m' dhe me disnivel vertikal të lartësisë mbidetare prej 350 m'. Ngritja dhe ndërtimi i tij, që do të mundësonte komunikimin e shpejtë dhe shumë të lehtë të vizitorëve, nga Kompleksi i Memorialit deri në Rrasën e Koshares, mund të zgjasë deri në fazën e dytë 3 – 5 apo të tretë mbi 5 vjeçare, në varësi të sigurimit të mjeteve financiare nga Buxheti i Kosovës apo PPP për këtë investim.

- *Hartimi i projekt-planit për rregullimin dhe funksionimin e kampingjeve (në Brahë dhe Koshare);*

Për funksionimin e kampingjeve, të parapara në Brahë dhe në fshatin Koshare, duhet hartuar projekt-plan për rregullimin e tyre, të cilat bazohen në Plan për Menaxhim të zonës.

- *Hartimi i projektit për hulumtimin e mureve të Fortesës së Jerinës.*

Hartimi i projektit në kërkimin dhe identifikimin e mureve të Fortesës së Jerinës në Rrasën e Koshares është me interes të përgjithshëm vendor. Zhvillim i këtij projekti, që do të udhëhiqet nga organet kompetente për trashëgiminë arkeologjike, nën mbikëqyrje të AD dhe në kohën sa më të shpejtë të mundshme, do të ndikonte në joshjen më atraktive të vizitorëve dhe në zhvillim të turizmit rural.

Objektivi 3. Mbrojtja, ruajtja dhe shfrytëzimi i vlerave të trashëguara

Qëndrueshmëria e një zone të veçantë është në varësi nga trajtimi gjithëpërfshirës i të gjitha vlerave dhe përmbajtjeve tjera mjedisore dhe jo vetëm i vlerave të caktuara historike për të cilat është shpallur. Nisur nga kjo, përveç ngritjes së Kompleksit Memorial të parashikuar, me zhvillimin e mëtejme hapësinor të zonës, nënkuptohen edhe veprimet tjera, me të cilat, me kujdes mbrohen, ruhen dhe shfrytëzohen vlerat tjera nga trashëgimia natyrore e larmia biologjike, nga trashëgimia kulturore (arkeologjike, arkitektonike, tradicionale, dhe shpirtërore - kultit), të vendeve të volitshme për peizazh dhe për rekreacion, me qëllim të shtimit të joshjes së vizitorëve për në këtë zonë të veçantë.

Veprimet me të cilat arrihet objektivi janë:

- *Largimi i Gurëthyesit dhe rehabilitimi i lokacionit të degraduar.*
- *Promovimi i llojeve të veçanta biologjike të identifikuar në zonë;*
- *Hulumtime të mëtejme për llojet endemike, të rralla e të rrezikuara të larmisë biologjike dhe habitatin e tyre;*
- *Identifikimi i lokacionit dhe hartimi projektit për ngritjen e digës, për shfrytëzim të trefishtë, në Lumin Gusha;*

Këto veprime, paraqesin masat, projektet dhe aktivitetet e parapara me afat shumë të shkurtë (të menjëhershëm) dhe të gjatë kohor (mbi 5 vite) të realizimit, me të cilat do të arrihet dhe fuqizohet ky objektivi, sidomos në mbrojtjen, ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të burimeve dhe të vlerave natyrore në zonën e mbrojtur dhe me interes të veçantë. Veprimi i fundit në këtë grup shpreh interesimin e madh për hartimin e projektit dhe ndërtimin e një dige me rol të trefishtë mbi lumin Gusha: 1) të urës komunikuese mes bregores së Koshres dhe të Shkozës, 2) të rezervari të ujit në rast zjarri në zonë si dhe 3) të gjenerimit të energjisë elektrike për plotësimin e nevojave të objekteve të zonës së Memorialit.

- *Konsolidimi dhe konservimi i mureve të identifikuar të Fortesës së Jerinës;*
- *Stimulime për rindërtimin dhe rijetësimin e shtëpive / kullave tradicionale në fshatin Koshare;*
- *Stimulime për rijetësimin e kullave tradicionale në VB për rreth zonës (Junik, Jasiq, Gjocaj, Batushë, Brovinë, Mulliq, Ponoshec dhe Morinë);*
- *Integrimi i objektit fetar (tyrbes) në zonën e zhvillimit në fshatin Koshare;*

Përveç veprimit për identifikim, restaurim dhe konservim të mureve të Fortesës së Jerinës, realizimi i të cilave zgjatë mbi 5 vite, këtu janë rreshtuar edhe veprimet me afat të shkurtë kohor (deri në 5 vite) të realizimit. Të gjitha këto veprime, që do të kontribuojnë kryesisht në plotësimin e kërkesave për ruajtje, promovim dhe shfrytëzim të vlerave të trashëgimisë kulturore, do të udhëhiqen nga organet kompetente, nën një Projekt të Përbashkët Partneriteti edhe me Pronarët, që synon të demonstrojë një praktikë të mirë të rijetësimin (revitalizimit) të monumenteve.

- *Monitorim rigoroz nga "Autoriteti Drejtues" ndaj vlerave të trashëgimisë, gjatë realizimit të zhvillimeve dhe lëvizjes së vizitorëve në zonë,;*
- *Shfrytëzimi i transportit ekologjik (jomotorik) gjatë vizitave të organizuara së zonës dhe për rreth saj;*

Me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së vlerave të trashëguara natyrore, kulturo-historike dhe të peizazhit në zonë, nevojitet një përkushtim dhe përkujdes më i shtuar i të gjithëve ndaj këtyre vlerave, gjatë realizimit të çdo veprimi të parapara me këtë strategji, sikur për ato me afat të shkurtë ashtu edhe për ato me afat të gjatë kohor si gjatë. Një nga veprimet e tilla është edhe organizime të vizitave në zonë duke përdorur për transport mjetet jo motorike (me energji pa djegëje të karburantit).

4.2.2. SYNIMI 2.

SIGURIMI I QASJES DHE SHËRBIMEVE TEKNIKE NË ZONË

SYNIMET	
S1	<i>Planifikimi dhe menaxhimi i zhvillimeve në zonë</i>
S2	<u>Sigurimi i qasjes dhe të shërbimeve teknike në zonë</u>
S3	<i>Zhvillimi i turizmit në zonë dhe të vendbanimeve për rreth saj</i>

ZMIV “Memoriali i Betejës së Koshares” nuk do të mund të kryente funksionin që ka nëse qasja atje do të ishte e vështirësuar. Zona është në funksion të informimit të publikut për luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, edukimit patriotik të popullit tonë, por edhe në funksion të zhvillimit të turizmit.

Si do të arriheshin këto funksione nëse vizitorëve do të ju mungonte qasja për dhe në zonë si dhe ofrimi i shërbimeve teknike?

Për këtë arsye është caktuar ky synim, që ka të bëjë me infrastrukturën fizike, arritja e të cilit u mundëson vizitorëve një qasje të lehtë në të gjitha pikat që janë me interes të vizitohen, qoftë përmes rrugës automobilistike, qoftë përmes shtigjeve për këmbësorë apo edhe ndonjë mënyre tjetër. Synimi po ashtu siguron shërbimet teknike si furnizimin me energji elektrike, me ujë të pijshëm, komunikimin e njerëzve dhe menaxhimin e mbeturinave në zonë duke siguruar infrastrukturën e nevojshme për të gjitha këto. Në vazhdim janë dhënë objektivat me të cilat do të arrihet ky synim.

Objektivi 4. Sigurimi i infrastrukturës rrugore dhe transportit

Realizimi e këtij objektivi, mundëson një qasje dhe lëvizshmëri më të lehtë dhe më të shpejtë të vizitorëve për në të gjitha pikat e rëndësishme të zonës, duke iu mundësuar atyre edhe ndalesa dhe pushime komode në hapësirat e rregulluara të këtyre pikave si dhe në vend-ndalesat përgjatë shtigjeve, në vend-vrojtimit për përjetim të peizazhit dhe pikat e caktuara të rekreacion.

Veprimet e nevojshme për arritjen e objektivit janë:

- *Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës kryesore (primare) prej hyrjes në zonë nga fshati Batushë deri në Kompleksin e Memorialit;*
- *Rregullimi dhe shtruarja e zhavorrit në rrugën dytësore (sekondare) nga Juniku nëpër Jasiq e deri në Kompleksin e Memorialit;*
- *Rregullimi dhe shtruarja me zhavorr e rrugës dytësore për në Karakoll dhe në R. e Shqipërisë (nga dy variantet në hartën Strategjia e Zhvillimit të Memorialit, fig. 16):*
 - *Varianti I-rë nga Kompleksi Memorial përmes urës re mbi lumin Gusha, dhe*
 - *Varianti II-të nga Restoranti “Katana” në hyrje të zonës së Memorialit;*
- *Zbatimi i projektit për ndërtimin e teleferikut nga Kompleksi Memorial deri në Rrasë të Koshares;*
- *Zbatimi i projektit për rregullimin e shtigjeve për këmbësor dhe kalërim si dhe të hapësirës për vend – ndalesa, pushim, rekreim dhe vrojtim;*
- *Zbatimi i projektit për rregullimin e rrugëve malore për automjete të lehta motorike dhe të zjarrfikësve në zonën e Memorialit;*
- *Rregullimi i pikave rekreative – sportive të parashutizmit në Rrasë të Koshares (rreth 1400 m lmd) dhe në vendin Guri n’gul (1800 m lmd);*

Objektivi 5. Sigurimi i infrastrukturës së energjisë elektrike

Ky objektivi ka të bëjë me sigurimin e infrastrukturës dhe plotësimin e nevojës për energji elektrike në zonë, duke ofruar shërbimet e nevojshme për furnizim të mjaftueshme për ndërtesat

Kompleksit të Memorialit, banorët e rikthyer të fshatit dhe vizitorët turistik që do të qëndrojnë në fshat dhe në kampingje.

Veprimet, me qëllim të arritjes së këtij objekti, janë:

- *Hartimi i planit për furnizim të zonës me energji elektrike;*
 - *Ndërtimi i linjave të reja furnizuese 10 kV gjegjësisht 0.4 kV me trafo-stacione përcjellës;*
 - *Zëvendësimi i linjave ajrore me ato kabllorë nëntokësore;*
 - *Vendosja e shtyllave për ndriçim publik të hapësirave me përmbajtje të theksuar zhvillimore brenda zonës.*

Objektivi 6. Sigurimi i infrastrukturës ujore

Sigurimi i infrastrukturës ujore me shërbimet e nevojshme e bën të mundur furnizimin me ujë të pijshëm në zonë dhe trajtimin e ujerave të zeza, nga nyjet e organizuara sanitare, përmes kanalizimit të tyre deri në impiante - gropa septike për kullim/filtrim para se ato të derdhen në ujërrjedhat më të afërta të zonës.

Ky objektivi arrihet përmes këtyre veprimeve:

- *Instalimi i sistemit të ujësjellësit dhe të kanalizimit në Kompleksin e Memorialit;*
- *Rregullimi i krojeve përkaj rrugëve dhe shtigjeve për këmbësor e kalërim;*
- *Sistemimi dhe rregullimi i sanitarëve në zonat e kampingjeve;*
- *Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujerave të zeza*
- *Ngritja dhe ndërtimi i digës së rezervuarit të ujit në Lumin Gusha (për ndërhyrje në rast zjarri).*

Objektivi 7. Sigurimi i infrastrukturës së telekomunikacionit

Arritja e këtij objekti, për banorët dhe vizitorët e zonës, do të ndikoj drejtpërdrejtë në zonën e Memorialit duke krijuar komunikim më të mirë brenda dhe jashtë saj.

Objektivi do të arrihet me realizimin e këtyre veprimeve:

- *Instalimi i linjës kabllorë nëntokësore për sjelljen e sinjalit të telefonisë fikse në Kompleksin e Memorialit;*
- *Vendosja e antenave dhe fijeve optike në përforcimin e rrjetit difuziv (pa tela - wireless) për Internet, telefoni mobile dhe TV kabllor në zonat e zhvillimit;*
- *Instalimi i pajisjeve (marrësit të sinjalit dhe të kabllorëve) në ndërtesat e përhershme në kampingje dhe në Kompleksin Memorial.*

Objektivi 8. Menaxhimi i mbeturinave

Mbajtja e mjedisit të pastër në një zonë të mbrojtur dhe me interes të veçantë është shumë e rëndësishme. Sepse, në të kundërtën, nuk do të ishte atraktive për vizitorët e kësaj zone. Prandaj, sigurimi i një menaxhimi të duhur për grumbullimin dhe largimin e mbeturinave, është nevojë dhe kërkesë e domosdoshme për zonën e Memorialit.

Ky objektivi arrihet përmes veprimeve:

- *Kontraktimi i operatorit për grumbullimin dhe largimin e mbeturinave në zbatim të planit për menaxhim të ZMIV;*
- *Vendosja e kontejnerëve dhe e shportave për grumbullimin e mbeturinave në zonat e zhvillimit (Kompleksi Memorial dhe kampingje) si dhe pranë rrugëve e shtigjeve;*
- *Largimi i mbeturinave nga zona e Memorialit dhe dërgimi tyre në deponi sipas orarit të akorduar.*

4.2.3. SYNIMI 3.

ZHVILLIMI I TURIZMIT NË ZONË DHE I VENDBANIMEVE PËR RRETH SAJ

SYNIMET	
S1	Planifikimi dhe menaxhimi i zhvillimeve
S2	Sigurimi i qasjes dhe të shërbimeve teknike në zonë
S3	Zhvillimi i turizmit në zonë dhe të vendbanimeve për rreth saj

Me qëllim të aritjes së këtij synimi ose të rritjes së të ardhurave të komunitetit do të planifikohet një zhvillimi i turizmit rural mbi vlerat e çmuara ekzistuese në zonë si dhe duke ruajtur thesaret natyrore, traditën dhe trashëgiminë kulturore-historike, cilësinë e peizazhit natyror, tiparet dalluese të jetesës dhe kulturës lokale përmes arti - zanateve dhe ngjarjeve tjera kulturo-artistike, kuzhinës, etj të tërhiqen turistët e jashtëm dhe vendor. Në shumë zona, cilësia e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore-historike është atraktive dhe thelbësore për zhvillim e këtij turizmi, i cili ndikon në gjenerim ekonomik dhe përmirësim të cilësisë së jetesës së

komuniteteve lokale nga njëra anë, kurse nga ana tjetër, në përjetimin e këtyre vlerave nga ana e vizitorëve.

Produkte të qëndrueshme turistike janë ato produkte të cilat funksionojnë në harmoni me mjedisin, komunitetin dhe kulturën lokale në mënyre që këto të jenë përfituese e jo viktime të zhvillimit të turizmit. Ky synim arrihet përmes këtyre objektivave:

Objektivi 9. Sigurimi dhe ofrimi i shërbimeve cilësore turistike

Me këtë objektiv tentohet që përmes ofrimit të shërbimeve cilësore turistike dhe përdorimit të saj si force ekonomike të financohet edhe në mbrojtjen, ruajtjen dhe rigjallërimin e restaurimin e vlerave të rrezikuara të trashëgimisë natyrore e kulturore.

Organizimi i vizitave cilësore nga grupe të ndryshme të vizitorëve si dhe aftësimi i udhëheqësve turistik për informim dhe interpretim të vlerave të zonës, si ato historike, kulturore dhe natyrore, që krijojnë rritjen e interesimit të vizitorëve që rezulton me përfitime ekonomike për komunitetin dhe zonën e interesit.

Objektivi arrihet përmes këtyre veprimeve:

- *Shtimi i kapaciteteve të punës për pastrimin më të shpejtë dhe komplet të zonës nga minat;*

Aktiviteti më i rëndësishëm dhe i domosdoshëm i Qeverisë së Kosovës është angazhimi i menjëhershëm i saj për të shtuar kapacitetet njerëzore dhe të pajisjeve punuese të njësiteve të KFOR-it dhe të FSK-së me qëllim të pastrimit komplet të zonës së Memorialit të Koshraes nga minat e pashpërthyera për të siguruar në afatin sa më të shpejtë kohor lëvizjen e lirë dhe komode të vizitorëve dhe banorëve në këtë zonë.

- *Hartimi dhe zbatimi i projektit për shenjëzimin turistik:*
 - *Vendosja e tabelave info - orientuese në akse rrugore deri në 30 km largë Memorialit;*
 - *Përpilimi i hartes turistike për zonën e Memorialit me rrethinë;*
 - *Vendosja e tabelave informative (foto 19) dhe hartë turistike alpine (fig.24) në pikat hyrëse dhe kyqe të zonës;*

Foto 19. Pamje e modelit të tabelës informative. Burimi: Sh. B. A. "Pashtriku".






Figura 24. Harta turistike me shtigje në bërthamën e Memorialit të Koshares. Burimi: Sh. B. A. "Pashtriku".

Hartimi dhe zbatimi i projektit për shenjzimin turistik për dhe në zonën e Memorialit. Në projekt, duhet të përfshihet sigurimi dhe vendosja e tabelave sinjalizuese të drejtimit për në zonë në akset e afërta rrugore, hartimin e hartave turistike (fig. 24), orientuese dhe tematike mbi ngjarjet e luftës së UÇK-së si dhe vendosja e tyre në tabelat njoftuese - informuese - orientuese (foto 19). Tabelat e përgatitura vendosen nëpër kryqëzime të rrugëve e të shtigjeve si dhe në pikat kyqe të kësaj zone. Ky projekt, më se i domosdoshëm, do të realizohet në afat të shkurtë kohor (deri në 3 vite) nga Qeveria qendrore dhe ajo lokale ma mundësi bashkëpunimi me PPP.

- *Ngritja e pikave hyrëse - dalëse dhe të informimit në zonë;*
- *Ngritja e zyrave informuese turistike në qendrat komunale Gjakovë dhe Junik*
- *Hapje Web faqes për Memorialin e Koshares.*

Po ashtu, edhe aktivitetet tjera që shërbejnë për njoftimin, orientimin dhe informimin e vizitorëve për zonën e veçantë të Memorialit të Koshares, duhet të realizohen nga Qeveria qendrore dhe lokale dhe në afatin e shkurtër kohor (deri në 3 vite).

- *Trajnimi dhe aftësimi i ciceronëve turistik;*

Aftësimi i udhëheqësve turistik (ciceronëve), përmes trajnimeve të ndryshme duke freskuar në vazhdimësi njohuritë e tyre mbi të dhënat për trashëgiminë historike, kulturore, natyrore, të biodiversitetit, të peizazhit si dhe për zonat e reja turistike, në komunë dhe për rreth saj.

- *Përfshirja e Memorialit të Koshares në informatorët e manifestimeve për ditët e shënuara të ngjarjeve të luftës së UÇK-së;*
- *Përfshirja e Memorialit të Koshares në produktet e marketingut turistik.*

Ndikim të rëndësishëm në promovimin e zonës së mbrojtur dhe me interes të veçantë "Beteja e Koshares" do të ketë inkorporimi dhe përfshirja e këtij Memoriali në prezantimet, programet, informatorët dhe produktet e ndryshme mbi kërkimet shkencore, mbi edukimin ambientale, për organizime të manifestimeve si dhe të marketingut turistik (përmes fletëpalosjes " Shtigjet kulturore të Dukagjinit"; broshurën "Kosova përëndimore - më pranë se kurrë"; Guiden turistike të Gjakovës, etj.).

- *Ofrimi i programeve turistike për grupe të ndryshme të vizitorëve*

Me qëllim të pjesëmarrjes vetanake në financim, për menaxhim dhe mirëmbajtje të zonës së Memorialit, do të përcaktohet edhe çmimorja për ofrim të shërbimeve cilësore turistike, me nivele të ndryshme të pagesës për raste dhe grupe të caktuara të vizitorëve (studentë, personat me nevoja të posaçme, ekskursione, grupe rekreative, hulumtime – shkencore, arsimore, etj);

Objektivi 10. Ngritja e njohurive të banorëve lokal për vlerat e zonës dhe mundësinë e përfitimit ekonomik

Me këtë objektiv do të arrijmë forcimin e zhvillimit, për promovimin e produkteve cilësore dhe shërbimeve të bazuara në trashëgiminë natyrore dhe kulturore, përfshirë zanatet tradicionale, produktet lokale dhe elementët e tjerë që përbëjnë tipare dalluese lokale në përvojën e përjetimit të vizitorëve. Cilësia e vlerave të trashëgimisë natyrore e kulturore, në shumë zona, është thelbësore për gjenerim të hyrash dhe rritje ekonomike nëpërmjet zhvillimit turizmit dhe të blegtorisë, gjë e cila ndikon në përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit lokal duke u përshtatur dhe plotësuar kërkesat e vizitorit. Prandaj qëllimi jonë është që ti promovojmë tiparet dalluese të prodhimeve vendore dhe të kulturës lokale të jetesës, përmes arteve, zanateve, gatimit e kuzhinës, ngjarjeve kulturore, etj.

Për të arritur këtë objektiv duhet të ndërmerren këto veprime:

- *Krijimi i politikave të favorshme për banorët lokal me qëllim të zhvillimit turizmit rural;*

Nga niveli qendror dhe lokal i qeverisjes duhet të ndahen fonde, për përkrahjen e banorëve të vendbanimeve në zonë dhe për rreth saj, me qëllim të zhvillimit dhe ngritjes së ofertës turistike rurale. Në këtë drejtim, ndihma dhe stimulimi i tyre duhet të fokusohet në: rregullimin e shtëpive dhe kullave të vjetra (në veçanti prej guri) për akomodimin e vizitorëve e që dëshmojnë për mënyrën e të jetuarit, prezantimin e traditës dhe kulturës të kësaj ane si dhe në kultivimin e ngritjen e cilësisë së prodhimeve bujqësore e të blegtorisë.

- *Adaptimi i shtëpive - kullave të vjetra (prej guri) për nevoja të turizmit rural;*

Ky aktivitet, ka për rezultat, identifikimin e shtëpive apo kullave karakteristike të banimit, në fazën fillestare, kurse për fazën tjetër, do të ketë projektet për restaurimin dhe rijetësimin e tyre. Hartimi dhe zbatimi i këtyre projekteve, do të iniciohet dhe zbatohet nga sektorët relevant të qeverisjes lokal dhe qendrore, duke mundësuar edhe përfshirjen e organizatave tjera joqeveritare, shoqërinë civile si dhe komunitetin e biznesit, të cilat merren me veprimtari të trashëgimisë, turizmit dhe të zhvillimit rural, mirëpo gjithnjë në partneritet me pronarët – banorët lokal.

- *Programe për inkurajimin e popullsisë lokale për turizmin rural dhe kulturor;*

Niveli qendror në bashkëpunim me atë lokal duhet të angazhojnë ekspert të cilët do të prezantojnë dhe informojnë popullatën për rëndësinë dhe mundësitë e zhvillimit rural që ofrohen nga ruajtja dhe shfrytëzimi i vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Inkurajimi i banorëve të zonës dhe atyre për rreth saj, duke përfshirë edhe vizitat e organizuara jashtë vendit për njohjen e tyre me praktikën më të mira, është tjetër veprim, që edhe përmes aktiviteteve dhe manifestimeve tradicionale të kulturës dhe ushqimit, mund të realizohen programet për zhvillimin dhe menaxhimin e turizmit rural.

- *Komercializimi i kulturës lokale dhe përshtatja me kërkesat e vizitorëve turistik;*

Me komercializim të kulturës lokale nënkuptojmë: organizimin e manifestimeve të ndryshme për promovimin e kulturës shpirtërore dhe të prodhimeve ushqimore tradicionale nga banorët lokal për rreth zonës, për stimulimin dhe grumbullimin e bimëve mjekuese e aromatike, për kultivimin dhe prodhimin e artikujve të ri bujqësor, etj, me qëllim të zhvillimit të konkurrencës dhe plotësimit të nevojave dhe kërkesave të vizitorëve.

Objektivi 11. Krijimi i imazhit dhe promovimi i Memorialit të Koshares

Me këtë objektivi do të arrihet një imazh i krijuar për ZMIV "Beteja e Koshares", përmes realizimit të programeve dokumentare dhe aktiviteteve të parapara për marketing turistik, në bashkëpunim të ngushtë mes komunave të Gjakovës e Junikut dhe organit drejtues për menaxhimin të Memorialit si dhe të mediave e agjencive operuese turistike. Funksionimi dhe promovimi i imazhit të krijuar, për këtë zonë të veçantë, do të publikohet edhe përmes mediave të shkruara dhe elektronike, me ç'rast do të ndikoj pozitivisht në zhvillimin e mëtejshëm dhe të ardhshëm të Memorialit. Njohja ndërkombëtare e Memorialit, do të mundësonte informimin e çdo të interesuari, nga të gjitha vendet e botës, për resurset, vlerat dhe veçoritë natyrore dhe kulturore - historike në këtë zonë.

Objektivi arrihet duke respektuar dhe plotësuar këto veprime:

- *Realizimi i dokumentarit për luftën çlirimtare të UÇK-së përfshirë Betejën e Koshares;*
- *Realizimi i dokumentarit të shkurtër për vlerat e zonës së Memorialit;*
- *Përpilimi i ofertave turistike në formë katalogu, broshure, DVD-je, e të tjera;*

Përderisa, realizimi i dokumentarit për Luftën çlirimtare të UÇK-së mund ta bëhet vetëm nën drejtimin, përgjegjësinë dhe kompetencën e anëtarëve të atëhershëm të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, realizimi i dokumentarit tjetër për vlerat e ndryshme të zonës së Memorialit si dhe përpilimi i ofertave turistike mund të bëhet nga agjenci turistike në bashkëpunim me drejtorinë Komonale, mediat dhe OJQ-në "Veteranet e Brigades 138 Agim Ramadani", që mund të zgjasin deri në afatin e mesëm kohor (3 - 5 vjet).

- *Bashkëpunimi me diasporën tonë për realizimin e ofertave të përpiluara turistike;*
- *Ofrimi i ofertave të përpiluara përmes zyrave informative turistike nëpër qendrat komunale dhe në pikat kufitare;*
- *Organizimi i fushatave njoftuese për ofertat turistike (përmes programeve specifike turistike, katalogëve, DVD-ve, broshurave, etj);*
- *Organizimi i grupeve të mediave dhe agjencive turistike për promovimin e vlerave të zonës;*
- *Përfshirja e zonës së Memorialit në programet për edukimin ambientale;*
- *Promovimi i kërkimeve të ndryshme shkencore në zonën e Memorialit;*
- *Promovimi turistik i zonës së Memorialit nëpër konferenca, kongrese, reklama turistike, etj;*
- *Arritja e kontakteve dhe e kontratave të bashkëpunimit mes agjencive e kompanive lokale për turizëm me ato ndërkombëtare;*
- *Angazhimi i vazhdueshëm dhe pa rezervë i institucioneve të Republikës së Kosovës për pranimin e saj në organizata dhe agjenci ndërkombëtare për turizëm.*

Gjithashtu, bashkëpunimi me diasporën për realizimin e ofertave të përpiluara turistike si dhe ofrimi i tyre nëpër zyrat informative, janë përgjegjësi e agjencive turistike dhe mund të zgjatet deri në afatin e mesëm kohor. Kurse organizimet e agjencive turistike me grupet e mediave për fushatat njoftuese dhe promovuese të vlerave specifike dhe të përgjithshme të zonës duke i përfshirë ato edhe programet, konferencat, kongreset dhe reklamat e ndryshme.

Angazhimi i vazhdueshëm i agjencive dhe kompanive lokale për turizëm si dhe të institucioneve qeverisëse për pranimin e Republikës së Kosovës në organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare, si: Organizatën Botërore të Turizmit (WTO), Këshillin Botëror për Turizëm dhe Udhëtim (WTTC), Federatën Ndërkombëtare të Operatoreve Turistik (IFTO), e të tjera, është i pashmangshëm, me qëllim të futjes dhe ngritjes së konkurrencës.

Vëmendje:

Në vazhdim, janë paraqitur Hartat Strategjike (të zhvillimeve hapësinore në kontekstin e ngushtë - brenda zonës së mbrojtur dhe me interes të veçantë dhe në kontekstin e gjerë - të ndërlidhjes së zonës me rajonin rrethues) si dhe Plani i Veprimit Strategjik.

Strategjia e Memorialit të Koshares, harta e kontekstit më të gjerë, si në fig. 25, paraqet dhe tregon pozitën qendrore të kësaj zone dhe rolin e saj rrezatues e të urave lidhëse me pikat më të vizituara turistike në rrethinën më të gjerë hapësinore. Përcaktimi i zonës si pikë stacionimi dhe ndërmjetësimi për vendet tjera turistike e atraktive për vizitorët bazohet në Konceptin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor (në kuadër të “Kornizës” - si fazë e tretë e procesit të planifikimit).




Figura 25. Harta strategjike e Memorialit të Koshares – konteksti i gjerë. Burimi: IPH.

Strategjia e Zhvillimit Hapësinor të Memorialit të Koshares, harta e mëposhtme në fig. 26, paraqet dhe tregon veprimet me shtrirjen e tyre hapësinore, nga të gjitha ato që janë listuar më sipër në strategjinë e zhvillimit të ardhshëm. Zhvillimet që shihen në hartë shprehin ndërhyrjet e nevojshme e të domosdoshme për qëndrueshmërinë e Memorialit të Koshares dhe janë veprime të kontekstit të ngushtë të zonës së mbrojtur dhe me interes të veçantë “Beteja e Koshares”.




Figura 26. Harta e strategjisë së zhvillimit të ZMIV "Beteja e Koshares" – konteksti i ngushtë. Burimi: IPH.

PLANI I VEPRIMIT STRATEGJIK

Plani i Veprimit Strategjik, si në vijim, është pjesa më kryesore e këtij Plani Hapësinor dhe paraqet të gjitha aktivitetet, masat ose projektet konkrete të renditura në një tërësi të vetme dhe në formë tabelore, përderisa shtrirja hapësinore e shumë prej tyre u pa edhe në hartat pararendëse më lartë.

Plani i Veprimit Strategjik në PH për ZMIV "Beteja e Koshares"						
Objekti	Veprimi (Aktivitet / Masë / Projekt)	Vendim- marrës	Zbatues	Afati kohor	Buxheti	Kosto (€uro)
SYNIMI 1. PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI I ZHVILLIMEVE NË ZONË						
O1. <i>Administrimi i zones dhe Menaxhimi i zhvillimeve</i>	<i>Themelimi i Autoritetit Drejtues për Administrim dhe Menaxhim</i>	Qeveria	MMPH / Komuna	*	BK	
	<i>Hartimi i Planit për Menaxhim të zonës së Memorialit</i>	MMPH / Komuna	Qeveria / AD / OJQ / Komp.publ	*	BK	5.000
	<i>Shpronësimi i pronave sipas ligjeve në fuqi</i>	MMPH / MF	MMPH, DSh / MF	*	BK	500.000
O2. <i>Planifikimi, zbatimi dhe kontrolli i zhvillimeve</i>	<i>Hartimi i PRRU-së (Planit Rregullues Urban) sipas Detyrës Projektuese</i>	MMPH	MMPH / Komuna	*	BK / Donac.	50.000
	<i>Ngritja dhe ndërtimi i Elementeve të Kompleksit të Memorialit sipas PRRU-së</i>	MMPH	MMPH / Komuna /	**	BK / Donac. / PPP	1.200.000
	<i>Ngritja e kapaciteteve të Muzeut për luftën e UÇK-së në Gjakovë përfshirë ekspozitat nga Beteja e Koshares</i>	Qeveria	MKRS / Komuna	**	BK / Donac. / PPP.	100.000
	<i>Rikonstruktimi dhe konservimi i Istikameve Kryesore sipas PRRU-së</i>	Qeveria / Komuna	MKRS / MMPH / Komuna	*	BK / Donac. / PPP	30.000
	<i>Konservimi i Karakollit dhe i Kullës Vrojtuese sipas PRRU-së</i>	Qeveria / Komuna	MKRS / MMPH / Komuna	*	BK / Donac. / PPP	40.000
	<i>Rregullimi i pikave të rëndësishme së veçantë për luftën e UÇK-së në zonë sipas PRRU-së</i>	Qeveria / Komuna	MMPH / MTI / MKRS / Komuna	*	BK / Donac. / PPP	30.000
	<i>Hartimi i projektit dhe konservimi i ngjarjeve të luftës përmes efekteve të zërit e të dritës në Rrasën e Koshares</i>	Qeveria	MMPH / MKRS / MTI	***	BK / dorac. / PPP	-
	<i>Hartimi i projekt-planit për rregullimin dhe funksionimin e kampingjeve (në Brahë dhe Koshare</i>	Qeveria	MMPH / MTI / MI / Komuna	**	BK / Donac. / PPP	-
	<i>Hartimi dhe zbatimi i Projektit hulumtim-kërkim të mureve të Fortesës së Jerinës.</i>	Qeveria	MKRS, IAK / Komuna	*	BK / Donac.	5.000
O3. <i>Mbrojtja</i>	<i>Largimi i Gurëthyesit dhe rehabilitimi i lokacionit të degraduar</i>	Qeveria	KPMM / MMPH / Komuna	*	-	-

	<i>Promovimi i llojeve të veçanta biologjike të zonës</i>	MMPH / Komuna	MMPH / Universitet i / OJQ	***	BK / Donac	3.000
	<i>Identifikimi i lokacionit dhe hartimi projektit për ngritjen e digës në Lumin Gusha (për shfrytëzim të trefishtë)</i>	Qeveria / Komuna	MMPH / MZhe / MI / MPB / Komuna	**	BK / Donac. / PPP	3.000
	<i>Konsolidimi dhe konservimi i mureve të identifikuara të Fortesës së Jerinës</i>	MKRS / MMPH	MKRS, IAK / Komuna	***	BK / Donac. / PPP	50.000
	<i>Stimulime për rindërtimin dhe rijetësimin e shtëpive / kullave tradicionale në fshatin Koshare</i>	Qeveria / Komuna	MKRS / MMPH / MTI / Komuna	**	BK / Donac. / PPP	200.000
	<i>Stimulime për rigjallërimin kullave tradicionale në VB për rreth zonës (Junik, Jasiq, Gjocaj, Batushë, Brovinë, Mulliq, Ponoshec dhe Morinë)</i>	Qeveria / Komunat	MKRS / MTI / Komunat	***	BK / Donac. / PPP	800.000

SYNIMI 2. SIGURIMI I QASJES SË LEHTË DHE SHËRBIMEVE TEKNIKE NË ZONË

O 4. <i>Sigurimi i infra-strukturës rrugore dhe transportit</i>	<i>Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës kryesore (primare) prej hyrjes në zonë nga fshati Batushë për në Kompleksin e Memorialit sipas projektit paraprak</i>	Qeveria	MI	*	BK / Donac. / PPP	1.000.000
	<i>Rregullimi dhe shtruarja e tamponit në rrugën dytësore (sekondare) Junik -Jasiq – për në Kompleksin e Memorialit sipas projektit psrsprsk</i>	Qeveria	MI	***	BK / Donac. / PPP	1.500.000
	<i>Rregullimi dhe shtruarja me zhavor e rrugës dytësore për në Karakoll dhe në R. e Shqipërisë sipas projektit paraprak për variantin I ose II</i>	Qeveria / Komuna	MI / Komuna	**	BK / Donac. / PPP	1.100.000
	<i>Zbatimi i projektit paraprak të Teleferikut nga Kompleksi Memorial deri në Rrasë të Koshares</i>	Qeveria	MI / MTI / MMPH	***	BK / Donac. / PPP	500.000
	<i>Zbatimi i projektit për rregullimin e shtigjeve për këmbësor dhe kalërim si dhe të hapësirave për vend – ndalesa, pushim, rekreim dhe vrojtim</i>	Qeveria / Komuna	MI / MTI / MMPH / Komuna	**	BK / Donac. / PPP	700.000
	<i>Zbatimi i projektit për rregullimin e rrugëve malore tjera për automjete të lehta të motorike dhe të zjarrfikësve në zonën e Memorialit</i>	Qeveria / Komuna	MI / MTI / MPB / Komuna	***	BK / Donac. / PPP	50.000
	<i>Rregullimi i pikave rekreative – sportive të parashutizmit në Rrasë të Koshares (në rreth 1400m lmd) dhe në vendin Guri n'gul (1800m lmd)</i>	Qeveria / Komuna	MI / MTI / MKRS / Komuna	***	BK / Donac. / PPP	5.000
O 5. <i>Sigurimi i</i>	<i>Ndërtimi i linjave të reja furnizuese 10 kV gjegjësisht 0.4 kV me trafo-stacione përcjellës</i>	Qeveria / Komuna	MZhe / MI / Komuna	**	BK / Donac. / PPP	
	<i>Zëvendësimi i linjave ajrore me ato kablllore nëntokësore</i>	Qeveria / Komuna	MI / MZhe, KEK / Komuna	***	BK / Donac. / PPP	200.000

	<i>Vendosja e shtyllave për ndriçim publik të hapësirave me përmbajtje të theksuar zhvillimore brenda zonës</i>	Qeveria / Komuna	MI / MZHE, KEK / Komuna	***	BK / Donac. / PPP	600.000
O 6. <i>Sigurimi i infra-strukturës ujore</i>	<i>Instalimi i sistemit të ujësjellësit dhe të kanalizimit në Komplexin e Memorialit</i>	Qeveria / Komuna	MI / MMPH / Komuna, Komp.Publ	**	BK / Donac. / PPP	80.000
	<i>Rregullimi i krojeve përkaj rrugëve dhe shtigjeve për këmbësor dhe kalërim</i>	Qeveria / Komuna	MI / MMPH / Komuna, Komp.Publ	***	BK / Donac. / PPP	10.000
	<i>Sistemimi dhe rregullimi i sanitarëve në dy zonat e kampingjeve</i>	Qeveria / Komuna	MI / MMPH / Komuna. Komp.Publ	***	BK / Donac. / PPP	20.000
	<i>Ndërtimi i impiantit për trajtim të ujrave të zeza</i>	Qeveria / Komuna	MI / MMPH / Komuna	***	BK / Donac. / PPP	12.000
	<i>Ngritja dhe ndërtimi i digës së rezervuarit të ujit në Lumin Gusha (për ndërhyrje në rast zjarri në zonë)</i>	Qeveria / Komuna	MI / MPB / MMPH / Komuna	***	BK / Donac. / PPP	150.000
	O 7. <i>Sigurimi i infra-strukturës për tele-komunikim</i>	<i>Instalimi i linjës kablore nëntokësore për sjelljen e sinjalit të telefonisë fikse në Kompl. Memorial</i>	Qeveria / Komuna	MI, PTK / Komuna	***	BK / Donac. / PPP
<i>Vendosja e antenave dhe fijeve optike në përforcimi i rrjetit difuziv (pa tela - wireless) për internet, telefoni mobile dhe TV kabllor në zonat e zhvillimit</i>		Qeveria / Komuna	MI, PTK / Komuna	***	BK / Donac. / PPP	180.000
<i>Instalimi i pajisjeve (marrësit të sinjalit dhe të kablove) në ndërtesat e përhershme në kampingje dhe në Kompl. Memorial</i>		Qeveria / Komuna	MI, PTK / Komuna	***	BK / Donac. / PPP	6.000
O 8. <i>Sigurimi i menaxhimit të mbeturinave</i>	<i>Vendosja e kontejnerëve dhe shportave për grumbullimin e mbeturinave në zonat e zhvillimit (Kompleks Memorial, kampingje dhe në zgjerimet për pushim buzë rrugë e shtegu)</i>	Qeveria / Komuna	MI / Komuna Komp.Oper	*	BK / Donac. / PPP	12.000
	<i>Largimi i mbeturinave nga zona e Memorialit dhe dërgimi tyre në deponi sipas orarit të akorduar</i>	Qeveria / Komuna	MI, PTK / Komuna	***	BK / Donac. / PPP	180.000
SYNIMI 3. ZHVILLIMI I TURIZMIT NË ZONË DHE TË VENDBANIMEVE PËR RRETH SAJ						
O 9. <i>Sigurimi dhe ofrimi i shërbimeve cilësore turistike</i>	<i>Shtimi i kapaciteteve të punës për pastrim më të shpejtë dhe komplet të zonës nga minat</i>	Qeveria / Komuna / KFOR	KFOR / MFS, FSK / Komunat	*	BK / Donac. / PPP	120.000
	<i>Zbatimi i projektit për shenjëzim turistik, me: Vendosjen e tabelave info</i>	Qeveria / Komunat	MTI, DT / MMPH / Komunat	**	BK / Donac. / PPP	30.000

	- Përpilimin e hartës turistike për zonën e Memorialit me rrethinë, - Vendosjen e tabelave informative dhe hartë turistike alpine në pikat kyqe të zonës, etj					
	Ngritja e pikave hyrëse - dalje dhe të informimit në zonë	Qeveria / Komunat	MMPH / MTI / Komunat	*	BK / Donac. / PPP	10.000
	Ngritja e zyrave informuese turistike në qendrat komunale Gjakovë dhe Junik	Komunat	Komunat, DUMK & DZhE	*	BK / Donac. / PPP	40.000
O10. Ngritja e njohurive të banorëve lokal për vlerat e zonës dhe mundësinë e përfitimit ekonomik	Adaptimi i shtëpive - kullave prej te vjetra (prej guri) për nevoja të turizmit rural	Qeveria / Komunat	MTI / MKRS / MBPZhR / Komunat / OJQ-të	***	BK / Donac. / PPP	300.000
	Komercializimi i kulturës lokale dhe përshtatja me kërkesat e vizitorëve turistik	Komunat	DZhE, DKASh, DBPZhR	***	BK / Donac. / PPP	25.000
O11. Krijimi i imazhit dhe promovimi i Memorialit të Koshares	Realizimi i dokumentarit për luftën çlirimtare të UÇK-së përfshirë Betejën e Koshares	Qeveria	MKRS / MFS	*	BK / Donac. / PPP	15.000
	Realizimi i dokumentarit të shkurtër për larimantinë e vlerave të zonës së Memorialit	Qeveria	MTI / MKRS / MMPH / MFS	**	BK / Donac. / PPP	7.000
	Përpilimi i ofertave turistike në formë katalogu, broshure, DVD-je, e të tjera	Qeveria / Komunat	MTI / MKRS / MMPH	***	BK / Donac. / PPP	15.000

Shuma e përgjithshme e vlerësuar për realizimin e aktiviteteve është afërsisht 10.000.000 €.

Shënim për afatin kohor të realizimit të veprimeve: (*) afat-shkurtë - deri në 3 vjet, (**) afat-mesëm - 3 deri në 7 vjet, (***) afat-gjatë - mbi 7 vjet dhe në vazhdimësi.

V. DISPOZITAT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

5. DISPOZITAT PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË

Dispozitat për zbatim të kësaj Strategjie, paraqesin kushtet dhe masat me karakter obligues, që ndikojnë drejtpërdrejt në realizimin e duhur të aktiviteteve më të rëndësishme, mbi çështjet e parapara, për zhvillimin, rregullimin dhe shfrytëzimin e hapësirës e të infrastrukturës si dhe për mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave mjedisore dhe të trashëgimisë në Zonë së Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë “Beteja e Koshares” për të cilën hartohet ky Plan Hapësinor.

5.1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME MBI PLANIN HAPËSINOR

- Me këtë Plan Hapësinor, për zonën e mbrojtur dhe me interes të veçantë “Beteja e Koshares” (në tekstin e mëtejme: Plani), definohej caqet dhe përgjegjësitë e organizimit e të rregullimit të hapësirës si edhe kushtet dhe masat për shfrytëzim dhe mbrojtje të vlerave të trashëguara të zonës së veçantë dhe më gjerë.
- Plani përfshihet në projekt-elaboratin “Plani Hapësinor për Zonën e Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë “Beteja e Koshares” i punuar nga Instituti për Planifikim Hapësinor në bashkëpunim të ngushtë me Grupin Punues Ndër-institucional.
- Anëtarët e GPNI-së emërohen nga autoriteti i MMPH-së në bazë të preferencës së deleguar nga autoriteti i përfaqësuar.
- Plani përbëhet nga pjesa tekstuale e grafike, ku përfshihen harta, tabela dhe foto të ndryshme.
- Plani mbulon periudhën kohore prej më shumë se dhjetë viteve, gjegjësisht 2013 - 2023+.
- Rishikimi i Planit bëhet në çdo pesë vite, por mund të bëhet edhe sipas kërkesave që janë rezultat i ndryshimeve eventuale në terren;
- Përgjegjës për rishikim të Planit është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përkatësisht AMMK / Instituti për Planifikim Hapësinor;
- Plani është punuar sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor, në përputhje edhe me ligjet tjera në fuqi, si dhe në pajtim me direktivat, konventat dhe parimet ndërkombëtare për planifikim, zhvillim dhe mbrojtje të mjedisit.
- Plani ka për bazë PHK 2010 - 2020+ dhe mbështetet në përkufizimet e trajtuara në kaptinat për “zonat e mbrojtura” dhe “zonat e veçanta”
- Të gjitha planet dhe strategjitë tjera, sektoriale apo komunale (plane të nivelit më të ulët), me ndikim në territorin e zonës ku është zhvilluar Beteja e Koshares, duhet të përshtaten sipas këtij Plani.

5.2. KUSHTET DHE MASAT E PËRGJITHSHME DHE TË PËRCAKTUARA NGA QEVERIA DHE PUSHTETI LOKAL

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Planit Hapësinor për Zonën e Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë “Beteja e Koshares”.
- Zona e Mbrojtur dhe me Interes të Veçantë ku është zhvilluar “Beteja e Koshares” nga Brigada 138 Agim Ramadani, e emërtuar edhe si Memoriali i Koshares, përfshinë sipërfaqe prej 2488 hektarëve që i përkasin pronësisë private dhe publike (ish shoqërore) në territorin e Komunës së Gjakovës.
- Në zonën e Memorialit të Koshares, nuk duhet të shpronësohen të gjitha pronat private, përveç atyre në bërthamë (zonë qendrore) me rreth 10 ha në Log të Koshares (Oplaz) brenda së cilës janë Varrezat ekzistuese të Dëshmorëve nga Brigada 138.
- Autoritetet përkatëse janë përgjegjëse për realizimin e inventarizimit, vlerësimit të paluajtshmërisë dhe të vendimeve për shpronësimin e pronave që janë këtë zonë.
- Zona e bërthamës në qendër të Memorialit të Koshares, është rezervuar për ngritjen e Elementeve të Kompleksit të Memorialit, në të cilën pas shpronësimit komplet dhe ndërrimit të titullarit të pronës (nga prona private në atë publike) mund të zbatohet Plani Rregullues Urban i hartuar paraprakisht.
- Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht MMPH-ja, merr përgjegjësitë për hartimin dhe zbatimin e PRRU-së (Planit Rregullues Urban).
- PRRU-ja duhet hartuar në bazë të kërkesave që dalin në Detyrën Projektuese, për ngritje të Kompleksit Memorial në Logun e Koshares, për konservim të ish-Karakollit dhe të ngjarjes së luftës në Rrasë të Koshares si dhe për rregullim të rrugëve malore, të shtigjeve për ecje dhe të vend-ndalesave (mobilitet dhe përjetim) në zonën e veçantë “Beteja e Koshares”.
- Kompania që përpilon planin rregullues urban, gjatë procesit të përpilimit duhet të mbajnjë kontakt të vazhdueshëm me MMPH me qëllim të konsultimit dhe njohtimit të saj për ecurinë e procesit.
- Duhet të ekzistojë një bashkëpunim i frytshëm, në trekëndshin Qeveri - Komunëa - Kompani përpiluese e planit rregullues, në mënyrë që të gjenden investitorët për projektet që parashihen me planin rregullues urban. Investimet mund të jenë krejtësisht qeveritare, private, por mund të krijohen edhe nga partneriteti - publik -privat (PPP).
- Zbatimi i PRRU-së së aprovuar nga qeverisja qendrore dhe lokale, realizohet me ngritjen dhe ndërtimin e Elementeve të Kompleksit të Memorialit, sipas projekteve të veçanta për zbatim për secilin element veç e veç në kuadër të këtij plani, me mundësi të investimit edhe nga Partneriteti Publik Privat (PPP).
- Ndërtimi i rrethojës për pengimin e hyrje-daljes së kafshëve brenda territorit të Kompleksit të Memorialit është i obligueshëm.
- Asnjë ndërmarrje ndërtimore nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e vet pa qenë e licencuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI);
- MMPH-ja lëshon pëlqimin, për ngritje të kampingut dhe ndërtim të objekteve në zonë, të hartuar në bazë të pëlqimeve nga sektorë tjerë relevantë dhe të VNM-së.
- Lejen për ngritjen e kampingut dhe ndërtimin e objektit në zonë e lëshon Drejtoria e Urbanizmit në Komunën e Gjakovës.
- Certifikata për përdorim të objekteve dhe të tërësisë hapësinore për kampingjet e organizuara, merret në Drejtorinë e Urbanizmit në Komunën e Gjakovës, pasi të jenë plotësuar kushtet e rekomanduara nga MMPH / IPH-ja.
- Inspektorati nga niveli qendror dhe lokal bëjnë mbikëqyrjen dhe kontrollin e zhvillimeve në zonë.

5.2.1. PËRGJEGJËSITË E AUTORITETIT PËR MENAXHIMIN E ZONËS

- Qeveria e Kosovës, përkatësisht MMPH-ja, në bashkëpunim me autoritetet e qeverisë lokale themelon Autoritetin Drejtues (AD), si institucion publik për Administrim të zonës së veçantë dhe menaxhim të zhvillimeve brenda Memorialit të Koshares, si dhe përcakton përbërjen e stafit dhe përgjegjësitë e tyre.
- Qeveria e Kosovës, përkatësisht MMPH-ja, përcakton financimin e nevojshëm për funksionimin e AD-së, i cili përbëhet nga buxheti i Kosovës dhe nga të hyrat e siguruarat prej vizitave turistike në zonë.
- AD-ja menjëherë pas themelimit fillon me procedurën për hartimin e Rregullores së Brendshme për administrim dhe më pas edhe të Planit për Menaxhim të zhvillimeve në territorin e zonës së Memorialit të Koshares.
- Administrimi dhe funksionimi i menaxhimit të zonës së mbrojtur dhe me interes të veçantë nga AD nënkupton dhe përfshinë:
 - masat për mbrojtjen, ruajtjen dhe shfrytëzimin e vlerave mjedisore dhe të trashëguara në zonë,
 - kontrollin mbi zhvillimet e ardhshme në zonë, dhe
 - mbikqurjen e vizitorëve gjatë frekuentimit të organizuar të tyre nëpër zonë
- AD duhet të ndërtojë sistem të plotë informimi/njoftimi në tërë zonën e Memorialit i cili duhet të dizajnohet në mënyrë të veçantë dhe complete;
- AD monitoron aktivitetet për hulumtime shkencore dhe udhëheq punën edukative-arsimore gjatë ekskursioneve të paraprirë nga ekspertët profesional në zonë;
- AD në bashkëpunim me DT/MTI-në duhet të përgatisin ofertën turistike në të cilën specifikohen: kushtet për vizitat mbikëqyrura në zonën e Memorialit, orientimin dhe lëvizjen nëpër shtigjet e organizuara, vërejtjet dhe udhëzime për vlerat e vegjetacionit dhe mbrojtjen e tyre;
- AD duhet të nxitë dhe orienton banorët lokal në vendbanimet rurale përreth Memorialit për revitalizimin e ekonomive shtëpiake për turizëm rural dhe ndihmon në kycjen e tyre në ofertat turistike, në pajtim me objektivat e këtij Plani.
- Plani për Menaxhimin e zonës së Memorialit të Koshares duhet të përmbajë:
 - Monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zhvillimeve në tërë zonën e Memorialit të Koshares e posaçërisht brenda Kompleksit të saj përkujtimor;
 - Plan - programin e hollësishëm për rregullimin e dy zonave të zhvillimit (në Brahë dhe fshatin Koshare), në ngritje të kampingut dhe sistemim të nevojshëm të shërbimeve teknike, për:
 - Rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit,
 - Rrjetin e energjisë elektrike dhe
 - Menaxhimin e mbeturinave;
- Plan - programin e hollësishëm për shfrytëzimin e ZMIV-të, si burimin financiar i cili përmban:
 - Menaxhimin e të hyrave në zonë,
 - Programi për pagesa, varësisht nga grupet e vizitorëve, dhe
 - Lehtësime për familjet e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së në pagesat gjatë vizitës së Memorialit të Koshares;
- Plan-programin e hollësishëm për marketingun e Memorialit të Koshares;
- Plan-programin e hollësishëm për organizimin e vizitave në zonë sipas paketave dhe ofertave turistike;
- Dizajnimin e simbolit të ZMIV dhe propozimet për vendosjen e tij.

5.2.2. ZHVILLIMI, RREGULLIMI DHE SHFRYTËZIMI I HAPËSIRËS

- Në ZMIV "Beteja e Koshares" ka hapësira me vlera natyrore, kulturore dhe hapësira apo tërësi me vlerë historike.
- Zonat dhe tërësitë me vlerë të veçantë duhet të mbrohen nga degradimi i mjedisit dhe dëmtimi fizik i objekteve që ndodhen atje.
- Në hapësirën apo zonën me vlera natyrore dhe kulturore duhet të ketë qasje të mirë përmes shtigjeve për këmbësorë, kurse në hapësirën me vlerë historike si dhe në hapësirën e Kompleksit të Memorialit, duhet të sigurohet e tërë infrastruktura e nevojshme fizike dhe shërbimet që lidhen me të.
- Hapësira me vlera natyrore rregullohet me planin hapësinor dhe Menaxhues për ZMIV "Beteja e Koshares", kurse hapësira e Memorialit si vlerë kulturo-historike rregullohet me planin rregullues urban, i cili është më hollësisht dhe i kërkuar nga PH për këtë zonë.
- Në këto zona dhe tërësi nuk lejohet asnjë intervenim që nuk është në përputhje me këtë plan hapësinor dhe me planin rregullues urban.
- Varrezat e Dëshmorëve duhet të jenë në qendër të Kompleksit Memorial dhe se Elementet tjera përcjellëse nuk guxojnë të kalojnë lartësinë e lapidarit (mbi 10 metra).
- Hartimi i Planit Rregullues për në Memorialin e Koshares duhet të realizohet nga një Kompani Private, që del fituese në konkursin e hapur ideor, e përzgjedhur nga Komisioni Profesional, nën organizim dhe mbikëqyrje të MMPH-së.
- Hartimin e Planit Rregullues duhet bazuar në kërkesat e Detyrës Projektuese dhe përfshinë:
 - ngritjen dhe rregullimin e Kompleksit të Memorialit me Elementët përbërës të tij në Logun e Koshares,
 - rregullimin e vëndrënjeve të Heronjve të Kombit në Rrasën e Koshares,
 - rindërtimin dhe konservimin e Istikameve (kryesore, të veçanta dhe në varg) në Rrasën e Koshares,
 - konservimin e ish-Karakollit të bombarduar afër Glavës dhe të vëzhgimores ushtarake në Majë të Glavës, si dhe
 - rregullimin e rrugëve malore e të shtigjeve për këmbësor e kalërim me zgjerimet dhe vend-ndalesat e nevojshme përskaj tyre.
- Aprovimi dhe zbatimi i Planit Rregullues duhet të bëhet në bazë të marrëveshjes dhe nën koordinim të qeverisë qendrore dhe lokale.
- Ndërtimi i teleferikut, prej kompleksit të Memorialit deri në Rrasë të Koshares, me rreth 700 m' gjatësi dhe me ndryshim niveli prej 350 m' të l.m.d, të realizohet sipas projektit paraprak, me mundësi të shfrytëzimit të energjisë së ripërtritshme, të aprovuar nga MTI, MZHE dhe MMPH.
- Lejohet ndërtimi i objekteve të reja në zonën ndërtimore të fshatit Koshare kur ato ruajnë arkitekturës tradicionale dhe nuk kalojnë etazhitetin B+P+1+NK (ose lartësinë prej 10 metrash).
- Lejohet ndërtimi i objekteve të vogla (të montuara e të përkohshme), përdhese me sipërfaqe nën 10 m², të karakterit shërbyes - tregtar për përmbushjen e nevojave turistike.
- Lejohet ndryshim shfrytëzimi paraprak pas rindërtimit të objekteve me përmasat ekzistuese në fshatin Koshare, të cilat ishin shkatërruar por që kanë shërbyer vetëm për mësim, banim dhe stallë për bagëtinë, duke i shndërruar ato në objekte me karakter turistik për pranimin, akomodimin dhe ushqimin e vizitorëve.
- Përkrahje banorëve të fshatit Koshare përmes granteve qeveritare dhe joqeveritare për rindërtimin e objekteve të shkatërruara gjatë luftës së viteve 1998-99.
- Lehtësime nga Qeveria e Kosovës për rindërtimin dhe adaptimin e objekteve me arkitekturë tradicionale dhe në përmasat ekzistuese në fshatin Koshare për pritjen, akomodimin dhe ushqimin e vizitorëve.
- Përparësi që të punësohen në vendet e reja të punës që do të hapen me zbatimin e planit hapësinor dhe planit rregullues urban duhet të kenë ish luftëtarët e Brigadës 138 Agim Ramadani.

- Banorëve vendës në gjendje ekonomike-financiare më të rëndë duhet t'u ndihmohet që edhe ata sikur të tjerët të mund t'i shfrytëzojnë objektet dhe hapësirat me destinime të ndryshme që parashihen në ZMIV "Beteja e Koshares".
- Përfshirja e të rinjve, banorë të zonës në aktivitetet kulturore, sportive e rekreative në zonë që mund të organizohen nga komunat, nga vet ata apo nga dikush tjetër, parandalon mundësinë e përfshirjes së tyre në dukuri negative.
- Në projektimin e objekteve të parapara sipas planit rregullues në Kompleksin e Memorialit duhet të aplikohen normat që ofrojnë infrastrukturën e nevojshme për qarkullimin e personave me nevoja të veçanta. Komunat nuk do të lëshojnë asnjë leje ndërtimi për objektet për të cilat nuk është marrë parasysh aplikimi i këtij kriteri.
- Lejohet shfrytëzimi i amfiteatrit të Kompleksit të Memorialit për organizime të manifestimeve të kontrolluara kulturore - artistike dhe turistike.
- Lejohet përdorimi i makinave të lehta motorike nëpër shtigjet për këmbësorë vetëm kur barten vizitorët me aftësi të kufizuara për ecje.
- Lejohet grumbullimi i sistemuar dhe nën monitorim i frutave malore dhe bimëve mjekuese në zonë dhe për rreth saj.
- Lejohet kullotja e sistemuar dhe nën monitorim e kafshëve (gjedheve dhe deleve) në kullosat e zonës dhe për rreth saj.
- Organizimi dhe rregullimi i pikave për vrojtim të peizazhit dhe atyre për sport dhe rekreacion aerodinamik realizohen në bazë të kërkesave dhe marrëveshjes mes MMPH-së, MKRS-së, komunës dhe klubeve sportive aerodinamike.
- Organizimi dhe rregullimi i kampingjeve malore të realizohet në zonat zhvillimore të përcaktuara me Plan të Menaxhimit (në zonën ndërtimore të fshatit Koshare dhe në Braha) dhe në bazë të kërkesave dhe marrëveshjes mes MMPH-së, MI-së, MTI-së dhe shoqatave bjeshkatore.
- Rregullimi i hapësirave për kampingje dhe ofrimin e shërbimeve të organizuara turistike të realizohet në bazë të marrëveshjes së MMPH-së me Komunën e Gjakovës, organizatat për shërbime publike dhe PPP-në.
- Vendosja e kontejnerëve për grumbullimin e mbeturinave si dhe bartja / largimi i mbeturinave të grumbulluara të realizohet nga Kompania Publike në bazë të projektit paraprak të aprovuar me Planin e Menaxhimit nga AD-ja.
- Përcaktimi i numrit të burimeve ujore për rregullim - ndërtimin e krojeve, në bazë të cilësisë së ujit në vendndalesat e përshtatshme për vrojtim dhe pushim, përskaaj dhe në afërsi të rrugëve apo shtigjeve.

5.2.2. MBROJTJA DHE RUAJTJA E VLERAVE

- Në ZMIV "Beteja e Koshares" duhet të parandalohet ndikimi i dëmshëm në ajër, në burimet dhe përroskat ujore si dhe në tokë, ndikim që do të mund të vinte nga ndonjë kapacitet ndotës industrial, hedhja e mbeturinave në rrjedhat ujore dhe në tokë, prerja ilegale e pyjeve apo cenimi i monumenteve natyrore përmes aktiviteteve të paplanifikuara dhe të jashtëligjshme.
- Pengimi i ndikimeve të dëmshme në mjedis bëhet duke futur në funksion instrumentet për mbrojtjen e mjedisit që janë të listuar në Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit.
- Dokumentet për mbrojtjen e mjedisit janë: Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit, Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis, Planet e Veprimit Lokal në Mjedis dhe Programet Mjedisore. Këto plane duhet të zbatohen me përpikëri në mënyrë që të pengohet ndikimi i dëmshëm në mjedis.
- Dokumentet për vlerësimin e ndikimit në mjedis janë: Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM). VSM bëhet për planet dhe programet të cilat

kanë mundësi të kenë ndikim të theksueshëm në mjedis, kurse VNM bëhet për projektet të cilët planifikohen të realizohen në hapësirë të caktuar e që mund të kenë ndikim të dëmshëm në mjedis. Nuk është e domosdoshme të bëhet VSM për planin hapësinor të ZMIV “Beteja e Koshares” sepse ky plan nuk do të ketë ndikim shumë të theksueshëm në mjedis, mirëpo për projekte të caktuara që i parasheh plani rregullues urban duhet të bëhet VNM, pa të cilin nuk mund të fillojë zbatimi i tyre.

- Instrumentet për monitorimin e mjedisit – Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit (LMM), MMPH dhe komunat në kuadër të përgjegjësive të veta të përcaktuara me ligj sigurojnë kontrollin e vazhdueshëm dhe bëjnë monitorimin e gjendjes së mjedisit. Organizatat për monitorimin e mjedisit që janë themeluar dhe personat juridik ose fizik duhet t’i përmbushin detyrimet që i kanë sipas LMM sa i përket monitorimit të mjedisit.
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit obligon mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e këtij ligji. Këtë mbikëqyrje e bën Inspektorati mjedisor i MMPH kurse mbikëqyrjen inspektuese për Lejen Mjedisore Komunale e kryen inspektori komunal i mjedisit.
- Evidentimi dhe mbrojtja e burimeve ujore në Memorialin e Koshares nga DMU dhe AMMK në kuadër të MMPH-së.
- Mbeturinat nuk mund të hidhen kudo në hapësirën e ZMIV “Beteja e Koshares”. Ato duhet të jenë nën Menaxhimin (grumbullimi, mbledhja, trajtimi dhe deponimi i mbeturinave) e personave fizik apo juridik për administrimin e mbeturinave.
- Vendosje e gjobave nga MMPH/AMMK-ja për hedhjen e mbeturinave jashtë vendit të caktuar (kontejnerë).
- Aktivitetet që duhet t’i kryejnë personat për administrimin e mbeturinave janë të rregulluara me Ligjin nr. 04/L-060 për Mbeturinat.
- Personat për administrimin e mbeturinave duhet të jenë të pajisur me licenca të cilat i lëshon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).
- Iniciativa dhe hartimi i projekt - propozimeve nga PPP dhe MMPH/AMMK-ja për ndarjen, përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave të grumbulluara.
- Ndërtimi i rrugëve për qarkullim të automjeteve zjarrfikëse do të realizohet nga MI-ja sipas rregullave teknike për rrugët malore duke mos kaluar gjerësinë prej 300 cm.
- Ndërtimi i shtigjeve për këmbësor, kalërim dhe për automjete që bartin persona me aftësi të kufizuar të ecjes, do të realizohet nga MI-ja sipas rregullave teknike për shtigjet për ecje malore duke mos kaluar gjerësinë prej 200 cm.
- Të ruhet forma natyrore e peizazheve gjatë dhe pas ndërtimit të elementeve të Kompleksit të Memorialit, teleferikut dhe objekteve të përhershme në kampingje.
- Ndalohet ndërtimi dhe vendosja e çfarëdo lloji të objektit me karakter industrial, prodhues, komercial, etj që shkakton ndotje dhe degradim në zonë.
- Nuk lejohet vendosja e antenave difuzive dhe të kontejnerëve për mbeturina në hapësira dhe lokalitete me vlera të peizazhit, larmisë biologjike dhe të trashëgimisë natyrore e kulturo - historike.
- Gjatë vendosjes dhe instalimit të antenave radio - difuzive, ngritjes dhe rregullimit të hapësirave për kampingje, vendosje të shtyllave të energjisë elektrike dhe hapjes së kanaleve të ujit, duhet të ruhen maksimalisht vlerat e natyrës e të peizazhit dhe nuk lejohen prerjet e drunjëve të pyllit.
- Shfrytëzimi i resurseve natyrore brenda zonës duhet të jetë kontrolluar, racional dhe i qëndrueshëm.
- Ndalohet çdo lloj veprimtarie, aktivitetet e së cilës zhvillohen në brendi të zonës dhe për rreth saj, nëse nuk merren masat paraprake për parandalimin e ndotjes dhe degradimit të elementeve mjedisore (ajrit, ujit dhe tokës).
- Iniciativa në mbështetje dhe zbatim ndërkombëtar në interes të pastrimit të tokës dhe ujit të kontaminuar nga Uraniumi i Varfëruar.
- Shtimi i kapaciteteve njerëzore dhe në pajisje të njësive për pastrimin më të shpejtë e të plotë të në zonës së Memorialit nga mjetet e pashpërthyer.
- Rehabilitimi i menjëhershëm i zonës së degraduar nga veprimtaria e Gurëthyesit.

- Ndalohet shfrytëzimi i pakontrolluar i pyjeve publike dhe private.
- Ndalohet prerja e drunjtëve për nevoja komerciale, për veç atyre të nevojshme fito-sanitare, në pyjet e kontrolluara të zonës së Memorialit.
- Të zbatohen kriteret për minimizimin e zhurmës gjatë zhvillimit të çfarëdo aktiviteti në zonën e veçantë.

5.2.4. INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET TEKNIKE

- Ndalohet çfarëdo ndërtimi në sipërfaqen në të cilën ky plan hapësinor e parasheh ndërtimin e rrugës së re automobilistike;
- Ndalohet çfarëdo ndërtimi në sipërfaqet e brezave mbrojtës të rrugëve lokale;
- Brezi mbrojtës rrugor paraqet sipërfaqen e të dyja anëve të auto-udhës, të rrugës nacionale, regjionale dhe lokale. Gjerësia e këtij brezi në rrugët nacionale, regjionale dhe lokale është përcaktuar me Ligjin Nr. 2003/11 – Ligjin për Rrugët dhe Ligjin Nr. 03/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për rrugët nr. 2003/11;
- Qeveritë komunale janë kompetente për rrugët lokale në territoret e komunave të tyre, prandaj çdo lloj intervenimi në këto rrugë realizohet me lejen dhe nën mbikëqyrjen e organeve kompetente komunale;
- Gjatë ndërtimit apo përmirësimit të rrugëve automobilistike, duhet të respektohen rregullat mbi kriteret teknike (gjerësia, pjerrtësia, shtresat dhe trashësia e tyre) për ndërtimin e tyre, rregulla të cilat i ka nxjerrë Ministria e Infrastrukturës (MI);
- Përgjatë rrugëve automobilistike të zonës të vendosen të gjitha shenjat e komunikacionit;
- Për çdo qasje me rrugë nga lokacionet ku do të ketë ndërtime me dedikim të caktuar në rrugët lokale, duhet të merret leja nga komuna përkatëse;
- Peshat dhe dimensionet e automjeteve që qarkullojnë nëpër rrugët automobilistike të zonës duhet të jenë në pajtueshmëri me rregullat e veçanta lidhur me këtë që i ka nxjerrë MI;
- Shtigjet për këmbësorë duhet të ndërtohen me gurë apo me materiale tjera që i përshtaten dhe janë në harmoni me rrethinën në të cilën ndërtohen. Gjerësia e tyre duhet të jetë 1.5 – 1.8 m;
- Në vendet e duhura, si aty ku fillon zona e Memorialit “Beteja e Koshares” dhe përgjatë shtigjeve për këmbësorë, duhet të vendosen tabelat me informatat e nevojshme për vizitorët;
- Transportin publik të udhëtarëve mund ta realizojnë vetëm operatorët e licencuar të transportit. Licencimi bëhet nga MI;
- Në mënyrë që transporti i udhëtarëve të jetë sa më i sigurt, automjetet transportues që i posedon operatori i transportit, duhet t’i plotësojnë të gjitha kushtet teknike që i përcakton MI;
- Gjatë ndërtimit të parkingjeve duhet të respektohen rregullat mbi kriteret teknike për ndërtimin e tyre, rregulla të cilat i ka nxjerrë MI;
- Numrin e parkingjeve, vendin e tyre të saktë në hapësirë dhe standardet për parkingje i përcakton plani rregullues për zonën e caktuar.
- Ndërmarrjet e energjisë që do t’i kryejnë punët e shpërndarjes dhe të furnizimit të qytetarëve me energji elektrike duhet të jenë të pajisura me licencë nga ZRRE;
- Punët në ndërtimin apo zgjerimin e rrjetit të furnizimit të energjisë elektrike, ngrohjes ose gazit natyror duhet të kryhen në përputhshmëri të plotë me rregullat teknike që i përpilojnë ndërmarrjet e energjisë dhe të cilët i miraton ZRRE.
- Gjatë projektimit, ndërtimit dhe vënies në shfrytëzim të teleferikut duhet që respektivisht të zbatohen dhe të plotësohen në tërësi rregullat teknike për teleferikë dhe kërkesat që gjenden në UA të nxjerrë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI);
- Për ndërtimin e sistemeve publike të ujësjellësve dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, duhet të merret leja nga Autoriteti Rajonal i Pellgut Lumor;
- Ofruesi i shërbimeve të telefonisë fikse, internetit dhe televizionit kabllor, duhet të jetë e pajisur me licencë nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART) Në mënyrë që të mund të

ushtrojë veprimtarinë e vet, qoftë si kompania publike apo private, në zonën e veçantë dhe në vendbanimet për rreth;

- Operatori i telefonisë mobile nuk mund të fillojë veprimtarinë e vet (fillimisht vendosja e antenave dhe pastaj shërbimet e telefonisë) pa pasur licencën për këtë, të cilën e lëshon Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART);
- Përveç licencës që merret nga ART, për vendosjen e antenave në terren, operatori i telefonisë mobile duhet të marrë edhe pëlqimin mjedisor nga MMPH.
- Të drejtën për administrimin me mbeturinat në zonë dhe në vendbanimet rreth saj e kanë vetëm operatorët për administrimin e mbeturinave që janë të pajisur me licencë nga MMPH;

5.3. DISPOZITAT PËR KONSULTIM, BASHKËPUNIM DHE PJESËMARRJE

- Që nga fillimi dhe në vazhdimësi të procesit të planifikimit dhe të hartimit të Planit duhet organizuar dhe mbajt takime konsultimi me krerët udhëheqës dhe pjesëmarrësit tjerë në luftë nga ish Brigada 138 Agim Ramadani tani anëtarë të OJQ “Veteranëve të Luftës së UÇK-së nga Brigada 138 A. Ramadani”.
- Para zbatimit të çdo aktiviteti, që do të ndërmerret në zonën e Memorialit të Koshares, duhet konsultuar me Bordin e OJQ “Veteranëve të Luftës së UÇK-së nga Brigada 138 A. Ramadani”.
- Gjatë tërë procesit të Planifikimit, Zbatimit dhe Vlerësimit (Evaluimit) të zhvillimeve, duhet të mbizotërojë bashkëpunim ndërmjet palëve të interesit, të sektorëve relevantë të qeverisjes qendrore dhe lokale me shoqërinë civile, bizneset dhe OJQ-të gjegjëse komunale dhe vendore.
- Të gjithë të interesuarit, qofshin përfaqësues apo jo të palëve të interesit, gëzojnë të drejtën për pjesëmarrje në takimet e hapura, të organizuara për diskutim, konsultim apo shqyrtim publik.

5.4. DISPOZITAT MBI RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E ZBATIMIT

- Në etapën e parë, që përfshinë realizimin e zhvillimeve brenda afatit të shkurtë trevjeçar, zbatimi i të cilave duhet bazuar në projektet e aprovuara e të investuara nga Qeveria e Kosovës me mundësi të ndihmës nga PPP (Partneriteti Publik Privat), hyjnë:
 - Elementet më kryesore në Kompleksin e Memorialit (Portali me Kthinat sanitare dhe Parkingun, Lapidari me Varrezat, Murali dhe Amfiteatri)
 - Rikonstruktimi dhe konservimi i Istikameve kryesore
 - Konservimi i Karakollit të bombarduar
 - Rregullimi i rrugëve, për në qendër të zonës, me shtresë:
 - Tamponi prej gurëve të thyer, nga Juniku deri në Kompleksin e Memorialit,
 - Finale prej asfalti, nga Restorant Katana deri në Kompleksin e Memorialit.
 - Rregullimi i rrugëve dhe shtigjeve malore për lëvizje deri në pikat më markante të zonës,
 - Ngritja dhe rregullimi i teleferikut nga Kompleksi Memorial për në Rrasë të Koshares.

- Në etapën e dytë, që përfshinë afatin e mesëm 3 – 5 vjeçar, do të realizohen zhvillimet e bazuara në projekte të aprovuara dhe të investuara nga niveli qendror, me mundësi të ndihmës nga PPP, për:
 - Të gjitha Elementet tjera të Kompleksit të Memorialit,
 - Krijimi i imazhit të ngjarjeve të luftës përmes efekteve të zërit dhe optike (audio-vizuele),
 - Rikonstruktimin dhe konservimin e Istikameve tjera të veçanta dhe në varg,
 - Rregullimin e rrugëve dhe shtigjeve tjera malore,
 - Projektet tjera për mbrojtjen e vlerave mjedisore e të trashëgimisë.
- Në etapën e tretë, ku përfshihen realizimet e zhvillimeve që kërkojnë afat më të gjatë ose të përhershëm, të cilat gjithashtu të bazuara në projekte të aprovuara e të investuara nga Qeveria me mundësi të ndihmës së PPP-së, renditen:
 - Rregullimi përfundimtar i të gjitha rrugëve dhe shtigjeve malore,
 - Ngritja e pendës tri-funksionale (akumulim uji, gjenerim të energjisë dhe urë kalimi) në lumin Gusha,
 - Projektet tjera për zhvillim të turizmit malor, rural, kulturor etj.

5.5. UDHËZIME MBI HULUMTIMET E MËTUTJESHME

- Identifikimi, inventarizimi dhe digjitalizimi i habitateve të llojeve të larmisë biologjike (florës dhe faunës) në zonë të kryhen nën udhëheqjen e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës;
- Kërkimi i mureve të Fortesës së Jerinës si dhe konsolidimi i tyre të kryhen nën udhëheqjen e Institutit Arkeologjik të Kosovës.
- Hulumtimi i burimeve të ripërtëritshme të përshtatshme për përfitimin e energjisë elektrike në zonë të kryhen nën udhëheqjen e Agjencisë për Efiçencë të të Energjisë..

SHTOJCA 1.

VENDIMI I QEVERISË NR. 09/19 ME DATË 15.06.2011



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/19
Datë: 15.06.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor 2011, mori

V E N D I M

1. Të Shpallet zonë nën mbrojtje dhe me interes të veçantë hapësira ku është zhvilluar "Beteja e Koshares" nga Brigada 138 Agim Ramadani me sipërfaqe prej 2488 ha në Komunën e Gjakovës sipas tabelës me ngastra kadastrale të bashkangjitura në aneks të këtij vendimi.
2. Shpronësimi i ngastrave kadastrale të paraqitura në tabelë aneks të këtij vendimi do të bëhet sipas Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme të Republikës së Kosovës.
3. Obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Qeveria e Republikës së Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

PLANI HAPËSINOR

Zona e Mbrojtur me Interes të Veçantë “Beteja e Koshares”

Ky dokument është hartuar nga Instituti për Planifikim Hapësinor në rolin e koordinatorit në bashkëpunim me Grupin Punues Ndër-Institucional i përbërë nga përfaqësues të sektorëve relevant të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Komuna e Gjakovës, Shoqata e Veteranëve të UÇK-së – Brigada 138 Agim Ramadani, Shoqata Bjeshkatare Alpine “Pashtriku”.

Vërejtje:

Versioni i dokumentit në gjuhën shqipe është version kompetent



Instituti për Planifikim Hapësinor
Prishtinë, Nëntor 2013

